

POLITIKA MJEDISORE DHE SOCIALE

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

Përkthimet e tekstit origjinal të këtij dokumenti bëhen nga BERZH-i vetëm për lehtësi të lexuesit. Ndërkohë që BERZH ka treguar kujdes të arsyeshëm për të siguruar autenticitetin e përkthimit, BERZH nuk garanton e as vërteton saktësinë e përkthimit. Lexuesi që mbështetet në një përkthim të tillë, e bën këtë me përgjegjësinë e vet. Në asnjë rrethanë, BERZH-i, punonjësit ose agjentët e saj nuk mbajnë përgjegjësi përpara lexuesit apo përpara kujtdo tjetër për ndonjë pasaktësi, gabim, mungesë, fshirje, defekt dhe/ose ndryshim të përmbajtjes së përkthimit, pavarësisht shkakut, ose për ndonjë dëm që vjen si pasojë e tyre. Në rast mospërputhjeje mes versionit në gjuhën angleze dhe atij të përkthyer, përparësi ka versioni në gjuhën angleze.

Tabela e Përmbajtjes

Seksioni I: Qëllimi	4
Seksioni II: Përkufizime	5
Seksioni III: Objekti.....	6
1. Roli dhe përgjegjësitë e BERZH-it.....	6
2. Angazhimet e BERZH-it.....	6
3. Kërkesat e Performancës Mjedisore dhe Sociale.....	7
4. Llogaridhënia dhe raportimi publik i BERZH-it	9
5. Marrëveshjet institucionale dhe zbatuese.....	10
6. Shtojcat	10
Seksioni IV: Heqje dorë, Përjashtime dhe Publikimi i Informacionit.....	11
1. Heqje dorë	11
2. Përjashtime	11
3. Publikimi i Informacionit.....	11
Seksioni V: Dispozita Kalimtare	11
Seksioni VI: Data e Hyrjes në Fuqi.....	11
Seksioni VII: Kuadri Vendimmarrës.....	11
Seksioni VIII: Shqyrtim dhe Raportim	11
1. Shqyrtimi.....	11
2. Raportimi.....	11
Seksioni IX: Dokumente shoqëruese	11
Shtojca 1: Lista e Përjashtimit nga Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it.....	12
Shtojca 2: Projektet e Kategorisë A	13

Kërkesa e Performancës 1 e BERZH-it: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale.....	15
Kërkesa e Performancës 2 e BERZH-it: Kushtet e punësimit dhe punës	19
Kërkesa e Performancës 3 e BERZH-it: Efiçienca e Burimeve dhe Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjes.....	23
Kërkesa e Performancës 4 e BERZH-it: Shëndeti, siguria dhe sigurimi	26
Kërkesa e Performancës 5 e BERZH-it: Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme.....	30
Kërkesa e Performancës 6 e BERZH-it: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla	39
Kërkesa e Performancës 7 e BERZH-it: Popullsi të indigjene	44
Kërkesa e Performancës 8 e BERZH-it: Trashëgimia kulturore.....	48
Kërkesa e Performancës 9 e BERZH-it: Ndërmjetësit Financiarë	50
Shtojca A: Lista e Referimit të Ndërmjetësve Financiarë	52
Kërkesa e Performancës 10 e BERZH-it: Publikimi i informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit.....	53

Seksioni I: Qëllimi

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH ose Banka) është e angazhuar në promovimin e "zhvillimit të shëndoshë dhe të qëndrueshëm mjedisor" brenda spektrit të plotë të veprimtarive të saj në zbatim të Marrëveshjes së Themelimit të BERZH-it.¹ Banka beson se qëndrueshmëria sociale dhe mjedisore është një aspekt thelbësor në arritjen e rezultateve në përputhje me mandatin e saj të tranzicionit. Si rrjedhojë, projektet që nxisin qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore janë ndër prioritetet më të mëdha në veprimtaritë e Bankës.

Ky dokument:

- Përvijon se si Banka do të vlerësojë dhe monitorojë rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të projekteve të saj;
- Përcakton kërkesat minimale për menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të shkaktuara nga projektet e financuara nga BERZH-i përgjatë jetëgjatësisë së projekteve;
- Përcakton një objektiv strategjik për Bankën për të promovuar projekte me përfitime të mëdha mjedisore dhe sociale; dhe
- Përcakton rolet dhe përgjegjësitë përkatëse si të BERZH-it dhe klientëve të saj në projektimin, zbatimin dhe operimin e projekteve në përputhje me këtë Politikë.

Ky dokument zëvendëson Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it të vitit 2014 si dhe Kërkesat përkatëse të Performancës.

¹ Neni 2.1(vii) i Marrëveshjes së Themelimit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Seksioni II: Përkufizime

Termet e përdorur në këtë Politikë kanë këto kuptime:

"struktura shoqëruese"	struktura ose veprimtari që nuk financohen nga BERZH-i si pjesë e projektit, por që sipas BERZH-it janë të rëndësishme për të përcaktuar suksesin e projektit, ose për të sjellë rezultate të dakordësuara të projektit. Këto janë veprimtari ose struktura të reja: (i) pa të cilat projekti nuk do të ishte i realizueshëm, dhe (ii) nuk do të ndërtohej, zgjerohej, kryhej ose planifikohej për t'u ndërtuar apo realizuar nëse projekti nuk do të ekzistonte.
"praktikë e mirë ndërkombëtare" ose "PMN"	ushtrimi i zotësisë profesionale, korrektesës, maturisë dhe vizionit afatgjatë që do të pritej në mënyrë të arsyeshme nga profesionistë të zotë e me përvojë, të angazhuar në të njëjtën lloj ndërmarrjeje në rrethana të njëjta ose të ngjashme në shkallë botërore ose rajonale. Rezultati i një ushtrimi të tillë duhet të jetë që projekti të përdorë teknologjitë dhe standartet më të përshtatshme në rrethanat specifike të projektit.
"hierarkia e minimizimit të riskut"	masat e marra për të shmangur krijimin e ndikimeve mjedisore ose sociale që në fillim të veprimtarive të zhvillimit dhe, kur kjo nuk është e mundur, zbatimimi i masave të tjera shtesë që do ta minimizonin, zbusnin dhe, si zgjidhje të fundit, kompensonin çdo ndikim të mbetur të padëshirueshëm.
"projekti"	tërësia e punimeve, mallrave, shërbimeve dhe/ose veprimtarive tregtare të përcaktuara në marrëveshjet financiare dhe për të cilat klienti kërkon financimin e BERZH-it, dhe të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të BERZH-it, ose nga menaxhimi i Bankës, në rastet kur Bordi i Drejtorëve delegon autoritetin e miratimit.
"social"	çështje që u përkasin personave të prekur nga projekti dhe komuniteteve e punëtorëve të tyre, si dhe lidhur me statusin socio-ekonomik, cënueshmërinë, gjininë, identitetin gjinor, të drejtat e njeriut, orientimin seksual, trashëgiminë kulturore, kushtet e punës, shëndetin dhe sigurinë dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje.
"persona të cënueshëm"	persona ose grupe individësh të cilët mund preken më negativisht nga ndikimet e projektit në krahasim me të tjerët për shkak të gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, fesë, etnisë, statusit ndigjen, moshës (duke përfshirë të miturit, të rinjtë dhe të moshuarit), aftësive të kufizuara fizike apo mendore, edukimit, bindjeve politike apo statusit shoqëror. Individët dhe/ose grupet e cënueshme mund të përfshijnë, ndër të tjerë, por nuk kufizohen në, persona në situata të cënueshme, si personat që jetojnë nën kufirin e varfërisë, të pastrehët, të moshuarit, familjet me një kryefamiljar, punëtorët sezonale, refugjatët, , personat e shpërngulur brenda për brenda vendit, pakicat kombëtare, komunitetet që varen nga me burimet natyrore ose çdo person tjetër të zhvendosur që mund të mos mbrohet nga legjislacioni kombëtar dhe/ose e drejta ndërkombëtare.

Seksioni III: Objekti

1. Roli dhe përgjegjësitë e BERZH-it

- 1.1. Përgjegjësitë e BERZH-it janë në përputhje me rolin e saj si institucion financiar ndërkombëtar që jep financim bankar për projekte të miratuara nga BERZH-i. Në lidhje me çdo projekt të veçantë investimi ose bashkëpunimi teknik, niveli i angazhimit të BERZH-it përcaktohet nga natyra dhe objekti i projektit, disponueshmëria e fondeve të donatorëve si dhe nga rrethanat konkrete të bashkëpunimit dhe marrëdhënies me klientin.
- 1.2. BERZH-i mund të mos e financojë një projekt, për arsye mjedisore ose sociale. Ka disa lloje veprimtarish të cilat BERZH-i nuk i financo, në përputhje me Listën e Përfshirjes për arsye Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, e përfshirë në Shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj Politike.
- 1.3. BERZH-i administron një sërë fondesh të donatorëve. Projektet apo veprimtaritë që financohen tërësisht apo pjesërisht me fondet e donatorëve duhet të jenë në përputhje me këtë Politikë. Kërkesa të tjera shtesë të donatorëve në lidhje me çështjet mjedisore ose sociale mund të zbatohen për projektet e financuara me fondet e donatorëve, sipas marrëveshjeve të lidhura ndërmjet BERZH-it dhe donatorëve.

2. Angazhimet e BERZH-it

- 2.1. Të gjitha projektet e financuara nga BERZH do të strukturohen në mënyrë të tillë që të përmbushin kërkesat e kësaj Politike.
- 2.2. Si palë nënshkruese e Parimeve Evropiane për Mjedisin,² BERZH-i angazhohet të sigurojë përdorimin e parimeve, praktikave dhe standardeve thelbësore mjedisore të BE-së³, kur këto mund të aplikohen në nivel projekt, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike. Kur rregulloret e vendit priten ndryshojnë nga standardet mjedisore rregullatore të BE-së, projektet duhet të përmbushin nivelin më të rreptë të rregullimit.
- 2.3. BERZH-i nuk do të financojë me dijoni projekte të cilat bien ndesh me ligjet kombëtare ose detyrimet e një vendi në bazë të traktateve, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të identifikuar gjatë fazës së vlerësimit të projektit.
- 2.4. BERZH-i është i angazhuar në respektimin e të drejtave të njeriut⁴ në projektet e financuara nga BERZH. BERZH-i do t'u kërkojë klientëve, që në veprimtaritë e tyre tregtare, të respektojnë të drejtat e njeriut, të shmangin shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të adresojë ndikimet e mundshme dhe riskun e shkeljes së të drejtave të njeriut që mund të shkaktohen nga aktiviteti i klientëve. të . BERZH-i do të vijojë të përmirësojë projektet që financon në përputhje me praktikatat e mira ndërkombëtare dhe do të synojë të përmirësojë proceset për evidentimin dhe trajtimin e riskut të shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë vlerësimit dhe monitorimit të projekteve.

- 2.5. BERZH-i beson se barazia gjinore është një aspekt themelor i mirë-funksionimit të ekonomisë së tregut dhe i një shoqërie demokratike, dhe është i angazhuar në parandalimin e diskriminimit gjinor dhe promovimin e barazisë gjinore përmes mandatit të saj. BERZH-i u kërkon klientëve të identifikojnë çdo faktor të mundshëm që mund të thellojë pabarazitë gjinore dhe ndikime të padëshirueshme dhe të ndërmarrimasa për minimizim e riskut . BERZH-i do t'u kërkojë klientëve që të marrin masa për parandalimin dhe trajtimin e çdo lloj forme të dhunës, ngacmimeve, duke përfshirë ngacmimin seksual, shfrytëzimin dhe abuzimin, dhunën me bazë gjinore, bullizimin, kërcënimin, dhe/ose shfrytëzimin.
- 2.6. BERZH-i do t'u kërkojë klientëve të tij që të identifikojnë personat apo grupet e cënueshme që mund të preken në mënyrë të zhdrejtë nga projekti dhe të zhvillojnë dhe zbatojnë plane masash që këto grupe mos të preken në mënyrë të zhdrejtë. Kjo do të përfshijë vlerësimin e ndikimit që mund të sjellin ndryshimet tarifore si rrjedhojë e projekteve në kuadër të aftësisë paguese për shërbimet bazë nga grupet e cënueshme dhe/ose të disavantazuara të popullatës dhe të bindet se janë hartuar dhe vënë në zbatim skema të efektshme për t'i dhënë zgjidhje këtyre sfidave
- 2.7. BERZH e kupton rëndësinë e adresimit të shkaqeve dhe pasojave të ndryshimeve klimatike në vendet ku ajo operon. BERZH-i do të angazhohet, sipas rastit, në investime novatore dhe asistencë teknike për të mbështetur investime pa ose me nivel të ulët të emetimit të karbonit dhe për minimizimin e ndryshimeve klimatike, si dhe do të identifikojë mundësitë për shmangien ose pakësimin e shkaktimeve të gazeve serrë nga projektet. BERZH do t'u kërkojë klientëve që të vlerësojnë rreziqet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike në projekt. BERZH do të mbështesë klientët gjithashtu në hartimin e masave përshtatëse klimatike dhe investime ripërtëritëse klimatike si dhe në menaxhimin e rreziqeve të shkaktuara nga ndryshimi klimatik.
- 2.8. BERZH do t'u kërkojë klientëve që të tregojnë kujdes në qasjen e tyre ndaj mbrojtjes, ruajtjes, menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve të gjalla natyrore. Klientët duhet të garantojnë që projektet përkatëse përfshijnë masa për mbrojtjen dhe, aty ku është e mundur për përmirësimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit me qëllim që të mos ketë humbje në biodiversitet, si dhe në menaxhimin dhe përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të burimeve të gjalla natyrore.
- 2.9. BERZH-i është i angazhuar për parimet e transparencës, përgjegjësisë dhe angazhimit të palëve të interesit, si dhe nxit klientët e saj në përvetësimin dhe zbatimin e këtyre parimeve. BERZH-i u kërkon klientëve të respektojnë kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar në lidhje me informimin dhe konsultimin publik , identifikimin e palëve të interesit që mund të preken dhe/ose janë të interesuar në projekte, dhe të zhvillojnë dhe zbatojnë një mekanizëm ankesash. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit, BERZH-i u kërkon klientëve që të bëjnë publik

² Parimet Evropiane për Mjedisin (PEM) janë miratuar nga Këshilli i Bankës Evropiane për Zhvillim, BERZH-i, Banka Evropiane e Investimeve, Korporata Nordike për Financimin e Mjedisit dhe Banka Nordike e Investimeve. PEM është një nisim e marrë në përgjigje të shtytjes për rritje të harmonizimit të parimeve, praktikave dhe standardeve mjedisore që shoqërojnë financimin e projekteve. Angazhimet e PEM-it pasqyrohen në KP-të 1, 3, 4 dhe 10.

³ Standardet mjedisore rregullatore të Bashkimit Evropian përfshihen në legjislacionin dytësor të BE-së, për shembull në rregulloret, direktiva dhe vendime. Nga ky përkufizim përjashtohen normat procedurale që u drejtohen shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila zbatohet për shtetet anëtare, institucionet e BE-së dhe personat juridikë dhe fizikë të BE-së.

⁴ Në kuadër të kësaj Politike, BERZH-i udhëhiqet nga Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe tetë konventat bazë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

informacion e nevojshëm rreth risqevedhe ndikimeve të shkaktuara nga projektet, të angazhohen me seriozitet, me palët e interesit për adresimin te eficient, gjithëpërfshirës dhe kulturalisht të përshtatshëm, si dhe të marrin në konsideratë informacionin e mbledhur përmes këtij angazhimi.

- 2.10. BERZH-i do të krijojë partneritete me klientët për t'i ndihmuar ata në shtimin e vlerës për veprimtaritë e tyre, përmirësimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe forcimin e kapaciteteve të tyre për menaxhimin mjedisor dhe social. BERZH-i do të punojë së bashku me institucione të tjera financiare ndërkombëtare, Bashkimin Evropian, donatorët dypalësh, agjencitë e OKB-së dhe organizata të tjera për të bashkërenduar ndërhyrje të efektshme për nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në nivel rajonal ose sektorial në vendet ku ushtron aktivitetin. Kur bashkë-financon projekte me banka për zhvillim shumëpalësh dhe institucione të zhvillimit dypalësh, BERZH-i do të bashkëpunojë me to për të rënë dakord për një qasje të përbashkët për përgatitjen dhe vlerësimin e projekteve, menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale, si dhe monitorimin dhe raportimin e tyre. BERZH-i mund të pranojë një qasje të përbashkët me kusht që kjo qasje të jetë në përputhje materiale në përmbajtje dhe rezultate me këtë Politikë, duke përfshirë edhe Kërkesat e Performancës. Banka do t'u kërkojë klientëve t'i përmbahen ose kërkesave të Bankës ose qasjes së përbashkët të projektit.

- 2.11. Strategjitë e BERZH-it për vendet përkatëse, si edhe strategjitë dhe politikat sektoriale, do të marrin parasysh sfidat dhe mundësitë mjedisore dhe sociale të cilat shoqërojnë veprimtaritë e parashikuara të BERZH-it.

- 2.12. Përmes bashkëpunimit teknik dhe dialogut për hartimin e politikave, BERZH-i do të punojë për të ngritur kapacitetet për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut social dhe mjedisor, impaktin dhe mundësitë, në vendet ku ushtron aktivitetin. BERZH-i do të mundësojë zhvillimin e një mjedisi nxitës, në të cilin klientët e saj do të arrijnë rezultate me qëndrueshmëri mjedisore dhe sociale.

3. Kërkesat e Performancës Mjedisore dhe Sociale

- 3.1. Banka ka përcaktuar një paketë gjithëpërfshirëse të kërkesave specifike të performancës (KP-të) për fushat kryesore të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale që projektet duhet të përmbushin. Në thelb të KP-ve është zbatimi i hierarkisë së minimizimit të riskut dhe praktikës së mirë ndërkombëtare.

- 3.2. KP-të janë si më poshtë:

KP 1	Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale
KP 2	Punësimi dhe kushtet punës
KP 3	Efiçenca e burimeve dhe parandalimi dhe kontrolli i ndotjes
KP 4	Shëndeti, siguria dhe sigurimi
KP 5	Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme

KP 6 Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve të gjalla natyrore

KP 7 Popullsia indigjene

KP 8 Trashëgimia kulturore

KP 9 Ndërmjetësit Financiarë

KP 10 Publikimi i informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit

KP-të 1 deri në 8 si dhe KP 10 përfshijnë kërkesat për investimet e drejtpërdrejta. Projektet për ndërmjetësuesit financiarë (NF) duhet të përmbushin KP 2, KP 9 dhe kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë të KP 4. Secila KP përshin kërkesat specifike për klientët e BERZH-it në lidhje me projektet e financuara nga BERZH, pavarësisht nëse ato realizohen drejtpërsëdrejti nga klienti apo përmes palëve të treta⁵. Përputhshmëria me legjislacionin përkatës kombëtar është pjesë integrale e të gjitha kërkesave të performancës.

- 3.3. Projektet që përfshijnë veprimtari tregtare ose struktura të reja do të projektohen në mënyrë të atillë që t'i përmbushin që në fillim kërkesat e performancës. Nëse një projekt përfshin modernizimin apo përmirësimin e veprimtarive ose strukturave ekzistuese që nuk i përmbushin kërkesat e performancës në momentin e miratimit nga Bordi i Drejtorëve, apo i organit vendimmarrës të BERZH-it, ose nëse projekti nuk përmbush KP-të që në fillim, klienti duhet të zbatojë një plan veprimi mjedisor dhe social (PVMS) i cili do të përmbajë një sërë masash që duhet të jenë teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive për të arritur përputhshmërinë e këtyre veprimtarive ose strukturave me kërkesat e performancës brenda një afati kohor të pranueshëm për BERZH-in. Në PVMS, Banka dhe klienti do të bien dakord për veprimet konkrete korrigjuese dhe parandaluese, masat zbutëse dhe afatin e realizimit që klienti do të zbatojë për menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit në përputhje me KP-të. PVMS-ja do të jetë pjesë e kontratave të financimit dhe do të përfshijë, sipas rastit, detyrimet e klientit në mbështetje të zbatimit të PVMS-së.

- 3.4. Vlerësimi paraprak mjedisor dhe social i projektit do të përfshijë vlerësimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të strukturave shoqëruese. Klientët duhet të garantojnë që rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe/ose sociale të shkaktuara nga strukturat shoqëruese menaxhohen dhe zbuten në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, PMN-në dhe objektivat e KP-ve. Nëse strukturat shoqëruese nuk mund të strukturohen për të përmbushur objektivat e KP-ve, vlerësimi i projektit do të identifikojë rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe/ose sociale që këto struktura shoqëruese mund t'i paraqesin projektit.

- 3.5. Aty ku identifikohen rreziqe dhe ndikime të mundshme të konsiderueshme mjedisore dhe/ose sociale nga strukturat ose veprimtari të tjera në afërsi të projektit, strukturave ekzistuese si dhe strukturave ose veprimtarive jashtë kontrollit të klientit, për të cilat KP-të nuk zbatohen, klienti do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të vlerësuar dhe zbutur rreziqet ndaj projektit.

⁵ Ndër të tjerë, një palë e tretë mund të jetë një agjenci shtetërore, një kontraktor ose furnitor me të cilin projekti/klienti ka marrëdhënie të konsiderueshme kontraktore.

Investimet e drejtpërdrejta⁶

- 3.6. BERZH-i kategorizon çdo projekt për të përcaktuar natyrën dhe nivelin e nevojshëm të hetimeve mjedisore dhe sociale, të publikimit të informacioneve dhe angazhimit të palëve të interesit. Kjo realizohet në përputhje me natyrën, vendndodhjen, ndjeshmërinë dhe shkallën e projektit, si dhe me rëndësinë e ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale, të cilat janë të reja dhe shtesë.
- 3.7. Një projekt kategorizohet A tekur mund të rezultojë në ndikime potencialisht të konsiderueshme mjedisore dhe/ose sociale, duke përfshirë ndikimet e drejtpërdrejta dhe ato kumulative mjedisore dhe sociale të cilat në momentin e kategorizimit janë të reja dhe shtesë, dhe nuk mund të identifikohen ose vlerësohen lehtësisht. Projektet e kategorizuara si A kërkojnë një proces të formalizuar dhe me pjesëmarrje në vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social. Një listë e projekteve të Kategorisë A paraqitet në Shtojcën 2 bashkëlidhur kësaj Politike.
- 3.8. Një projekt kategorizohet B kur ndikimet e mundshme mjedisore dhe/ose sociale zakonisht janë specifike për vendndodhjen dhe/ose identifikohen dhe trajtohen përmes masave zbutëse të efektshme. Objekti i vlerësimit mjedisor dhe social do të përcaktohet nga BERZH-i rast pas rasti.
- 3.9. Një projekt kategorizohet C nëse me shumë gjasa ka pak ose aspak ndikime të mundshme negative mjedisore dhe/ose sociale.
- 3.10. Shqyrtimet fillestare mjedisore dhe sociale (SHFMS) do të kryhen kur ka informacion të pamjaftueshëm në momentin e kategorizimit për të përcaktuar kategorinë e duhur dhe objektin e vlerësimit.

Ndërmjetësit Financiarë

- 3.11. Një projekt kategorizohet "NF" nëse struktura e financimit kërkon që fondet të jepen përmes ndërmjetësve financiarë (NF).

Qasja e përgjithshme ndaj vlerësimit të projektit

- 3.12. Të gjitha projektet i nënshtrohen vlerësimit mjedisor dhe social, për të ndihmuar BERZH-in të vendosë nëse do të financojë apo jo projektin dhe, nëse po, mënyrën me të cilën duhen trajtuar çështjet mjedisore dhe sociale gjatë planifikimit, zbatimit dhe funksionimit të projektit. Ndërsa objekti i posaçëm i vlerësimit do të përcaktohet rast pas rasti, ai do të jetë i përshtatshëm me natyrën dhe shkallën e projektit dhe do të jetë në përpjesëtim të drejtë me nivelin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale. Vlerësimi do të vlerësojë rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit, si dhe kapacitetin dhe angazhimin e klientit për të zbatuar projektin në përputhje me KP-të përkatëse. Kur një projekt përfshin struktura ekzistuese apo veprimtari tregtare, dhe/ose struktura shoqëruuese, vlerësimi do të marrë parasysh rreziqet dhe ndikime mjedisore dhe sociale të lidhura me këto struktura dhe veprimtari.
- 3.13. Është përgjegjësi e klientit të sigurojë dhënien e informacionit të duhur në mënyrë që Banka të mund të kryejë një vlerësim mjedisor dhe social në përputhje me këtë Politikë. Roli i Bankës është: (i) shqyrtimi i informacionit të klientit; (ii) dhënia e orientimeve për të ndihmuar klientin në hartimin e masave të duhura në përputhje me hierarkinë zbutëse për t'u dhënë zgjidhje ndikimeve mjedisore dhe sociale që të përmbushen KP-të

përkatëse dhe (iii) të ndihmojë në identifikimin e mundësive për përfitime mjedisore ose sociale shtesë.

- 3.14. Në rastet kur investimi i Bankës mund të mos ketë për objekt projekte apo aktive fizike konkrete, si në rastin e financimit të kapitalit qarkullues dhe të disa llojeve të instrumenteve të kapitalit neto, apo për investime të ardhshme, atëherë përdorimi i propozuar i mjeteve monetare dhe gjurma mjedisore dhe sociale janë përgjithësisht të paqarta në momentin e marrjes së vendimit të BERZH-it për të investuar. Prandaj, Banka (i) duhet ta analizojë investimin në bazë të rreziqeve dhe ndikimeve të vetvetishme të sektorit në fjalë dhe të kushteve në të cilat ushtrohet veprimtaria tregtare dhe (ii) duhet të analizojë kapacitetin dhe angazhimin q137 merr klienti për të zbatuar projektin në përputhje me kërkesat përkatëse të performancës.
- 3.15. Kur projekti ka të bëjë me financën e përgjithshme të korporatës, kapitalin qarkullues apo financimin e kapitalit për një shoqëri me vendndodhje të shumta, dhe kur përdorimi i mjeteve monetare nuk ka për objekt aktivitet fizike konkrete, klientit do t'i kërkohej të përafrojë sistemet e tij të menaxhimit mjedisor dhe social me KP-të dhe të zhvillojë masa në nivel korporate për menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale të lidhura me veprimtarinë e tij tregtare.
- 3.16. Për transaksionet e tregut kapital⁷, publikimi i dokumentacionit mjedisor dhe social përpara dhe pas nënshkrimit i nënshtrohet rregullave dhe rregulloreve të zbatueshme të tregut të kapitalit që parandalojnë tregtimin e instrumenteve financiare në bazë të informacionit jopublik material dhe parimeve që lidhen me trajtimin e barabartë të investitorëve. Për shkak të natyrës së transaksioneve të tregut kapital, vlerësimi mjedisor dhe social i Bankës do të jetë i bazuar në risk. Vlerësimi mund të duhet të mbështetet vetëm në informacionin e disponueshëm publikisht për të vlerësuar kapacitetin dhe angazhimin e klientit në menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe/ose sociale që lidhen me veprimtarinë e tij tregtare (dhe me projektet e investimeve që do të financohen me të ardhurat e mbledhura nga transaksione të tilla të tregut të kapitalit) në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, PMN-të dhe KP-të. Vlerësimi paraprak do të evidentojë nëse informacioni i disponueshëm mjafton për të përcaktuar rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit dhe përputhshmërinë me kërkesat e performancës. Pas nënshkrimit, klientët duhet të respektojnë KP-të. Projektet me rreziq të lartë apo projektet e kategorizuara "A" nuk do të financohen përmes instrumenteve të tregut të kapitalit.
- 3.17. Kur BERZH-it i paraqitet kërkesë për të financuar një projekt, që është në ndërtim e sipër, ose kur projekti i ka marrë lejet përkatëse në vendin pritës, përfshirë edhe miratimin e vlerësimeve të ndikimit vendor mjedisor dhe social, vlerësimi i Bankës do të përfshijë një analizë të boshllëqeve të planifikimit dhe zbatimit të projektit kundrejt kërkesave të performancës për të identifikuar nëse studime dhe/ose masa zbutëse shtesë do të nevojiten për të përmbushur kërkesat e BERZH-it.
- 3.18. Vlerësimi i BERZH u kërkon klientëve të identifikojnë palët e interesit që mund të preken nga projektet dhe/ose mund të jenë të interesuar për këto projekte, të publikojnë informacion të mjaftueshëm për rreziqet dhe ndikimet që lindin nga projektet dhe të konsultohen me palët e interesit në mënyrë të plotë dhe kulturalisht të

⁶ Projektet e BERZH-it ndahen në "Projekte të investimeve të drejtpërdrejta" dhe "Projekte me ndërmjetës financiarë (NF)". Në rastin e projekteve me ndërmjetës financiarë, klienti është një ofrues i shërbimeve financiare, një fond investimi ose një subjekt tjetër i ngjashëm. Të gjitha projektet e tjera janë projekte të investimeve të drejtpërdrejta.

⁷ Transaksionet e tregut të kapitalit i referohen transaksioneve në letra me vlerë të tregtueshme në bursë si obligacionet dhe aksionet ose transaksionet në letra me vlerë që nuk tregtohen në bursë, por mbeten subjekt i kufizimeve në tregtimin e këtyre letrave me vlerë në bazë të informacionit material jopublik.

përshtatshme. Në veçanti, BERZH-i u kërkon klientëve të angazhohen me personat e prekur nga projektet dhe palët përkatëse të interesit, në përputhje me ndikimet e mundshme që shoqërojnë projektin dhe nivelin e shqetësimit të palëve të interesit. Për projektet objekt të VNMS-së që mund të kenë ndikime të konsiderueshme mjedisore, një angazhim i tillë i palëve të interesit duhet të realizohet duke mbajtur parasysh frymën dhe parimet e Konventës së UNECE-së "Për të drejtën për informacion, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore". Për projektet që mund të kenë ndikime të konsiderueshme mjedisore përgjatë kufijve ndërkombëtarë, Banka do të nxisë qasjen e Konventës së UNECE-së "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në nivel ndërkufitar", pavarësisht vendndodhjes gjeografike të projektit. Banka, në disa raste, mund të zhvillojë vetë konsultime publike për të kuptuar pikëpamjet e palëve të interesit.

- 3.19. Për projektet me ndërmjetës financiarë, Banka do të kryejë studimin e duhur për ndërmjetësin financiar dhe portofolin e tij, për të vlerësuar: (i) politikat dhe procedurat ekzistuese mjedisore dhe sociale të ndërmjetësit financiar dhe kapacitetin e tij për t'i zbatuar ato, (ii) rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë portofolin ekzistues të NF dhe projektet e pritsëm në të ardhmen dhe (iii) masat e nevojshme për të përmirësuar sistemin ekzistues të menaxhimit mjedisor dhe social.

Vendimmarrja

- 3.20. Dokumentacioni që i paraqitet Bordit të Drejtorëve të BERZH-it ose nëse Bordi i Drejtorëve ia ka deleguar autoritetin e miratimit menaxhmentit të Bankës, për miratimin e një projekti duhet të përfshijë një përshkrim të vlerësimit mjedisor dhe social, të ndikimeve dhe rreziqeve thelbësore, të masave zbutëse të identifikuar si dhe një përmbledhje lidhur me angazhimin e palëve të interesuara, dhe informacion rreth mënyrës se si rreziqet dhe ndikimet e projektit po trajtohen ose do të trajtohen nga klienti. Bordi i Drejtorëve ose organi tjetër vendimmarrës i Bankës, sipas rastit, do të marrin parasysh komentet dhe shqetësimet e palëve të interesit në procesin e tyre të vendimmarrjes si pjesë e vlerësimit të përfitimeve dhe rreziqeve të përgjithshme të projektit.
- 3.21. Bordi i Drejtorëve i Bankës mund të bjerë dakord që, si kusht për financimin nga BERZH-i, disa elemente të caktuara të vlerësimit mjedisor dhe social të bëhen pas miratimit të Bordit dhe pas nënshkrimit të kontratave të financimit. Bordi do të marrë parasysh ndikimet, rreziqet dhe përfitimet e përgjithshme të qasjes së propozuar. Kur projekti miratohet në zbatim të këtyre kushteve, Dokumenti Përmbledhës i Projektit do të përfshijë një përshkrim të kësaj qasjeje.

Dokumentacioni ligjor

- 3.22. Kontratat e financimit që BERZH-i nënshkruan me klientët në lidhje me një projekt do të përfshijnë dispozita të veçanta që pasqyrojnë kërkesat mjedisore dhe sociale të BERZH-it. Këto përfshijnë përmbushjen e të gjitha kërkesat e zbatueshme të performancës, si dhe dispozitat për raportimin mjedisor dhe social, angazhimin e palëve të interesit dhe monitorimin. Dokumentet ligjore do të përfshijnë gjithashtu, sipas rastit, edhe të drejtat dhe/ose rrugëzgjidhjet ligjore për Bankën në rastin kur huamarrësi ose shoqëria në të cilën bëhet investimi nuk i zbaton dispozitat mjedisore ose sociale në përputhje me kërkesat e kontratës së financimit.

Monitorimi

- 3.23. BERZH-i do të monitorojë dhe vlerësojë si projektet me financim të drejtpërdrejtë si ato me ndërmjetësim

kundrejt objektivave të kësaj Politike për aq kohë sa Banka ka interes financiar në projekt. Shkalla e monitorimit do të jetë në përputhje me rreziqet mjedisore dhe sociale të lidhura me projektin. BERZH-i shqyrton raportet vjetore mjedisore dhe sociale për performancën mjedisore dhe sociale të projekteve, zbatimin e PVMS-së dhe respektimin nga ana e klientit e marrëveshjeve mjedisore dhe sociale në kontratat financiare. Kur klienti nuk i përmbush angazhimet sociale dhe mjedisore sipas përcaktimeve të kontratave financiare, Banka mund të bëjë dakord me klientin për masa korrigjuese që mund të ndërmarrë klienti. Nëse klienti nuk i përmbush masat korrigjuese për të cilat është rënë dakord, Banka mund të marrë masa dhe/ose të përdorë rrugët ligjore të parashikuara në kontratat e financimit, si ta gjykojë të arsyeshme. BERZH-i mund të verifikojë periodikisht informacionin e monitorimit të përgatitur nga klientët përmes vizitave në terren të projekteve të kryera nga specialistët dhe/ose ekspertët e pavarur të çështjeve mjedisore dhe sociale. Në rastet kur Banka është në një proces gjyqësor me klientin, aftësia monitoruese e saj mund të jetë e kufizuar.

Ndryshimet operative

- 3.24. Ndryshime mund të ndodhin në natyrën dhe qëllimin e projektit pas miratimit nga BERZH dhe nënshkrimit të marrëveshjeve financuese. Këto ndryshime mund të kenë pasoja të konsiderueshme mjedisore ose sociale që lidhen me to. Kur parashikohen ndryshime të tilla me rëndësi materiale, Banka bën një vlerësim mjedisor dhe social të ndryshimeve përkatëse, në përputhje me këtë Politikë dhe me çdo vlerësim shtesë dhe kërkesë për angazhimin e palëve të interesit, si dhe në dokumentacionin e modifikuar/ristrukturuar të projektit do të përfshihen masa zbutëse mjedisore dhe sociale. Kur ndryshimet operative çojnë në një situatë mjedisore dhe/ose sociale e cila ndryshon në mënyrë materiale nga ajo e miratuar nga Bordi, ndryshimi i raportohet nivelit të lartë drejtues të Bankës dhe, sipas rastit, i paraqitet Bordit për informim ose miratim në përputhje me politikat e zbatueshme të BERZH-it.

4. Llogaridhënia dhe raportimi publik i BERZH-it

- 4.1. BERZH-i është i angazhuar me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së palëve të interesit. Banka do të publikojë raportin vjetor të qëndrueshme risë me informacion mbi aspektet mjedisore dhe sociale të lidhura me veprimtaritë dhe operacionet e saj të financimit, si dhe për zbatimin e kësaj Politike. BERZH-i do të përfshihet në dialog të plotë me palët përkatëse të interesit të Bankës, në përputhje me Direktivën e BERZH-it për Informimin Publik (DIP). Banka do të nxisë praktika të mira të ngjashme tek klientët e saj.
- 4.2. BERZH-i do të përmbledhë rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale lidhur me projektet në Dokumentet Përmbledhëse të Projekteve në përputhje me DIP.
- 4.3. Mekanizmi i llogaridhënies së BERZH-it, Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin, u jep individëve, organizatave dhe grupeve që mendojnë se mund t'u shkaktohet dëm nga projekti një mjet për të ngritur çështje dhe për të kërkuar ndihmë me zgjidhjen e problemit veçmas nga operacionet e bankës. Mekanizmi mund të përdoret edhe nga individë dhe grupe për të paraqitur ankesa nëse ata besojnë se Banka nuk ka respektuar këtë Politikë apo komponentë të DIP-it specifikë për projektin.

5. Marrëveshjet institucionale dhe zbatuese

- 5.1. Për të siguruar që vendimet strategjike të përshkruara më lart janë adresuar në mënyrën e duhur, BERZH-i do të caktojë përgjegjësitë dhe burimet e duhura për zbatimin efektiv të kësaj Politike. Banka do të ruajë burimet e duhura njerëzore për të mbikëqyrur proceset e vlerësimit dhe të monitorimit mjedisor dhe social si dhe për të nisur dhe zhvilluar projekte me përfitim mjedisor dhe social.
- 5.2. BERZH-i do të përgatisë dhe ndjekë procedurat mjedisore dhe sociale, udhëzuesit dhe mjetet e duhura për të ndihmuar në zbatimin e kësaj Politike, dhe do të sigurojë që personeli të marrë trajnimin e duhur për kërkesat e kësaj Politike.
- 5.3. BERZH-i do të vazhdojë të mbështetet nga Këshilli Konsultativ Mjedor dhe Social (KKMS), mendimet e të cilit do të merren për çështje të përgjithshme të lidhura me politikën dhe për politikat dhe strategjitë sektoriale përpara finalizimit të tyre. Mendimet e këtij Këshilli do të merren edhe për çështje konkrete të lidhura me projektet dhe veprimtaritë e BERZH-it.

6. Shtojcat

Përmbajtja e Shtojcave 1 deri në 10 janë pjesë e këtij Seksioni III.

Seksioni IV: Heqje dorë, Përrjashtime dhe Publikimi i Informacionit

1. Heqje dorë

Bordi i Drejtorëve mund të lejojë një përrjashtim ndaj një kërkese të kësaj Politike që nuk lejohet shprehimisht nga kushtet e kësaj Politike.

2. Përrjashtime

Kjo Politikë nuk është e zbatueshme për shërbimet këshillimore, projektet e nismave në komunitet, dialogun politik dhe bashkëpunimin teknik, të financuar dhe/ose zbatuar nga BERZH-i, ose proceset drejtuese, administruese dhe vendimmarrëse të BERZH-it.

3. Publikimi i Informacionit

Kjo Politikë do të bëhet publike në faqen zyrtare të internetit të Bankës menjëherë pas miratimit të saj nga Boardi i Drejtorëve.

Seksioni V: Dispozita Kalimtare

Projektet që marrin miratimin fillestar nga organi drejtues i Bankës⁸ përpara hyrjes në fuqi të kësaj Politike, i nënshtrohen politikës në fuqi në kohën e miratimit fillestar të projektit.

Seksioni VI: Data e Hyrjes në Fuqi

Kjo Politikë hyn në fuqi më 1 janar 2020.

Seksioni VII: Kuadri Vendimmarrës

Llogaridhënës

Zëvendës-presidenti për Zyrën e Rrezikut dhe Përrputhshmërisë jep llogari për këtë Politikë.

Përgjegjës

Drejtori Menaxhues i Departamentit të Mjedisit dhe Qëndrueshmërisë është përgjegjës për këtë Politikë.

Seksioni VIII: Shqyrtim dhe Raportim

1. Shqyrtimi

Politika do t'i nënshtrohet shqyrtimit, me një proces publik konsultimi në vitin 2024.

Bordi i Drejtorëve mund të miratojë rishikime të Politikës në çdo fazë pa mbajtur konsultime publike kur rishikimet nuk janë të një natyre thelbësore ose kur lindin nga ndryshime të një politike tjetër të Bankës që ka qenë objekt i konsultimeve publike.

2. Raportimi

Nuk zbatohet.

Seksioni IX: Dokumente shoqëruese

Politika e Informimit Publik (2019) dhe Direktiva për Informimin Publik (2019)

Politika e Llogaridhënies së Projektit (2019) dhe

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit: Udhëzimi (2019)

⁸ Në kohën kur është miratuar kjo Politikë, për investime të drejtpërdrejta dhe me ndërmjetësues financiarë, ky miratim fillestar quhet "Shqyrtimi i konceptit".

Shtojca 1: Lista e Përrjashtimit nga Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it

BERZH-i, me dijeni të saj, nuk do të financojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes NF, projektet ku të ardhurat e BERZH përdoren për aktivitete që kanë të bëjnë me sa vijon::

- a. Prodhimin ose tregtimin e produkteve apo veprimtarive të konsideruara të paligjshme sipas ligjeve apo rregulloreve (kombëtare) të vendit pritës, ose sipas konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ose që janë objekt i nxjerrjes jashtë përdorimit apo bllokimit ndërkombëtar, siç janë:
 - (i) prodhimi ose tregtimi i produkteve që përmbajnë bifenole të poliklorinuara (PCB).⁹
 - (ii) prodhimi ose tregtimi i produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme.¹⁰
 - (iii) prodhimi ose tregtimi i lëndëve ozon-holluese.¹¹
 - (iv) prodhimi ose tregtimi i ndotësve organikë të qëndrueshëm.¹²
 - (v) tregtimi i jetës së egër natyrore ose prodhimi apo tregtimi i produkteve të llojeve të egra objekt i CITES.¹³
 - (vi) lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të ndaluara sipas drejtës ndërkombëtare.¹⁴
- b. Largimin e detyruar.¹⁵
- c. Minierat termike të qymyrit ose kapaciteti i prodhimit të energjisë elektrike me qymyr.
- d. Kërkimi dhe prodhimi i naftës.
- e. Projektet zhvilluese të nxjerrjes së naftës, me përjashtim të rrethanave të rralla dhe të jashtëzakonshme ku të ardhurat e projektit synojnë vetëm reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë apo të djegjes nga fushat prodhuese ekzistuese.
- f. Veprimtaritë që kanë të bëjnë me të ushqyerit e detyruar të rosave dhe patave.

- g. Mbajtja e kafshëve me qëllimin kryesor të prodhimit të gëzofit ose çdo veprimtari që përfshin prodhimin e gëzofit.
- h. Prodhimin, përdorimin ose tregtimin e fibrave të asbestit ose të artikujve dhe përbërjeve që përmbajnë këto fibra të shtuara qëllimisht.¹⁶
- i. Eksportin e merkurit dhe përbërësve të merkurit, si dhe prodhimin, eksportin dhe importin e një game të gjerë të produkteve që përmbajnë merkur.¹⁷
- j. Veprimtaritë e ndaluara nga legjislacioni i vendit pritës apo konventat ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e burimeve të biodiversitetit ose trashëgimisë kulturore.
- k. Peshkimin me rrjeta lundruese në det duke përdorur rrjeta me gjatësi më të madhe se 2,5 km.
- l. Transportimin e naftës ose të lëndëve të tjera të rrezikshme me anije cisternë që nuk i përmbushin kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare për Lundrimin Detar (IMO).¹⁸
- m. Tregtimin e mallrave pa lejet e nevojshme të eksportit ose të importit apo dëshmi të tjera autorizuese që lejojnë kalimin nga vendet përkatëse të eksportit, importit dhe, nëse ka, të tranzitit.

⁹ PCB-të: Bifenole të poliklorinuara janë një grup lëndësh kimike shumë toksike. PCB-të mund të gjenden në kondensatorët, kabinet dhe transformatorët elektrikë të mbushur me vaj që i përkasin periudhës 1950-1985.

¹⁰ Dokumentet e referencës: Rregullorja nr. 649/2012 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2012, Për Eksportin dhe Importin e disa Lëndëve Kimike të Rrezikshme, e ndryshuar herë pas here; Lista e Konsoliduar e Kombeve të Bashkuara për produktet, konsumi dhe/ose shitja e të cilave është e ndaluara, e eliminuar, rreptësisht e kufizuar ose e pamiruar nga qeveritë; Konventa Mbi Procedurën e Njoftimit të Pëlqimit Paraprak për disa Kimikate të Rrezikshme dhe Pesticide në Tregtinë Ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Klasifikimi i pesticideve sipas rrezikut rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

¹¹ Lëndët ozon-holluese (ODS): përbërës kimikë që reagojnë me ozonin në stratosferë dhe e zbrërtojnë atë, duke shkaktuar atë që gjerësisht njihet si "vrime e ozonit". Në Protokollin e Montrealit për lëndët që hollojnë shtresën e ozonit jepet lista e ODS-ve dhe afati për pakësimin dhe eliminimin gradual të tyre. Lista e përbërësve kimikë që rregullohen nga Protokollin e Montrealit, ku përfshihen aerosolët, lëndët ftohëse, lëndët shkumë-formuese, holluesit dhe lëndët kundër zjarrit, së bashku me të dhënat për vendet nënshkruese dhe afatet për heqjen graduale të tyre, gjendet pranë Programit të Mjedisin të Kombeve të Bashkuara (UNEP).

¹² Dokumentet e referencës: Konventa e Stokholmit për ndotësit organikë të qëndrueshëm (POP) e ndryshuar në vitin 2009.

¹³ CITES: Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër. Lista e llojeve që mbulon CITES gjendet pranë sekretariatit të CITES.

¹⁴ Dokumentet e referencës: Konventa e Bazelit për kontrollin mbi lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre; Rregullorja (KE) nr.1013/2006, datë 14 qershor 2006, për transportimin e mbetjeve; Vendimi C(2001)107/Final i Këshillit të OECD-së për rishikimin e Vendimit C(92)39/Final për kontrollin mbi lëvizjet ndërkufitare të destinuara për rikuperim energjie

¹⁵ "Largimi i detyruar" i referohet veprimeve dhe/ose mosveprimeve që përfshijnë zhvendosjen e detyruar ose të pavullnetshme të përhershme ose të përkohshme të individëve, grupeve dhe komuniteteve nga shtëpitë dhe/ose tokat dhe nga burimet pronë e përbashkët, të cilat ata i posedojnë ose nga të cilat varen, duke eliminuar ose kufizuar në këtë mënyrë mundësinë e individit, grupit ose komunitetit për të banuar apo punuar në një banesë, rezidencë apo vendndodhje të veçantë, pa ofrimin ose aksesin në forma të përshtatshme të mbrojtjes ligjore ose të llojeve të tjera.

¹⁶ Rregullore e Komisionit (BE) 2016/1005 e datës 22 qershor 2016 që ndryshon Shtojcën XVII të Rregullores (KE) Nr. 1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) për sa u përket fibrave të asbestit (krisotile).

¹⁷ Rregullore (BE) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2017 për merkurin.

¹⁸ Certifikata të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det (SOLAS), (duke përfshirë, ndër të tjera, përputhshmërinë me Kodin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Sigurisë), anijet cisternë të futura në listën e zezë nga Bashkimi Evropian ose të ndaluara me Aktmarrëveshjen e Parisit për Kontrollin Shtetëror të Porte ve (Paris MOU) dhe anijet cisternë të destinuara për heqje graduale nga puna sipas rregullores 13G të MARPOL-it. Nuk duhet të përdoret asnjë anije cisternë me skelet tek, me vjetërsi më shumë se 25 vjet.

Shtojca 2: Projektet e Kategorisë A

Kjo listë zbatohet për projektet në formë investimi të ri dhe projektet në formë zgjerimi madhor ose transformim-konvertimi në kategoritë e renditura më poshtë. Llojet e projekteve të renditura më poshtë janë shembuj të projekteve që mund të sjellin ndikime të konsiderueshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen dhe që, për rrjedhojë, kërkojnë një vlerësim të ndikimit mjedisor dhe social. Kategorizimi i secilit projekt varet nga natyra dhe rëndësia e çdo ndikimi aktual ose të mundshëm të padëshirueshëm mjedisor ose social në të ardhmen, sikurse përcaktohet nga veçantitë e natyrës, vendndodhjes, ndjeshmërisë dhe shkallës së projektit.

1. Rafineritë e naftës bruto (me përjashtim të ndërmarrjeve që prodhojnë vetëm lubrifikantë nga nafta bruto) dhe impiantet për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 tonëve ose më shumë shisti qymyror ose bituminoz në ditë.
2. Termocentralet ose impiantet e tjera me djegie të brendshme me fuqi nxehtësie në dalje prej 300 megavat¹⁹ ose më shumë dhe centralet bërthamore e reaktorët e tjerë bërthamorë, përfshi çmontimin ose nxjerrjen nga përdorimi të centraleve të tilla (me përjashtim të impianteve kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e lëndëve të zbërthueshme dhe të konvertueshme, fuqia maksimale e të cilëve nuk është më e madhe se 1 kilovat ngarkesë termale e vazhdueshme).
3. (a) Centralet për ripërpunimin e karburantit me rrezatim nuklear; dhe (b) centralet e projektuara për: (i) prodhimin ose pasurimin e karburantit me rrezatim nuklear; (ii) përpunimin e karburantit me rrezatim nuklear ose mbetjeve me radioaktivitet të lartë; (iii) asgjësimin përfundimtar të karburantit me rrezatim nuklear; (iv) vetëm për asgjësimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive; dhe (v) vetëm për depozitimin (të planifikuar për më shumë se 10 vjet) të karburantit me rrezatim nuklear ose të mbetjeve radioaktive në një zonë të ndryshme nga ajo e prodhimit.
4. Uzinat e integruara për shkrirjen fillestare të gizës dhe të çelikut; impiantet për prodhimin e metaleve bruto me ngjyra nga xeherorët, koncentratet apo lëndët e para dytësore me anë të proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.
5. Impiantet e integruara kimike: impiantet për prodhimin në shkallë industriale të substancave duke përdorur proceset e konvertimit kimik, në të cilat disa agregate janë të instaluar ngjitur me njëri-tjetrin, janë të lidhur funksionalisht me njëri-tjetrin dhe që përdoren për prodhimin e: kimikatet bazë organikë; kimikatet bazë inorganike; plehëruesve (të thjeshtë ose të përbërë) me bazë fosfori, azoti ose potasi; produkteve bazë për shëndetin e bimëve dhe biocideve; produkteve farmaceutike bazë duke përdorur proces kimik ose biologjik; ose lëndëve plasëse.
6. Ndërtimi i rrugëve kombëtare, autostradave dhe linjave të trafikut hekurudhor për distanca të gjata; i aeroporteve me gjatësi bazë piste prej të paktën 2.100 metra; i rrugëve të reja me katër ose më shumë korsi ose ndryshimi i gjurmës dhe/ose zgjerimi i rrugëve ekzistuese që të kenë katër ose më shumë korsi, kur këto rrugë të reja ose segmente rrugore me gjurmë të re dhe/ose të zgjeruara kanë gjatësi të vazhdueshme prej 10 km ose më shumë.
7. Tubacionet me një diametër prej më shumë se 800 mm dhe me gjatësi prej më shumë se 40 km, terminalet dhe strukturat shoqëruese për transportimin në shkallë të madhe të gazit, naftës dhe lëndëve kimike ose për transportimin e rrymave të dioksidit të karbonit për qëllim të depozitimit gjeologjik, duke përfshirë edhe stacionet përforcuese përkatëse.
8. Shesh depozitimet për depozitimin gjeologjik të dioksidit të karbonit.
9. Impiantet për kapjen e CO₂ me qëllim depozitimin gjeologjik, kur kapja vjetore e CO₂ është 1,5 megaton ose më shumë.
10. Portet e mëdha detare si dhe kanalet e brendshme të lundrueshme dhe portet për trafikun e brendshëm ujor; portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkimin të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave për tragetet).
11. Impiantet për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve për djegie, trajtimin kimik ose groposjen e mbetjeve të rrezikshme ose toksike.
12. Impiantet e asgjësimit në shkallë të gjerë të mbetjeve për djegie ose trajtimin kimik të mbetjeve jo të rrezikshme me një kapacitet që tejkalon 100 ton në ditë.
13. Digat²⁰ e mëdha dhe prita të tjera të projektuara për të mbajtur ose depozituar ujë në mënyrë të përhershme, ku një sasi e re apo shtesë e ujit të mbajtur apo të depozituar tejkalon 10 milion metër kub.
14. Veprimtaritë e nxjerrjes së ujërave nëntokësore ose sistemet e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore në rastet kur vëllimi vjetor i ujit që nxirret ose rimbushet arrin 10 milion metra kub ose më shumë.
15. Tubacionet për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve lumore ku ky transferim synon të parandalojë mungesat e mundshme të ujit dhe kur sasia e ujit të transferuar i kalon 100 milion metra kub/vit, ose tubacione për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve lumore kur prurja mesatare shumëvjeçare e basenit të nxjerrjes tejkalon 2.000 milion metra kub/vit dhe kur sasia e ujit të transferuar tejkalon 5 për qind të asaj prurjeje. (Për të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm në tubacione).
16. Fabrikat industriale për: (a) prodhimin e brumit të letrës nga lënda drusore ose lëndë të ngjashme fibroze; (b) prodhimin e letrës dhe kartonit me kapacitet prodhues që i kalon 200 ton në gjendje të thatë në ditë.
17. Guroret dhe minierat ku sipërfaqja e sheshit është më shumë se 25 hektarë, ose nxjerrja e torfës, ku sipërfaqja e sheshit është më shumë se 150 hektarë.
18. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare, kur në rastin e naftës sasia e nxjerrë tejkalon 500 ton/ditë, dhe në rastin e gazit, 500.000 metra kub/ditë.
19. Impiantet për magazinimin e produkteve të naftës, produkteve petrokimike ose kimike me kapacitet 200.000 ton ose më shumë.
20. Prerja e pemëve në shkallë të gjerë ose shpyllëzimi i sipërfaqeve të mëdha.
21. Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura bashkiake me kapacitet më të madh se ekuivalenti 150.000 banorë.
22. Impiantet e asgjësimit dhe përpunimit në shkallë të gjerë të mbetjeve të ngurta bashkiake.

¹⁹ E barasvlershme me të një produkti bruto të energjisë elektrike prej 140 MW për centralet me turbina me avull me cikël të thjeshtë që punojnë me gaz.

²⁰ Komisioni Ndërkombëtar për Digat e Mëdha (ICOLD) e përkufizon digën e madhe si një digë me lartësi prej 15 metrash nga themeli ose më shumë. Edhe digat me lartësi nga 5 deri në 15 metra dhe me vëllim rezervuari më shumë se 3 milion metra kub klasifikohen si diga të mëdha.

23. Ndërtimet turistike dhe tregtare në shkallë të gjerë.
24. Ndërtimi i linjave ajrore të tensionit të lartë.
25. Impiantet për prodhimin në shkallë të gjerë të energjisë elektrike nga era (fermat e erës).
26. Aktivitetet në shkallë të gjerë për bonifikimin dhe gërryerjen e fundit të detit.
27. Bujqësia ose pyllëzimi në shkallë të gjerë, që kërkon intensifikim, ndryshim të përdorimit të tokës ose konvertim të karakteristikave parësore të biodiversitetit dhe/ose të habitateve me rëndësi kritike.
28. Fabrikat për regjen e lëkurëve, me kapacitet trajtimi më të madh se 12 ton produkt i gatshëm në ditë.
29. Impiantet për mbarështimin intensiv të shpezëve ose derrave me më shumë se: (a) 85.000 vende për zogj pule dhe 60.000 vende për pula; (b) 3.000 vende për derra (mbi 30 kg); ose (c) 900 vende për doka.
30. Projektet²¹ që planifikohen për t'u realizuar ose që kanë gjasa të kenë një ndikim të dukshëm, duke përfshirë ndikimin e grumbulluar në kombinim me zhvillime të tjera përkatëse të së shkuarës, të tashmes dhe të parashikueshme, në vendndodhje të ndjeshme me rëndësi ndërkombëtare, kombëtare ose rajonale, edhe nëse kategoria e projektit të mos jetë e përfshirë në këtë listë. Vendndodhje të tilla me ndjeshmëri, ndër të tjera, përfshijnë zonat e mbrojtura natyrore të përcaktuara si të tilla me ligj kombëtar ose ndërkombëtar, habitatet me rëndësi kritike ose ekosistemet e tjera që mbështetin karakteristikat parësore të biodiversitetit, zonat me rëndësi arkeologjike ose kulturore dhe zonat me rëndësi për popujt indigjenë ose popullata të tjera të cënueshme.
31. Projektet që mund të çojnë në ndikime të konsiderueshme sociale për popullata ose grup(e) personash të prekura nga projekti ose që mund të preken nga projekti në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.
32. Projektet që mund të kërkojnë shpërngulje të detyrueshme të konsiderueshme ose zhvendosje ekonomike të konsiderueshme.

²¹ Duke përfshirë, ndër të tjera, projektet me orientim mjedisor ose social (siç janë burimet e energjisë së ujit apo burime të tjera të rinovueshme të energjisë).

Kërkesa e Performancës 1 e BERZH-it: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale

Hyrje

1. Në këtë kërkesë performance (KP) i jepet rëndësi vlerësimit të integruar për të identifikuar rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektet, si dhe menaxhimin që klienti i bën performancës mjedisore dhe sociale gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Një Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social (SMMS) i suksesshëm dhe efikas nxit një performancë bindëse e të qëndrueshme mjedisore dhe sociale, dhe mund të sjellë rezultate të përmirësuara financiare, mjedisore dhe sociale. Ai është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, që e merr nismën dhe mbështetet nga nivelet drejtuese e që kërkon komunikim kuptimplotë midis klientëve, punonjësve dhe komuniteteve vendase të prekura nga projekti dhe/ose veprimtari të tjera të klientit dhe, sipas rastit, edhe palët e tjera të interesit.
2. Kjo kërkesë performance përcakton përgjegjësitë e klientit në procesin e vlerësimit të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale dhe të hartimit e zbatimit të procedurave për menaxhimin dhe monitorimin e këtyre rreziqeve dhe ndikimeve.

Objektivat

3. Objektivat e kësaj kërkesë performance janë:
 - identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore të projektit;
 - adoptimi i qasjes së hierarkisë së masave zbutëse për të adresuar rreziqet dhe ndikimet mjedisore ose sociale për punonjësit, komunitetet e prekura dhe mjedisin si rezultat i veprimtarive të projektit;
 - zhvillimi i një SMMS-je të përshtatur me shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale në përputhje me kërkesat përkatëse të performancës; dhe
 - promovimi i përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore dhe sociale të klientëve përmes përdorimit të efektshëm të sistemeve të menaxhimit.

Fusha e zbatimit

4. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet e financuara nga BERZH-i, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të kësaj KP-je dhe mënyrën si do të trajtohen dhe menaxhohen përmes projektimit, ndërtimit, operimit, nxjerrjes nga puna ose mbylljes, si dhe rikthimit në gjendjen e mëparshme.

5. Projektet që përfshijnë veprimtari tregtare ose struktura të reja do të projektohen në mënyrë të atillë që t'i përbushin që në fillim kërkesat e performancës. Nëse një projekt përfshin modernizimin apo përmirësimin e veprimtarive ose strukturave ekzistuese që nuk i përbushin kërkesat e performancës në momentin e miratimit nga Bordi i Drejtorëve, apo i organit vendimmarrës të BERZH-it, ose nëse projekti nuk përbush KP-të që në fillim, klienti duhet të zbatojë një plan veprimi mjedisor dhe social (PVMS) i cili do të përbajë një sërë masash tekniko dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive për të arriturur përputhshmërinë e këtyre veprimtarive ose strukturave me kërkesat e performancës brenda një afati kohor të pranueshëm për BERZH-in. Në PVMS, Banka dhe klienti do të bien dakord për veprimet konkrete korrigjuese dhe parandaluese, masat zbutëse dhe afatin e realizimit që klienti do të zbatojë për menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit në përputhje me KP-të. PVMS-ja do të jetë pjesë e kontratave të financimit dhe do të përfshijë, sipas rastit, detyrimet e klientit në mbështetje të zbatimit të PVMS-së.
6. Rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të strukturave shoqëruese do të përfshihen në procesin e vlerësimit të rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale. Klientët duhet të garantojnë që rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe/ose sociale të shkaktuara nga strukturat shoqëruese menaxhohen dhe zbuten në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, PMN-në dhe objektivat e KP-ve.
7. Aty ku identifikohen rreziqe dhe ndikime të mundshme të konsiderueshme mjedisore dhe/ose sociale nga strukturat ose veprimtari të tjera në afërsi të projektit, strukturat ekzistuese dhe strukturat ose veprimtaritë jashtë kontrollit të klientit, për të cilat KP-të nuk zbatohen, klienti do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të vlerësuar dhe zbutur rreziqet ndaj projektit.
8. Angazhimi me palët e interesit të projektit është një pjesë përbërëse e këtij projekti. Kërkesat lidhur me angazhimin e palëve të interesit përvijohen në KP 10.

Kërkesat

Vlerësimi Mjedisor dhe Social

9. Vlerësimi mjedisor dhe social i klientit do të marrë parasysh rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektin. Kur një projekt përfshin struktura apo veprimtari tregtare ekzistuese, dhe/ose struktura shoqëruese, vlerësimi mjedisor dhe social i klientit do të marrë parasysh rreziqe dhe ndikime mjedisore dhe sociale të lidhura me këto struktura dhe veprimtari. Prosesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të mbështetet në informacionet më të fundit, dhe të dhënat bazë mjedisore dhe sociale, duke përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë, në një nivel të përshtatshëm detajesh. Prosesi i vlerësimit duhet të identifikojë edhe: (i) aktet e zbatueshme ligjore dhe nënligjore mjedisore dhe sociale të territorit ku ushtron aktivitet projekti, përfshi edhe ato akte ligjore ku zbatohen detyrimet e vendit pritës të cilat rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare; dhe (ii) kërkesat e zbatueshme të kërkesave të performancës. Në thelb të kësaj qasjeje është zbatimi i hierarkisë së hapave zbutëse dhe praktikës së mirë ndërkombëtare.

10. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social do të identifikojë dhe karakterizojë, në masën e duhur, rreziqet dhe ndikimet kumulative të projektit që lidhen me rreziqet dhe ndikimet nga zhvillime të tjera të së shkuarës, të tashmes dhe të parashikueshme, si dhe veprimtari të paplanifikuara por të parashikueshme të mundësuar nga projekti që mund të realizohet më vonë ose në një vend tjetër.
11. Për projekte që mund të kenë ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe sociale, klienti duhet të identifikojë, si pjesë tërësore të procesit të vlerësimit, palët e interesuara të projektit dhe të hartojë një plan për angazhimin e palëve të interesit në mënyrë të plotë për të marrë në konsideratë vendimet dhe shqetësimet e tyre gjatë planifikimit, zbatimit dhe funksionimit të projektit në përputhje me KP 10. Procesi i identifikimit të palëve të interesit do të evidentojë çdo person që mund të ndikohet nga projekti në mënyrë joproporcionale. Do të hartohen dhe zbatohen masa zbutëse në mënyrë që personat e cenueshëm mos të preken në mënyrë joproporcionale.
12. Procesi i vlerësimit duhet të jetë proporcional si dhe në përpjesëtim të drejtë me rreziqet dhe ndikimet e mundshme të projektit dhe duhet të mbulojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha rreziqet dhe ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore dhe sociale të projektit dhe fazat përkatëse të ciklit të projektit. Gjatë procesit të vlerësimit do të merren parasysh edhe çështjet gjinore dhe rreziqet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike për projektin. Mund të duhet që klienti ta plotësojë vlerësimin e tij mjedisor dhe social me studime të mëtejshme që përqendrohen tek rreziqet dhe ndikimet specifike, siç janë të drejtat e njeriut. Vlerësimi do të evidentojë dhe analizojë edhe mundësi për përmirësim.
13. Për projekte komplekse apo kontroverse, ose që përfshijnë rreziqe dhe ndikime të mundshme mjedisore dhe sociale të konsiderueshme e shumëplanëshe, klienti duhet të angazhojë një ose më shumë ekspertë të pavarur të njohur ndërkombëtarisht. Në varësi të projektit, këta ekspertë do të formojnë një panel këshillimor ose do të kontraktohen nga klienti për të ofruar këshillim dhe mbikëqyrje të pavarur nga projekti.
14. Një projekt i përket kategorisë A nëse do të sillte ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale të konsiderueshme në të ardhmen, duke përfshirë ndikime të drejtpërdrejta apo kumulative të cilat, në momentin e kategorizimit janë të reja dhe shtesë, dhe nuk mund të identifikohen ose të analizohen lehtë. Projektet e kategorizuara si A kërkojnë një proces të formalizuar dhe me pjesëmarrje në vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social (VNMS). VNMS duhet të përfshijë një shqyrtim të arsyeshëm, lidhur me vendndodhjen, teknologjinë, përmasat, shkallën dhe projektimin, mundësitë e masave zbutëse dhe alternativën sikur të mos kishte projekt. Një listë e projekteve të Kategorisë A paraqitet në Shtojcën 2 bashkëlidhur kësaj Politike.
15. Një projekt i përket kategorisë B nëse ndikimet e mundshme mjedisore dhe/ose sociale zakonisht janë specifike për vendndodhjen dhe/ose identifikohen dhe trajtohen përmes masave zbutëse të efektshme. Objekti i vlerësimit mjedisor dhe social do të përcaktohet nga BERZH-i rast pas rasti.
16. Një projekt i përket kategorisë C nëse me shumë gjasa ka pak ose aspak ndikime të mundshme negative mjedisore dhe/ose sociale.

17. Në rastet kur klientët me aktivitete në disa zona kërkojnë financim të përgjithshëm të shoqërisë tregtare ose financim të kapitalit, vlerësimi i parashikuar nga pika 9 deri te 15 nuk mund të jetë i përshtatshëm. Në këto raste, sistemi aktual i menaxhimit mjedisor dhe social i klientit dhe performanca e shkuar dhe ajo aktuale e tij vlerësohen nga Banka kundrejt kërkesave përkatëse të performancës dhe përgatitet e zbatohet një VNMS për menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale në nivel korporate. Mund të merren në konsideratë veprime specifike për zonën.

Sistemet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social

18. Klientëve u kërkohet të vendosin dhe të mbajnë një sistem menaxhimi mjedisor dhe social (SMMS) sipas natyrës dhe shkallës së projektit, në proporcion me nivelin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Objektivi i një sistemi të tillë menaxhimi është integrimi i zbatimit të kërkesave mjedisore dhe sociale në një proces të thjeshtuar dhe të bashkërenduar dhe përfshirja e tij në veprimtaritë kryesore operative të klientit.

Politika Mjedisore dhe Sociale

19. Klienti duhet të zhvillojë, sipas rastit, një politikë gjithëpërfshirëse ku përcaktohen objektivat dhe parimet mjedisore dhe sociale të cilat mundësojnë që projekti të arrijë një performancë të shëndoshë mjedisore dhe sociale. Politika duhet të sigurojë kuadrin për procesin e vlerësimit dhe të menaxhimit mjedisor dhe social në përputhje me parimet e kërkesave të performancës.

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

20. Duke marrë në konsideratë konstatimet e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social dhe rezultatet e angazhimit të palëve të interesit, klienti do të hartojë dhe të zbatojë një program veprimesh për të trajtuar rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të identifikuara të projektit dhe masa të tjera të përmirësimit të performancës për të përmbushur KP-të. Në varësi të projektit, programi mund të përfshijë një ndërthurje të politikave operative të dokumentuara, sistemeve të menaxhimit, procedurave, planeve, praktikave dhe investimeve kapitale, bashkërisht të quajtura Plane të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS).
21. PMMS-ja duhet të pasqyrojë hierarkinë e hapave zbutëse dhe, kur është e realizueshme teknikisht dhe financiarisht, të favorizojë shmangien dhe parandalimin e ndikimeve kundrejt minimizimit, zbutjes apo kompensimit, dhe të sigurojë që të gjitha fazat përkatëse të projektit të strukturohen në mënyrë të atillë që të përmbushin kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore dhe KP-të.
22. Kur individët ose grupet e prekura identifikohen gjatë procesit të vlerësimit paraparak të projektit si individë ose grupe të cenueshme ose të disavantazuar, PMMS-ja duhet të përfshijë masa të diferencuara, në mënyrë që ndikimet e padëshirueshme të mos bien mbi ta në mënyrë jo proporcionale dhe ata të mund të marrin përparësi nga mundësitë për të përfituar nga projekti.
23. Niveli i detajeve dhe i kompleksitetit të PMMS-së duhet të jetë në proporcion me rreziqet dhe ndikimet e projektit, duke trajtuar rreziqet, ndikimet si dhe mundësitë për përmirësimin e projektit. PMMS-ja duhet të përcaktojë rezultatet e dëshiruara si ngjarje të matshme, për aq sa është e mundshme, me elemente të tilla si plani dhe treguesit e performancës që mund të gjurmohen gjatë periudhës së përcaktuar. Duke pranuar natyrën dinamike të procesit të përgatitjes dhe të zbatimit të projektit, PMMS-të duhet t'iu përgjigjen ndryshimeve në rrethanat e projektit, ngjarjeve të paparashikuara, ndryshimeve rregullatore dhe rezultateve të monitorimit e shqyrtimit dhe të përditësohen herë pas here.

Angazhimi dhe kapaciteti organizativ

24. Klienti duhet të krijojë, të mbajë dhe të fuqizojë, sipas nevojës, një strukturë organizative e cila përcakton rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin për vënien në zbatim të SMMS-së, për të siguruar përmbushjen në vazhdimësi të kërkesave rregullatore përkatëse kombëtare dhe të kërkesave të performancës. Klienti duhet të caktojë personel të posaçëm, duke përfshirë përfaqësuesin(t) e drejtuesve, me hierarki të qartë përgjegjësie dhe autoriteti për të mbajtur dhe zbatuar SMMS-në. Përgjegjësitë kryesore mjedisore dhe sociale duhet të përcaktohen dhe t'u komunikohen punonjësve përkatës. Klienti do të ofrojë mbështetjen e duhur dhe burimet njerëzore dhe financiare në mënyrë të vazhdueshme për të arritur një performancë të efektshme dhe të vazhdueshme mjedisore dhe sociale.
25. Klienti duhet të sigurojë që punëmarrësit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtaritë që lidhen me performancën mjedisore dhe sociale të projektit të jenë të kualifikuar dhe të trajnuar.

Rreziku i Palëve të Treta

26. SMMS-ja, duke përfshirë kërkesat dhe veprimet specifike që parashtrohen, do të zbatohet për projektin pavarësisht nëse projekti realizohet drejtpërsëdrejti nga klienti apo përmes palëve të treta.
27. Është përgjegjësi e klientit të sigurojë që kontraktorët që punojnë në zonat e projektit të përmbushin kërkesat e SMMS-së duke adaptuar dhe zbatuar një sistem të përshtatshëm të menaxhimit të kontraktorit. Menaxhimi efektiv i kontraktorit përfshin:
 - vlerësimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale të lidhura me punimet dhe shërbimet e kontraktuara dhe përfshirjen e kushteve përkatëse të PMMS-së në dokumentet e tenderit sipas rastit, duke u kërkuar kontraktorëve të zbatojnë këto standarde dhe të ofrojnë masa zbutëse dhe/ose korrigjuese në rast mosrespektimi;
 - mbikëqyrjen që kontraktorët të kenë njohuritë dhe aftësitë për të kryer detyrat e tyre të projektit në përputhje me kushtet kontraktuale mjedisore dhe sociale;
 - monitorimin e përputhshmërisë së kontraktorit me kushtet kontraktuale mjedisore dhe sociale; dhe
 - në rastin e nënkontraktimit, që kontraktorët të kenë marrëveshje të barasvlershme mjedisore dhe sociale të lidhura me nënkontraktorët e tyre.

28. Klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të identifikuar rreziqet që lidhen me furnitorët e tij parësor²². Çdo masë dhe/ose masë zbutëse e identifikuar gjatë kontrollit të të dhënave duhet të përfshihet, aty ku është e përshtatshme, në PMMS. Kur klienti mund të ushtrojë në mënyrë të arsyeshme kontroll mbi furnitorët parësorë të tij, procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të marrë në konsideratë edhe nëse zinxhirët e furnizimit parësor janë apo jo të lidhur me rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale. Nëse është kështu, klienti duhet të miratojë dhe të zbatojë një sistem të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit në përjesëtim me kompleksitetin e tyre dhe rreziqeve dhe ndikimeve përkatëse mjedisore dhe sociale, përshtatur sipas natyrës dhe shkallës së projektit. Sistemi i menaxhimit duhet të përfshijë proceset për të vepruar me qëllim adresimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të identifikuar gjatë vlerësimit të zinxhirit të furnizimit apo gjatë monitorimit të vazhdueshëm, duke marrë parasysh: (a) faktin nëse ka qenë apo jo klienti ai që i ka shkaktuar problemet apo ka ndikuar tek to; (b) fuqinë ndikuese që ka klienti tek furnitori; (c) sa kritike është kjo marrëdhënie për klientin; (d) sa të rënda janë rreziqet dhe ndikimet; dhe (e) nëse zgjidhja e marrëdhënies me furnitorin do të kishte apo jo në vetvete pasoja të padëshirueshme. Kërkesat për standardet e punës në zinxhirin e furnizimit parashtrohen në KP2; kërkesat për zinxhirin e furnizimit për burimet natyrore përcaktohen në KP6.

Monitorimi dhe raportimi i projektit

29. Klienti duhet të monitorojë performancën mjedisore dhe sociale të projektit. Ky monitorim synon: (i) konstatimin nëse projekti po zbatohet apo jo në përputhje me KP-të; dhe (ii) marrjen e mësimeve, alokimin e burimeve dhe identifikimin e mundësive për përmirësim të vazhdueshëm.
30. Kërkesat e monitorimit duhet të jenë në proporcion me natyrën e projektit dhe me rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të tij. Monitorimi do të adresoj:
 - çdo rrezik dhe ndikim të konsiderueshëm mjedisor dhe social të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social;
 - pjesët përkatëse të kërkesave të performancës të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit të projektit dhe gjatë monitorimit pasues;
 - veprimet e përcaktuara në PMMS ose PVMS;
 - ankesat që vijnë nga punonjësit dhe palët e jashtme të interesit dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
 - çdo kërkesë rregullatore për monitorimin dhe raportimin; dhe
 - çdo monitorim dhe raportim të kërkuar nga palë të tjera (për shembull, blerësit e burimeve, financuesit apo organet certifikuese).

²² Furnitorët parësor janë ata furnitorë të cilët, në mënyrë të vazhdueshme, ofrojnë drejtpërdrejt mallra ose materiale thelbësore për funksionet operacionale bazë të projektit. Funksionet operacionale bazë të projektit janë ato procese prodhimi dhe/ose shërbimi që janë thelbësore për veprimtari specifike të projektit dhe pa të cilat projekti nuk mund të vazhdojë.

31. Klienti duhet të sigurojë që për kryerjen e monitorimit janë ngritur dhe funksionojnë sisteme, burime dhe personeli i duhur. Klienti duhet të shqyrtojë rezultatet e monitorimit dhe të fillojë veprimet korrigjuese, sipas nevojës. Krahas kësaj, klienti mund të përdorë palë të treta, siç janë ekspertët e pavarur, komunitetet vendase ose organizatat e shoqërisë civile, për ta plotësuar ose verifikuar informacionin e vet monitorues. Kur autoritetet përkatëse ose palë të treta kanë përgjegjësi për menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve të veçanta dhe masave përkatëse zbutëse, klienti duhet të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse ose palë të tjera të treta për vendosjen dhe monitorimin e masave të tilla zbutëse.
32. Klienti duhet t'i paraqesë BERZH-it raporte të rregullta për performancën mjedisore dhe sociale të projektit, përfshi përbushjen e kërkesave të performancës dhe zbatimin e SMMS-së, PMMS-së, PVMS-së dhe Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit, sipas rastit. Mbështetur në rezultatet e monitorimit, klienti duhet të identifikojë dhe të pasqyrojë çdo veprim korrigjues dhe parandalues të nevojshëm në një PMMS ose PVMS, me miratimin e BERZH-it. Klienti duhet të zbatojë veprimet e miratuara korrigjuese dhe parandaluese dhe t'i ndjekë në vazhdimësi këto veprime për të përmirësuar performancën e tyre.
33. Klienti duhet t'i njoftojë menjëherë BERZH-it çdo incident ose aksident mjedisor ose social që ka lidhje me klientin ose me projektin dhe që ka, apo ka të ngjarë të ketë një ndikim të konsiderueshëm të padëshirueshëm.
34. Klienti duhet t'i njoftojë menjëherë BERZH-it çdo ndryshim të qëllimit të projektit, të projektit apo të funksionimit të tij që ka të ngjarë t'i ndryshojë në mënyrë materiale rreziqet dhe ndikimet e tij mjedisore ose sociale. Klienti duhet të kryejë çdo vlerësim tjetër shtesë dhe të angazhojë palët e interesit në përputhje me kërkesat e performancës dhe të ndryshojë PMMS-në ose PVMS-në sikurse është rënë dakord me BERZH-in.
35. Për projekte që mund të kenë rreziqe dhe ndikime të konsiderueshme të padëshirueshme mjedisore dhe sociale, klientit mund t'i kërkohet të angazhojë ekspertë të jashtëm për të kryer shqyrtime të pavarura periodike të projektit ose për të kryer monitorimin e rreziqeve dhe ndikimeve të veçanta mjedisore ose sociale. Objekti i kësaj pune dhe i veprimeve pasuese përcaktohet rast pas rasti.

Hyrje

1. Kjo kërkesë performance pranon se për klientët dhe veprimtaritë tregtare të tyre, fuqia punëtore është një pasuri e çmuar dhe se menaxhimi i mirë i burimeve njerëzore dhe një marrëdhënie e mirë punonjës-drejtuës, bazuar tek respekti për të drejtat e punonjësve, duke përfshirë lirinë e asociimit dhe të drejtën për marrëveshje kolektive, janë përbërësit kyç të qëndrueshmërisë së veprimtarive tregtare.

Objektivat

2. Objektivat e kësaj kërkesë performance janë:
 - respektimi dhe mbrojtja e parimeve dhe të drejtave themelore²³ të punëtorëve;
 - garantimi i trajtimit të drejtë, mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta për punonjësit në përputhje me programin e denjë të punës²⁴;
 - vendosja, ruajtja dhe përmirësimi i një marrëdhënieje të shëndoshë punonjës-drejtuës;
 - garantimi i përputhshmërisë me legjislacionin kombëtar për punën dhe punësimin dhe çdo marrëveshjeje kolektive në të cilën klienti është palë;
 - mbrojtja e grave dhe burrave në punë, duke përfshirë punonjësit e cenusur siç janë punonjësit në moshë të re, persona me aftësi të kufizuara, punonjës emigrantë dhe refugjatë, punonjësit të kontraktuar nga palët e treta, dhe punonjësit e zinxhirit të furnitorëve të klientit;
 - parandalimi i përdorimit të punës së detyruar dhe punës së fëmijëve (sipas përkufizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO-s)); dhe
 - garantimi i mjeteve të aksesueshme dhe efektive për të ngritur dhe adresuar shqetësime lidhur me punën, të disponueshme për punëtorët.

Fusha e zbatimit

3. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet e financuara nga BERZH-i, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale. Fusha e zbatimit e kësaj KP do të përcaktohet gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social dhe varet nga lloji i marrëdhënieve kontraktuale midis klientit dhe punonjësve të projektit.

²³ Sipas udhëzimeve të Konventave themelore të ILO-s:

C087 Për lirinë e asociimit dhe mbrojtjen e të drejtës së organizimit (1948) C098 Për të drejtën e organizimit dhe marrëveshjet kolektive (1949) C029 Për punën e detyruar (1930) dhe protokollet shtesë P029 (2014) C105 Për eliminimin e punës së detyruar (1957) C100 Për pagesë të barabartë (1951) C111 Për diskriminimin (Punë dhe Profesione) (1958) C138 Për rrogën minimale (1973) C182 Për format më të këqija të punës së fëmijëve (1999)

4. Kjo KP përcakton kërkesat për klientët në lidhje me të gjithë punonjësit e projektit, duke përfshirë punonjësit me kohë të plotë, me kohë të pjesëshme, të përkohshëm, me afat të caktuar, sezonal dhe emigrantë, edhe kur janë të punësuar drejtpërdrejt nga klienti ose nga një palë e tretë, dhe përcakton kërkesa specifike për furnitorët parësorë. Punonjësit e projektit janë ata që punojnë në zonën e projektit ose kryejnë punë të lidhur drejtpërdrejt me funksionet bazë të projektit.
5. Kërkesat e KP-së që zbatohen për punonjës jo-punëmarrës²⁵ përcaktohen në pikat 22-24 të kësaj KP-je. Kërkesat e punës të lidhura me zinxhirin e furnizimit trajtohen në pikat 25-27 të kësaj KP-je.
6. Kërkesat e shëndetit, sigurisë dhe sigurimit në punë parashikohen në KP4.

Kërkesat

Të Përgjithshme

7. Projekteve u kërkohet të respektojnë, minimalisht, (i) legjislacionin kombëtar të punës, të sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit e sigurisë në punë dhe (ii) parimet dhe standardet themelore të mishëruara në konventat e ILO-s, dhe (iii) këtë kërkesë performance.

Menaxhimi i marrëdhënieve me punonjësit

Politikat e Burimeve Njerëzore

8. Klienti duhet të miratojë dhe/ose të mbajë politika dhe sisteme ose procedura menaxhimi të burimeve njerëzore në përputhje me madhësinë dhe numrin e punonjësve të tij, ku të parashtrohet qasja e ndjekur për menaxhimin e fuqisë punëtore në përputhje me kërkesat e kësaj kërkesë të performancës dhe me legjislacionin kombëtar. Këto politika dhe procedura duhet të jenë të kuptueshme, të aksesueshme dhe t'u komunikohen punonjësve në gjuhën ose gjuhët kryesore që flasin ata.

Marrëdhëniet e punës

9. Klienti do t'u sigurojë punonjësve kontrata me shkrim në fillim të marrëdhënies së punës dhe kur ndodh ndonjë ndryshim material në termat ose kushtet e punësimit, duke përfshirë marrëdhënien e punës me klientin. Kontrata do të përcaktojë të drejtat e tyre sipas legjislacionit kombëtar për punën dhe punësimin dhe çdo marrëveshje kolektive të zbatueshme në lidhje me kushtet e punës dhe kushtet e punësimit (duke përfshirë pagën, orarin e punës, rregullimet dhe kompensimin për punën jashtë orarit), si dhe çdo përfitim (si leja shëndetësore, leja e barrë-lindjes ose leja vjetore). Çdo ndryshim material do të dokumentohet dhe do t'u bëhet e ditur punonjësve. Ky informacion duhet të jetë i kuptueshëm dhe aksesueshëm për punonjësit, dhe i disponueshëm në gjuhë(t) kryesore të folura nga punonjësit. Sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të garantojnë përditësimin e të dhënave duke respektuar të drejtën e punonjësve për jetë private dhe për mbrojtjen e të dhënave.

²⁴ Puna e denjë përmblendh aspiratat e njerëzve gjatë viteve të punës. Ajo përfshin mundësi për të bërë punë produktive dhe që realizon të ardhura të drejta, ofron siguri në qendrën e punës dhe mbrojtje sociale për familjet, perspektivë më të mirë për zhvillim vetjak dhe integritim social, liri që njerëzit të shprehin shqetësimet e tyre, të organizohen dhe të marrin pjesë në vendimet që u prekin jetën dhe barazi në mundësi dhe trajtim për të gjithë gratë dhe burrat.

²⁵ 'Punonjësit jo-punëmarrës' janë punonjës në projekt të cilët nuk janë punësuar drejtpërdrejt nga klienti, por nga palë të treta siç janë kontraktorët, agjentët, ndërmjetësuesit apo të tjerë.

10. Komunikimi duhet menaxhuar me qëllim që punonjësit të kenë: (i) informacionin e duhur për ndryshimet që mund të prekin ata, në veçanti për ndryshimet e pritshme lidhur me projektin dhe (ii) mundësinë për të dhënë komente në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, duke përfshirë mënyrën e paraqitjes së ankesave, sikurse përshkruhet në pikën 21 të kësaj KP-je.

Puna e fëmijëve

11. Klienti do të përbushë të gjitha kërkesat e akteve ligjore përkatëse kombëtare ose standardet ndërkombëtare të punës në lidhje me punësimin e të miturve, cilido prej tyre ofron shkallën më të lartë të mbrojtjes për fëmijët.
12. Klienti nuk duhet të punësojë fëmijë për qëllime shfrytëzimi ekonomik apo që të jetë e rrezikshme ose të cenojë arsimimin e fëmijës ose të jetë e dëmshme për shëndetin apo zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror të fëmijës. Të rinjtë nën moshën 18 vjeç duhet të identifikohen nga klienti dhe nuk duhet të punësohen për të kryer punë të rrezikshme. E gjithë puna e personave nën moshën 18-vjeçare duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të duhur të rreziqeve dhe një monitorimi të rregullt të shëndetit, kushteve të punës dhe orarit të punës.

Puna e Detyruar

13. Klienti nuk duhet të përdorë punë të detyruar, e cila konsiston në punë apo shërbime të kryera jo me vullnet të lirë e të marra me forcë nga një individ, nën kërcënimin e dhunës ose të gjobës, si dhe praktikave mashtruese të punësimit. Kjo përfshin punën e pavullnetshme dhe të detyruar, siç është ajo me kontratë borxhi, puna e detyruar në burg, me detyrim ose rregullime të ngjashme të marrjes në punë, apo siç është puna e personave të trafikuar²⁶.

Mosdiskriminimi dhe mundësitë e barabarta

14. Projektet do të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse për mosdiskriminimin në lidhje me punësimin. Në veçanti, lidhur me projektin, klienti:
- nuk duhet të marrë vendime punësimi në bazë të karakteristikave personale që nuk kanë lidhje me kërkesat e vetvetishme të vendit të punës, siç janë përkatësia gjinore, racore, shtetësia, bindjet politike, përkatësia në një sindikatë, origjina etnike, shoqërore apo indigjene, feja apo besimi, gjendja civile ose familjare, aftësitë e kufizuara, moshë, orientimi seksual apo identiteti gjinor;
 - duhet ta mbështesë marrëdhënien e punës tek parimi i mundësive të barabarta dhe i trajtimit të drejtë dhe nuk duhet të bëjë dallime në lidhje me të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës, duke përfshirë rekrutimin dhe marrjen në punë, caktimin e vendit të punës, kompensimin (duke përfshirë pagat dhe përfitimet), kushtet e punës dhe të punësimit, duke përfshirë përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara, akses në trajnim, ngritjen në detyrë, ndërprerjen e marrëdhënies të punës ose daljen në pension, dhe disiplinimin;
 - duhet të marrë masa për të parandaluar dhe trajtuar çdo formë të dhunës dhe ngacmimit, bullizimit,

shtrëngimit dhe/ose shfrytëzimit, si dhe çdo lloj forme të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ)²⁷.

Masat e mëposhtme nuk konsiderohen diskriminim: masat e posaçme të mbrojtjes ose të ndihmës për t'i dhënë zgjidhje veprimeve diskriminuese të së shkuarës; nxitja e mundësive vendore për punësim; ose përzgjedhja për një vend të caktuar pune në bazë të kërkesave të vetvetishme të vendit të punës, të cilat janë në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Organizatave e punonjësve

15. Klienti duhet të informojë punonjësit se ata kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësuesit e punonjësve, të formojnë ose t'u bashkohen sindikatave që ata dëshirojnë dhe të marrin pjesë në negociatat kolektive, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Klienti nuk duhet të diskriminojë apo të marrë masa kundër punonjësve të cilët veprojnë si përfaqësues, marrin pjesë apo kërkojnë të marrin pjesë në organizata të tilla apo në negociatat kolektive, si dhe nuk do të ndërhyjë në formimin apo funksionimin e organizatave të punonjësve. Klienti duhet t'i angazhojë këta përfaqësues apo organizata të punonjësve në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe t'u japë informacionet e nevojshme për negociatën të plotë brenda kohës së duhur. Kur legjislacioni kombëtar e kufizon ndjeshëm ngritjen ose funksionimin e organizatave të punonjësve, klienti duhet të ngrejë një proces të pavarur për punonjësit që këta të shprehin ankesat e tyre dhe të mbrojnë të drejtat e tyre lidhur me kushtet e punës dhe termat e punësimit, sipas madhësisë së klientit dhe numrit të punonjësve. Klienti nuk do të përpiqet që të influencojë apo kontrollojë këto mekanizma. Kur nuk parashikohet shprehimisht në legjislacionin kombëtar, klienti nuk duhet të shkurajojë punonjësit për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre, formuar organizata të punonjësve apo për tu anëtarësuar në organizata të punonjësve, sipas dëshirës së tyre apo sipas negociatave kolektive dhe nuk duhet të diskriminojë apo të hakmerret kundër punonjësve të cilët marrin pjesë apo kërkojnë të marrin pjesë në organizata të tilla apo në negociatat kolektive. Klienti duhet t'i angazhojë këta përfaqësues apo organizata të punonjësve dhe t'u japë informacionet e nevojshme për negociatën të plotë brenda kohës së duhur.

Pagat, përfitimet dhe kushtet e punës

16. Pagat, përfitimet dhe kushtet e punës që ofrohen (duke përfshirë edhe orarin e punës), në përgjithësi duhet të jenë të paktën të krahasueshme me ato që ofrojnë punëdhënësit e të njëjtit nivel në vendin/rajonin përkatës dhe në sektorin në fjalë. Puna përtej orarit do të kryhet në mënyrë vullnetare dhe do të kompensohet në përputhje me legjislacionin kombëtar.
17. Kur klienti është palë e një kontrate kolektive apo është objekt i një kontrate të tillë, kjo kontratë duhet të respektohet. Kur nuk ka kontrata të tilla ose kur këto kontrata nuk i trajtojnë kushtet e punës dhe termat e punësimit, klienti duhet të ofrojë kushte pune dhe terma punësimi të arsyeshme në përputhje me legjislacionin kombëtar.

²⁶ Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet si rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, përmes kërcënimit ose përdorimit të dhunës ose formave të tjera të bindjes me forcë, të rrëmbimit të personave, të mashtrimit, të futjes në kurth, të shpërdorimit të pushtetit apo të një pozite të pambrojtur ose të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka nën kontroll një person tjetër me qëllim shfrytëzimin. Gratë dhe fëmijët janë veçanërisht të prekur nga fenomeni i trafikimit.

²⁷ "Dhuna dhe ngacmimi" duhet të kuptohet si një vazhdimësi e sjelljeve dhe praktikave të papranueshme, apo kërcënimeve të tyre, qoftë një dukuri e vetme apo e përsëritur, që kanë për qëllim të shkaktojnë lëndim fizik, psiko-social apo ekonomik, duke përfshirë DHBGJ-në. DHBGJ është një term i përgjithshëm për çdo veprim lëndues të kryer kundër vullnetit të një personi, dhe që bazohet në dallime të vendosura nga shoqëria. Ajo përfshin akte që shkaktojnë lëndim ose vuajtje fizike, mendore, ose seksuale, kërcënimin me këto akte, detyrimin dhe kufizime të tjera të lirisë.

18. Klienti duhet të identifikojë punonjësit migrantë dhe të sigurojë që këta të angazhohen me terma dhe kushte kryesisht të ngjashme si të punonjësve jo migrantë që kryejnë të njëjtën punë.

Akomodimi i punonjësve

19. Kur një klient u siguron akomodim punonjësve të projektit, klienti duhet të vendosë dhe zbatojë politika që rregullojnë cilësinë dhe menaxhimin e akomodimit dhe ofrimit të shërbimeve. Shërbimet e akomodimit do të ofrohen në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare dhe me parimet e mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta, duke përfshirë mbrojtjen kundrejt ngacmimit seksual dhe formave të tjera të DHBGJ-së. Liria e lëvizjes së punonjësve drejt vendit të akomodimit të siguruar nga punëdhënësi nuk do të kufizohet në mënyrë të paarsyeshme.

Shkurtimet kolektive

20. Përpara zbatimit të shkurtimeve kolektive²⁸ në lidhje me projektin, klienti duhet të kryejë një analizë të alternativave ndaj shkurtimit të planifikuar të fuqisë punëtore. Nëse analiza nuk eidenton alternativa të realizueshme, klienti do të hartojë dhe zbatojë një plan shkurtimesh kolektive për të vlerësuar, zvogëluar dhe zbutur ndikimet e padëshirueshme të pakësimit të fuqisë punëtore tek punonjësit, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe PMN-në dhe duke u mbështetur në parimet e mosdiskriminimit dhe konsultimit. Procesi i përzgjedhjes do të jetë transparent, bazuar në kritere të drejta, objektive, dhe të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme, si dhe objekt i një mekanizmi efektiv ankesash. Klienti do të përbushë të gjitha kërkesat ligjore dhe të miratuara kolektivisht në lidhje me shkurtimin kolektiv nga puna, duke përfshirë njoftimin e autoriteteve publike dhe dhënien e informacionit dhe konsultimin me punonjësit dhe organizatat e tyre. Plani përfundimtar i shkurtimeve kolektive do të pasqyrojë rezultatet e konsultimeve me punonjësit dhe organizatat e tyre. Të gjitha pagat e prapambetura, përfitimet e sigurimeve shoqërore dhe kontributet e përfitimet e pensioneve u paguhen punonjësve: (i) përpara ose në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës; (ii) sipas rastit, në momentin e rënë dakord me punonjës; ose (iii) pagesa do të bëhet në përputhje me afatin kohor të miratuar me një kontratë kolektive. Kur pagesat kryhen për përfitimin e punonjësve, ata do të pajisen me dëshminë e kryerjes së këtyre pagesave. Klienti do të njoftojë paraprakisht BERZH-in për reduktimin e planifikuar të fuqisë punëtore dhe, kur kërkohet nga BERZH-i, një kopje të planit të propozuar për shkurtimet kolektive.

Mekanizmi i ankesave

21. Klienti duhet të ofrojë një mekanizëm të efektshëm për ankesat e punonjësve (dhe të organizatave të tyre, kur këto ekzistojnë), përmes të cilit ata të ngrënë shqetësime për vendin e punës. Klienti duhet t'i informojë punonjësit për mekanizmin e ankesave në momentin e marrjes në punë dhe ta bëjë atë lehtësisht të aksesueshëm. Mekanizmi duhet të përfshijë një nivel të duhur të menaxhimit dhe të adresojë menjëherë shqetësimet, duke përdorur një proces të kuptueshëm dhe transparent, i cili jep informacion në kohën e duhur palëve në fjalë, pa ndëshkim. Mekanizmi do të përfshijë dispozita për ankesa konfidenciale dhe ato që kërkojnë masa të veçanta mbrojtëse, si raportimet e dhunës me bazë gjinore. Mekanizmi nuk duhet të pengojë përdorimin e rrugëve të tjera gjyqësore ose administrative që parashikon ligji ose procedura ekzistuese e arbitrazhit apo ndërmjetësimit dhe as nuk duhet të konsiderohet si zëvendësues i mekanizmave të ankesave që ofrohen përmes sindikatave apo kontratave kolektive.

Punonjësit e palëve të treta

22. Për punonjësit e palëve të treta që kontraktin klienti përmes sipërmarrësve apo ndërmjetësve të tjerë, për të punuar në zonat e projektit apo për të kryer punë drejtpërdrejt të lidhura me funksionet bazë të projektit, klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme: (i) për të vlerësuar performancën e kaluar të këtyre kontraktorëve ose ndërmjetësve në lidhje me punësimin dhe shëndetin dhe sigurinë në punë, për të përcaktuar kapacitetin e tyre aktual për zbatimin e kërkesave të kësaj KP-je dhe KP 4; dhe (ii) për të kërkuar që ata të zbatojnë kërkesat e parashtruara në pikat 7-19 dhe 21 të kësaj KP-je dhe pikat 11-15 të KP 4.

²⁸ Shkurtimet kolektive mbulojnë të gjitha largimet e shumëfishta që janë rezultat i një arsyeje ekonomike, teknike apo organizative; ose arsye të tjera që nuk lidhen me performancën apo arsye të tjera personale.

23. Klienti do të identifikojë rreziqet që lidhen me rekrutimin, angazhimin dhe shkarkimin e punonjësve të projektit nga palët e treta dhe do të vendosë politika dhe procedura proporcionale për menaxhimin dhe monitorimin e performancës së punëdhënësve të palëve të treta në lidhje me projektin dhe kërkesat e kësaj KP-je. Krahas kësaj, klienti do të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'i përfshirë këto kërkesa në marrëveshjet kontraktuale me këta punëdhënës dhe sipas rastit, do të hartojë dhe zbatojë një plan menaxhimi të kontraktorit. Në rastin e nënkontraktimit, klienti do të bëjë përpjekje të arsyeshme me qëllim që palët e treta të përfshijnë kërkesa të barasvlershme në marrëveshjet e tyre kontraktuale me nënkontraktorët e tyre.
24. Klienti duhet të sigurojë që punonjësit jo punëmarrës të kenë mundësi të përdorin një mekanizëm të efektshëm ankesash që përmbush kërkesat e kësaj KP-je. Në rastet kur pala e tretë nuk është në gjendje të sigurojë një mekanizëm ankesash, klienti duhet të ofrojë një mekanizëm të efektshëm ankesash për t'u shërbyer punonjësve të kontraktuar nga pala e tretë.

Zinxhiri i furnizimit

25. Si pjesë e procesit të vlerësimit të zinxhirit të furnizimit të parashtruar në KP1, klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rrezikun e përdorimit të punës së fëmijëve dhe të punës së detyruar²⁹ që përdoret në aktivitetet e furnitorëve parësorë³⁰.
26. Nëse vlerësimi i rrezikut identifikon praninë ose rreziqet e konsiderueshme të punës së fëmijëve ose punës së detyruar në operacionet e furnitorëve parësorë në shkelle të standardeve të ILO-s, ose kur rreziqe të konsiderueshme të punës së fëmijëve ose punës së detyruar raportohen në nivelet më të ulëta të zinxhirit të furnizimit të mallrave dhe materialeve që janë thelbësore për funksionet operacionale bazë të projektit, klienti do të ndërmarrë hapat e duhur për ta korrigjuar këtë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
- (i) Në lidhje me punën e fëmijëve, klienti do të përpiqet në mirëbesim për të korrigjuar ose zbutur problemin. Klienti duhet ta vazhdojë prokurimin e këtyre mallrave ose materialeve nga ky furnitor vetëm pasi të ketë marrë premtim apo dëshmi të pranueshme se furnitori është i angazhuar për të vënë në zbatim një program në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare për eliminimin e këtyre praktikave brenda një afati kohor të arsyeshëm. Klienti duhet të raportojë rregullisht mbi ecurinë e zbatimit të një programi të tillë;
 - (ii) Në lidhje me punën e detyruar, klienti duhet ta vazhdojë prokurimin e këtyre mallrave ose të lëndëve nga ky furnitor vetëm pasi të ketë marrë premtim apo dëshmi të pranueshme se furnitori ka ndërmarrë hapat e duhur për eliminimin e kushteve që përbëjnë punë të detyruar; dhe
 - (iii) Kur ekziston rreziku i përdorimit të punës së fëmijëve dhe/ose të punës së detyruar, klienti duhet të monitorojë vazhdimisht furnitorët parësorë, në mënyrë që të identifikojë çdo ndryshim të konsiderueshëm në zinxhirin e furnizimit dhe rreziqet ose rastet e reja të punës së fëmijëve dhe/ose të punës së detyruar. Gjithashtu, kur ekziston rreziku i lëndimit të punonjësve të një furnitori parësor, klienti do të kërkojë nga furnitori përkatës parësor të prezantojë procedura dhe masa të tjera kontrolli për të parandaluar ose zvogëluar rrezikun e dëmtimit të shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve. Klienti do të

rishikojë këto procedura dhe masa kontrolli në mënyrë periodike për të përcaktuar efektshmërinë e tyre.

27. Aftësia e klientit për t'u dhënë zgjidhje plotësisht këtyre rreziqeve varet nga niveli i kontrollit ose ndikimit menaxherial që ka klienti mbi furnitorët parësorë të tij. Kur korrigjimi nuk është i mundur, klienti do t'i riorientojë furnitorët parësorë të prekur gjatë një periudhe të arsyeshme kohore të dakordësuar me BERZH-in tek furnitorët që mund të tregojnë se janë në përputhje me këtë KP.

²⁹ Sipas përkufizimeve të konventave të ILO-s nr. 138, 182, 29, 105

³⁰ Shihni KP 1, pika 28 për përkufizimin e furnitorëve parësorë dhe funksionet operacionale bazë të projektit.

Hyrje

1. Kjo kërkesë performance (KP) përcakton një qasje në nivel projekti të ndikimeve klimatike dhe shkarkimeve të gazeve serrë, menaxhimit të burimeve dhe kontrollit dhe parandalimit të ndotjes³¹. Ai mbështetet tek hierarkia zbutëse, tek parimi që dëmi mjedisor duhet, si përparësi, të zgjidhet në burim dhe tek parimi “ndotësi pagan”. Rreziqet dhe ndikimet e projektit që lidhen me përdorimin e burimeve dhe prodhimin e mbetjeve dhe shkarkimeve duhet të vlerësohen në kuadër të vendndodhjes së projektit dhe kushteve mjedisore vendase. Duhet të miratohen masa zbutëse, teknologji dhe praktika të përshtatshme për përdorim efikas dhe efektiv të burimeve, parandalimin, kontrollin dhe shmangien e ndotjes, minimizimin dhe pakësimin e shkarkimeve të gazeve serrë (GHG).
2. Kjo KP pranon edhe konceptin dhe praktikën e re të Ekonomisë Qarkore³² dhe/ose rikuperimin e burimeve ku produkte të përdorshme dhe me vlerë mund të krijohen ose përfitohen nga ajo që më parë konsiderohej mbetje³³.
3. Kjo KP pranon rëndësinë e përdorimit të teknikave më të mira të disponueshme dhe praktikave të mira ndërkombëtare për të optimizuar përdorimin e burimeve dhe për të parandaluar dhe kontrolluar ndotjen në mënyrë efikase.

Objektivat

4. Objektivat e kësaj kërkesë performance janë:
 - adoptimi i qasjes së hierarkisë të masave zbutëse për të trajtuar ndikimet e padëshirueshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, që lindin nga përdorimi i burimeve dhe ndotja e shkaktuar nga projekti;
 - shmangia, pakësimi dhe menaxhimi i emetimeve të gazeve serrë në lidhje me projektin;
 - shmangia, pakësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve të lidhura me substancat dhe lëndët e rrezikshme, duke përfshirë pesticidet; dhe
 - identifikimi, ku është e mundur, i mundësive në lidhje me projektin për përmirësimin e përdorimit sa më efikas të burimeve për projektin.

Fusha e zbatimit

5. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet e financuara drejtpërdrejt nga BERZH-i, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të kësaj KP-je dhe mënyrën si do të trajtohen dhe menaxhohen ato përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të kësaj KP-je do të menaxhohet si pjesë e Sistemit të përgjithshëm të Menaxhimit Mjedor dhe Social (SMMS) të klientit dhe/ose Planit të Menaxhimit Mjedor dhe Social (PMMS) specifik të projektit.

Kërkesat

Efiçienca e burimeve

6. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të identifikojë mundësitë dhe alternativat për efiçencën e burimeve që lidhen me projektin, në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Në këtë kuadër, klienti duhet të zbatojë masa teknike dhe financiarisht të realizueshme³⁴ dhe kosto efektive³⁵ për të minimizuar konsumin dhe përmirësuar efiçencën e përdorimit të energjisë, të ujit e të burimeve të tjera dhe lëndëve të përdorura, si edhe për rikuperimin dhe ripërdorimin e mbetjeve gjatë zbatimit të projektit. Synimi kryesor duhet të jetë tek veprimtaritë që konsiderohen si funksionet bazë të projektit, por duhet të merren në konsideratë edhe mundësi të ngjashme në veprimtaritë e tjera tregtare të klientit që nuk janë pjesë e projektit. Kur ka të dhëna të gatshme për të bërë një vlerësim krahasues, vlerësimi i klientit duhet të bëjë një krahasim të aktiviteteve të tij me praktikën e mirë ndërkombëtare për të vlerësuar nivelin relativ të efiçencës.
7. Klienti duhet të integrojë masat e efiçencës së burimeve dhe parimet për një prodhim më të pastër në projektimin e produktit dhe proceset e prodhimit, me qëllim ruajtjen e lëndëve të para, të energjisë dhe ujit, si dhe shmangien dhe pakësimin e prodhimit të mbetjeve.

Ujërat

8. Në kuadër të hartimit të projektit do të identifikohen dhe të merren parasysh të gjitha mundësitë e realizueshme teknike dhe financiarisht dhe me kosto efektive për minimizimin, ripërdorimin dhe riciklimin e ujërave në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Kur duhet ndërtuar një ujësjellës i veçantë për projektin, klienti duhet të kërkojë të përdorë, kur është e realizueshme, ujë qëllim teknike, i cili nuk është i përshtatshëm për konsum njerëzor.
9. Për projektet me kërkesë të lartë për ujë (më shumë se 5.000 m³/ditë), pikat e mëposhtme do të aplikohen:

³¹ Termi “ndotje” i referohet ndotësve kimikë të rrezikshëm dhe jo të rrezikshëm në fazë të ngurtë, të lëngët ose të gaztë dhe përfshin përbërës të tjerë si shkarkimi termik në ujë, shkarkimet e ndotësve klimatikë jetëshkurtër dhe jetëgjatë, ndotjen e habitatit mjedisor (duke përfshirë tokën, ajrin dhe ujin), erërat e bezdisshme, zhurmën, dridhjet, rrezatimin, energjinë elektromagnetike dhe krijimin e ndikimeve të mundshme vizuale, duke përfshirë dritën.

³² Siç përcaktohet në Paketën e Komisionit Evropian për Ekonominë Qarkore.

³³ Sipas përcaktimit në Direktivën 2008/98/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 19 nëntor 2008 për mbetjet dhe shfuqizimin e disa Direktivave (Direktiva e BE-së për Kuadrin e Mbetjeve).

³⁴ Realizueshmëria teknike mbështetet në faktin nëse masat dhe veprimet e propozuara mund të zbatohen me aftësitë, pajisjet dhe materialet tregtare në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë karakteristikat vendore të tilla si klima, gjeografia, infrastruktura, siguria, qeverisja, kapaciteti dhe besueshmëria operative. Realizueshmëria financiare mbështetet tek konsideratat tregtare, duke përfshirë shkallën relative të kostove shtesë që sjell zbatimi i masave dhe i veprimeve të tilla në krahasim me kostot e investimit, operimit dhe mirëmbajtjes së projektit.

³⁵ Efiçentiteti i kostos përcaktohet sipas kostove kapitale dhe operative dhe përfitimeve financiare të masës, të marra parasysh gjatë gjithë jetës së projektit.

- një bilanc i detajuar i ujit do të zhvillohet gjatë procesit të vlerësimit dhe do të mbahet dhe raportohet çdo vit tek BERZH;
 - do të vlerësohet përdorimi specifik i ujit (i matur me vëllimin e ujit të përdorur për njësi prodhimi);
 - operacionet do të krahasohen me standardet e disponueshme të industrisë dhe me Praktikën e Mirë Ndërkombëtare të efikasitetit të përdorimit të ujit;; dhe
 - duhen identifikuar mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm sa i takon efikasitetin e përdorimit dhe rikuperimit të ujit.
10. Si pjesë e procesit të tij të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të marrë në konsideratë ndikimet e mundshme kumulative që ka nxjerrja e ujit mbi përdoruesit e tretë dhe ekosistemet vendase. Ky vlerësim do të marrë parasysh edhe efektet e mundshme të ndryshimit klimatik. Kur evidentohen rreziqe dhe ndikime të padëshirueshme, klienti do të zbatojë masat e duhura për të zbutur këto rreziqe dhe ndikime në përputhje me qasjen e hierarkisë së masave zbutëse dhe praktikave të mira ndërkombëtare.

Mbetjet³⁶

11. Klienti duhet të shmangë ose minimizojë prodhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme dhe ta zvogëlojë rrezikshmërinë e tyre aq sa është e mundur. Aty ku prodhimi i mbetjeve nuk mund të shmanget por është minimizuar, klienti do t'i ripërdorë, riciklojë ose rikuperojë mbetjet ose t'i përdorë ato si burim energjie në mënyrë të atillë që është e sigurt për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Në rastet kur mbetjet nuk mund të riciklohen, ripërdoren apo rikuperohen, klienti do të duhet t'i trajtojë dhe/ose t'i hedhë ato në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt për mjedisin, që përfshin kontrollin e duhur të shkarkimeve dhe mbetjeve që rezultojnë nga trajtimi dhe përpunimi i mbetjeve dhe sipas rastit, në përputhje me standardet thelbësore mjedisore të BE-së.
12. Nëse mbetjet e prodhuara konsiderohen të rrezikshme sipas rregulloreve vendase dhe/ose të BE-së, klienti duhet të marrë parasysh kufizimet e zbatueshme për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve dhe kërkesat e tjera ligjore.
13. Kur depozitimi i mbetjeve bëhet jashtë zonës së projektit dhe/ose bëhet nga palë të treta, klienti duhet të marrë dokumentacionin e zinxhirit të kujdestarisë deri në destinacionin përfundimtar dhe duhet të përdorë kontraktorë që janë të licencuar nga agjencitë rregullore përkatëse. Klienti do të tregojë kujdesin e duhur në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Parandalimi dhe kontrolli i ndotjes

14. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social i klientit duhet të përcaktojë metodat, teknologjitë dhe praktikën e duhura të kontrollit dhe parandalimit të ndotjes ("teknikat") të cilave u nënshtrohet projekti. Vlerësimi duhet të marrë në konsideratë karakteristikat e strukturave dhe aktivitetëve që janë pjesë e projektit, vendndodhjen gjeografike të projektit dhe kushtet mjedisore vendase. Procesi i vlerësimit duhet të identifikojë teknikat e kontrollit dhe parandalimit të ndotjes teknike dhe financiare të realizueshme dhe me kosto efektive, të cilat janë më të përshtatshmet për të shmangur ose minimizuar ndikimet e padëshirueshme mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Teknikat e zbatuara për projektin duhet të favorizojnë parandalimin ose shmangien e rreziqeve dhe ndikimeve, kundrejt minimizimit dhe zvogëllimit, në përputhje me qasjen e hierarkisë zbutëse dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare, dhe duhet të jenë sipas natyrës dhe shkallës së rreziqeve dhe ndikimeve të padëshirueshme të projektit.
15. Klienti duhet t'i strukturojë projektet që të përmbushin standardet mjedisore përkatëse të BE-së, kur këto mund të zbatohen në nivelin e projektit³⁷. Disa projekte, për shkak të natyrës dhe shkallës së tyre, do të ishin objekt i Direktivës së BE-së për ndotjen industriale³⁸ kështu që do t'u kërkohej të përmbushin teknikat më të mira të mundshme të BE-së dhe standardet përkatëse për çlirimim dhe shkarkimin e ndotësve, pavarësisht vendndodhjes.
16. Kur nuk ka standarde mjedisore përkatëse të BE-së në nivelin e projektit, klienti duhet të identifikojë, me miratimin e BERZH-it, standarde të tjera të përshtatshme në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Krahas kësaj, projektet duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe duhet të mirëmbahen dhe operohen në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore kombëtare. Kur rregulloret e vendit priten ndryshojnë nga nivelet dhe masat e parashtruara në kërkesat mjedisore të BE-së ose standardet e tjera mjedisore të identikuara, projektet duhet të respektojnë nivelin më të rejtë të rregullimit.
17. Që në fillim, projektet duhet të plotësojnë standardet mjedisore thelbësore të BE-së ose standarde të tjera të miratuara mjedisore, si dhe kërkesat rregullore kombëtare. Projektet që përfshijnë rehabilitimin e strukturave dhe/ose aktivitetëve ekzistues duhet të përmbushin kërkesat e pikës 15 dhe/ose 16 brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili do të përcaktohet përmes një vlerësimi zyrtar të performancës së tyre kundrejt standardeve të zbatueshme.
18. Në lidhje me projektet në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet që po anëtarësohen apo janë kandidatë ose kandidatë potenciale për anëtare në BE, të cilat përfshijnë rehabilitimin e strukturave dhe/ose aktivitetëve ekzistues dhe kur janë identifikuar standardet mjedisore thelbësore të BE-së, afati kohor për të arritur përputhshmërinë me këto standarde duhet të marrë në konsideratë afatet kohore të miratuara brenda vendit. Për projektet në të gjitha vendet e tjera, afati kohor për arritjen e përputhshmërisë së standardeve mjedisore thelbësore të BE-së duhet të marrë parasysh kushtet vendase dhe koston e zbatimit dhe duhet të jetë në përputhje me Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe çdo marrëveshjeje dypalëshe apo plan veprimi të miratuar e të lidhur midis BE-së dhe vendit pritës në fjalë.

³⁶ Në kuptim të kësaj kërkesë të performancës, mbetjet përkufizohen si një përzierje heterogjene lëndësh/ materialesh të gazta, të lëngëta dhe/ose të ngurta që duhet trajtuar përmes proceseve të përshtatshme fizike, kimike dhe/ose biologjike përpara se të asgjësohen në mjedis në mënyrë të sigurt.

³⁷ Në kuptim të kësaj kërkesë të performancës, standardet mjedisore thelbësore të BE-së mund të zbatohen në nivelin e projektit kur vetë dokumenti legjislativ detyësor i BE-së përmban kërkesa të qarta sasimore ose cilësore që janë të zbatueshme në nivelin e projektit (kundrejt atyre në nivelin e mjedisit, për shembull).

³⁸ Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 24 nëntor 2010 për shkarkimet industriale (kontrolli dhe parandalimi i integruar i ndotjes).

19. Gjatë të gjithë ciklit të jetës së projektit, klienti duhet të zbatojë teknika të kontrollit dhe parandalimit të ndotjes në përputhje me qasjen e hierarkisë zbutëse për minimizimin e ndikimeve të mundshme të padëshirueshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, ndërkohë që mbeten teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive. Kjo zbatohet për shkarkimin e ndotësve për shkak të rethanave rutinë, jo rutinë apo aksidentale.

Gazet Serrë

20. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social i klientit duhet të marrë parasysh dhe të zbatojë ato alternativa që janë teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive për të shmangur ose minimizuar shkarkimet e gazeve serrë (GHG) të lidhura me projektin gjatë planifikimit dhe funksionimit të projektit. Në këto alternativa përfshihen, ndër të tjera, vendndodhja, teknikat ose proceset alternative të projektit, përdorimi i burimeve të rinovueshme ose burimeve të energjisë me nivel të ulët karboni, praktika të menaxhimit të qëndrueshëm të bujqësisë, pyjeve dhe gjëës së gjallë, pakësimi i shkarkimeve fluruese dhe i djegies së gazeve.
21. Për projektet që ose (1) kanë, apo priten të kenë, shkarkime bruto që tejkalojnë një barasvlërë vjetore prej 100.000 ton CO₂, ose (2) priten që të kenë një ndryshim neto të shkarkimeve, pozitive apo negative, të një barasvlere vjetore prej më shumë se 25.000 ton CO₂ pas investimit, klienti duhet të përcaktojë sasinë e këtyre shkarkimeve në përputhje me Protokollin e BERZH-it për Vlerësimin e Shkarkimeve të Gazeve Serrë. Objekti i vlerësimit të gazeve serrë duhet të përfshijë të gjitha shkarkimet e drejtpërdrejta nga strukturat, veprimtaritë dhe aktivitetet që janë pjesë e projektit, si edhe shkarkimet e tërthorta që shoqërojnë prodhimin e energjisë së përdorur nga projekti. Përcaktimi sasior i shkarkimeve të gazeve serrë duhet të bëhet nga klienti çdo vit dhe t'i raportohet BERZH-it.

Përdorimi i sigurt dhe menaxhimi i lëndëve dhe materialeve të rrezikshme

22. Në të gjitha veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me projektin, klienti duhet të shmangë ose të minimizojë përdorimin e lëndëve dhe të materialeve të rrezikshme dhe të marrë në konsideratë përdorimin e zëvendësuesve më pak të rrezikshëm për këto lëndë dhe materiale, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi nga ndikimet e mundshme të dëmshme prej tyre. Kur nuk mundet të shmangen ose të zëvendësohen, klienti duhet të zbatojë masat e duhura të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të minimizojë ose të mbajë nën kontroll çlirimin e lëndëve/materialeve të tilla në ajër, ujë dhe/ose tokë, si pasojë e prodhimit, transportimit, trajtimit, depozitimit, përdorimit dhe asgjësimit të tyre në lidhje me veprimtaritë e projektit.
23. Klienti duhet të shmangë prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve dhe materialeve të rrezikshme që janë subjekt i ndalimit ndërkombëtar ose nxjerrjes jashtë përdorimit për shkak të nivelit të lartë toksik për organizmat e gjalla, rezistencës në mjedis, mundësisë për bioakumulim ose hollimit të shtresës së ozonit.

Menaxhimi i dëmtuesve

24. Klientët që menaxhojnë ose përdorin pesticide duhet të hartojnë dhe të zbatojnë një qasje të menaxhimit të integruar të dëmtuesve (MID) dhe/ose menaxhimit të integruar të vektorëve (MIV) për veprimtaritë e menaxhimit të dëmtuesve. Programi MID dhe MIV i klientit duhet të bashkërendojë përdorimin e informacioneve për dëmtuesit dhe mjedisin së bashku me metodat e mbajtjes në kontroll të dëmtuesve, përfshi praktikat kulturore, mjetet biologjike, gjenetike dhe kimike për të parandaluar nivelet e papranueshme të dëmit të shkaktuar nga dëmtuesit e bimëve. Kur në veprimtaritë e menaxhimit të dëmtuesve përfshihet përdorimi i pesticideve, klienti duhet të përpiqet të zvogëlojë ndikimet që kanë pesticidet tek biodiversiteti, shëndeti i njeriut dhe mjedisi dhe, më në përgjithësi, të arrijë një përdorim të qëndrueshëm të pesticideve, si dhe një zvogëlim të përgjithshëm të konsiderueshëm të rreziqeve dhe përdorimeve të pesticideve në përputhje me mbrojtjen e nevojshme të kulturave bujqësore.
25. Përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve duhet të përfshijë:
- shmangien, ose kur kjo nuk është e mundur, minimizimin e ndikimeve që kanë pesticidet në biodiversitet, shëndetin e njeriut dhe mjedisin në përgjithësi;
 - uljen e niveleve të lëndëve aktive të dëmshme përmes zëvendësimit të lëndëve më të rrezikshme me alternativa më të sigurta (përfshi edhe alternativa jo-kimike);
 - përzgjedhjen e pesticideve që kanë nivel të ulët toksik, të njohura si të efektshme kundër llojeve të synuara dhe që kanë ndikime minimale tek llojet jo të synuara, siç janë insektet pllenuese dhe mjedisi;
 - promovimi i kulturave bujqësore me nivel të ulët ose pa pesticide që mbështeten në strategjitë MID dhe MIV; dhe
 - minimizimin e dëmit ndaj armiqve natyrorë të dëmtuesve të synuar dhe parandalimin e zhvillimit të rezistencës tek dëmtuesit.
26. Klienti duhet t'i trajtojë, magazinojë, përdorë dhe depozitojë pesticidet në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Hyrje

1. Kjo Kërkesë Performance (KP) njeh rëndësinë e menaxhimit të rreziqeve të shëndetit, sigurisë dhe sigurimit të punonjësit, komunitetet e prekura nga projekti dhe konsumatorët, të lidhura me veprimtaritë e projektit, në përputhje me hierarkinë e kontrollit të rrezikut³⁹. Duke iu ofruar punonjësve kushte pune të sigurta, të shëndetshme dhe të siguruara, klientët mund të krijojnë përfitime të prekshme, si përmirësimi i eficiencës dhe rendimentit të operacioneve të tyre.
2. Veprimtaritë, pajisjet dhe infrastruktura e projektit mund ta rrisin mundësinë e ekspozimit të punonjësve dhe të komunitetit ndaj rreziqeve të shëndetit, sigurisë dhe sigurimit, duke përfshirë edhe ato të lidhura me mobilizimin, ndërtimin, kolaudimin, operimin, mirëmbajtjen, nxjerrjen nga përdorimi apo mbylljen, rikthimin në gjendjen e mëparshme dhe transportin e mallrave dhe shërbimeve.
3. Klienti ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar kushte të sigurta dhe të shëndetshme për punonjësit e tij dhe për informimin, udhëzimin, trajnimin, mbikëqyrjen dhe konsultimin e punonjësve për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë. Punonjësit kanë përgjegjësinë për të bashkëpunuar aktivisht me punëdhënësin dhe për t'u kujdesur për shëndetin dhe sigurinë e tyre, si dhe shëndetin dhe sigurinë e të tjerëve.
4. Duke njohur rolin që kanë autoritetet përkatëse për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit dhe të sigurisë së publikut, klienti ka detyrën të menaxhojë rreziqet për shëndetin, sigurinë dhe sigurimin e komuniteteve të prekura nga projekti.

Objektivat

5. Objektivat e kësaj KP-je janë:
 - mbrojtja dhe promovimi i shëndetit, sigurisë dhe sigurimit të punonjësve, duke siguruar kushte pune të sigurta, të shëndetshme dhe të siguruara, dhe duke zbatuar një sistem menaxhimi të rreziqeve të lidhura me projektin; dhe
 - identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve të shëndetit, sigurisë dhe sigurimit të komunitetet dhe konsumatorët e prekur nga projekti përgjatë të gjithë ciklit të projektit, nga veprimtaritë rutinë dhe ato jo rutinë.

Fusha e zbatimit

6. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet e financuara nga BERZH-i, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të kësaj KP-je dhe mënyrën si do të trajtohen dhe menaxhohen ato përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Rreziqet e mundshme për punonjësit dhe komunitetet e prekura nga projekti mund të ndryshojnë në varësi të fazës së projektit, duke përfshirë mobilizimin, ndërtimin, kolaudimin, operimin, mirëmbajtjen dhe nxjerrjen nga përdorimi, ose mbylljen dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmirësimin e kërkesave të kësaj KP-je menaxhohet si pjesë përbërëse e Sistemit të përgjithshëm të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të klientit dhe/ose Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) specifik të projektit, siç parashikohet në KP1.
7. Kërkesat e detajuara për parandalimin dhe kontrollin e rreziqeve në shëndetin e njerëzve dhe të ndikimeve në mjedis për shkak të çlirimit të ndotjes gjendet në KP 3.

Kërkesat

Kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e shëndetit dhe të sigurisë

8. Klienti duhet të ndërmarrë masa për të identifikuar dhe parandaluar aksidentet, dëmtimet dhe sëmundjet e punonjësve dhe të komuniteteve të prekura nga projekti, të cilat lindin ose lidhen me veprimtaritë e projektit, apo ndodhin gjatë veprimtarive të projektit, si dhe për të përgatitur e zbatuar masa parandaluese dhe mbrojtëse, dhe plane për të menaxhuar rreziqet e shëndetit dhe të sigurisë në përputhje me hierarkinë e kontrollit të rreziqeve dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare.
9. Klienti duhet t'u japë punonjësve dhe komuniteteve të prekura nga projekti informacionin, udhëzimet dhe trajnimin përkatës në lidhje me rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë, masat mbrojtëse dhe parandaluese dhe planet e emergjencës, të cilat janë të nevojshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre gjatë gjithë projektit.
10. Kur një aksident, dëmtim dhe sëmundje ndodh gjatë punimeve lidhur me projektin, ose kur ka mundësi të ndodhë diçka e tillë, klienti duhet të hetojë, t'i dokumentojë dhe analizojë konstatimet, dhe të zbatojë masa për të parandaluar përsëritjen e tyre dhe, kur e kërkon ligji, të njoftojë dhe të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse. Klienti duhet të sigurojë kompensim të përshtatshëm financiar për çdo person që vuan nga dëmtime apo sëmundje të shkaktuara nga projekti.

³⁹ Hierarkia e kontrollit të rrezikut i referohet; (i) eliminimit të rrezikut; (ii) pakësimit e rrezikut duke i zëvendësuar kushtet ose substancat e rrezikshme me substanca jo të rrezikshme ose më pak të rrezikshme; (iii) izolimit të rrezikut për të parandaluar ekspozimin; (iv) futjes së kontrolleve inxhinierike që mbrojnë fuqinë punëtore dhe komunitetin në tërësi; dhe (v) ofrimit të informacionit, udhëzimeve dhe trajnimit për punonjësit dhe komunitetet, kur është e përshtatshme, lidhur me rreziqet, sistemet e sigurta të punës, planet e emergjencës, kërkesat e raportimit dhe mbikëqyrjen e detyrueshme.

Shëndeti dhe siguria në punë

11. Klienti duhet t'u sigurojë të gjithë punonjësve një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke mbajtur në konsideratë rreziqet e vetvetishme të sektorit përkatës dhe klasat specifike të rreziqeve që mund të jenë të pranishme. Klienti duhet të identifikojë rreziqet e shëndetit dhe të sigurisë dhe masat mbrojtëse sipas fazës, madhësisë dhe natyrës së projektit, në përputhje me standardet përkatëse bazë të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (SHSP)⁴⁰ dhe Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN). Klienti duhet të kryejë një vlerësim që përkon me nivelin e rrezikut dhe të hartojë një plan për shëndetin dhe sigurinë të posaçëm për projektin, sipas rastit, i cili duhet të integrohet në PMMS. Plani duhet të rishikohet në mënyrë periodike për të vlerësuar efikasitetin e tij për trajtimin e rreziqeve përkatëse.
12. Klienti duhet të planifikojë dhe zbatojë masat e SHSP-së me ndihmën e një personi përgjegjës për SHSP-në, duke respektuar hierarkinë e kontrollit të rrezikut dhe duke ofruar pajisje të mbrojtjes personale pa kosto për punonjësit. Klienti duhet t'u kërkojë punonjësve jo-punëmarrës, kontraktorëve dhe palëve të treta, të angazhuar për të punuar në zonat e projektit apo për të kryer punë drejtpërdrejt lidhur me funksionet bazë të projektit, të respektojnë planin e shëndetit dhe sigurisë.
13. Gjatë çdo veprimtarie pune, klienti duhet të sigurojë që të gjithë punonjësve t'u bëhet mbikëqyrje e vazhdueshme dhe e duhur për të siguruar përdorimin e sigurt të pajisjeve të punës dhe zbatimin e respektimit e duhur të procedurave dhe rregullave të shëndetit dhe të sigurisë.
14. Klienti duhet të monitorojë shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve të tij dhe të konsultojë me ta masat e SHSP-së, t'i nxisë punonjësit të ndërpresin punën në situata me rrezik të menjëhershëm dhe të raportojnë veprimet dhe kushtet e pasigurta në vendin e punës. Këtu përfshihen, por nuk kufizohen, hetimi i aksidentit, vlerësimi i rrezikut, zhvillimi i sistemeve të sigurta të punës dhe përzgjedhja e pajisjeve të punës.
15. Kur ka rreziqe të veçanta që shoqërojnë veprimtari të caktuara pune me pasoja negative për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve me ndjeshmëri të tilla si moshë, përkatësia gjinore, aftësi të kufizuara ose gjendje shëndetësore afatshkurtra apo afatgjata, klienti duhet të kryejë një vlerësim më të detajuar të rrezikut dhe të bëjë rregullimet përkatëse për të parandaluar dëmtimin dhe sëmundjet.

Shëndeti dhe siguria në komunitet

16. Klienti do të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e lidhura me projektin dhe ndikimet negative për shëndetin dhe sigurinë e komuniteteve mundësisht të prekura, dhe do të hartojë masa mbrojtëse, parandaluese dhe zbutëse në përpjesëtim me ndikimet dhe rreziqet, dhe sipas fazës, madhësisë dhe natyrës së projektit. Klienti duhet të komunikojë me komunitetet e prekura nga projekti dhe palët e tjera përkatëse të interesit, sipas rastit, për planet dhe masat zbutëse. Këto masa duhet të jenë në përputhje me hierarkinë e kontrollit të rrezikut dhe praktikën e mirë ndërkombëtare.

17. Masat për shmangien ose zbutjen e ndikimeve nga projekti në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit mund të jenë përgjegjësi e autoriteteve publike përkatëse. Në këto rrethana, klienti duhet të sqarojë rolin dhe përgjegjësinë e tij për të njoftuar pranë autoriteteve përkatëse dhe për të bashkëpunuar me to.

Dhuna me bazë gjinore

18. Klienti duhet të vlerësojë rreziqet e dhunës me bazë gjinore që kanë lidhje me projektin, si ngacmimi seksual, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i personave dhe komuniteteve të prekura nga projekti. Aty ku gjën zbatim, klienti duhet të zbatojë masa të veçanta për t'i parandaluar dhe trajtuar këto rreziqe, duke përfshirë ofrimin e kanaleve konfidenciale për raportimin e incidenteve dhe ofrimin e mbështetjes.

Kërkesat e veçanta për menaxhimin e shëndetit dhe të sigurisë

Projektimi dhe siguria e infrastrukturës, ndërtesave dhe pajisjeve

19. Klienti duhet të përfshijë aspektet e shëndetit dhe të sigurisë në projektimin, ndërtimin, kolaudimin, operimin, mirëmbajtjen dhe nxjerrjen nga përdorimi të elementeve ose komponentëve strukturorë të projektit në përputhje me PMN-në, duke mbajtur në konsideratë rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për palët e treta dhe komunitetet e prekura nga projekti. Elementet strukturorë duhet të projektohen dhe ndërtohen nga profesionistë të kualifikuar. Duhet kryer auditimi i mbrojtjes ndaj zjarrit dhe mbrojtjes së jetës nga palët e treta të specializuara për të gjitha ndërtesat e reja publike dhe rinovimin e tyre madhor, përpara kolaudimit apo përdorimit të tyre.
20. Ndërtimi dhe rinovimi i ndërtesave që përdoren për qëllime të përbashkëta komunitare duhet të projektohen në përputhje me konceptin e aksesit universal⁴¹.
21. Kur elemente ose komponentë strukturorë, të tillë si diga, rezervuare të mbetjeve ose rezervuare hiri, ndodhen në pika me rrezik të lartë dhe mosfunksionimi ose keqfunksionimi i tyre mund të verë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e punonjësve dhe komuniteteve, klienti duhet të angazhojë një ose më shumë ekspertë të kualifikuar me përvojën përkatëse dhe të njohur në projekte të ngjashme, veçmas nga personat përgjegjës për projektimin dhe ndërtimin. Ata duhet të kryejnë një shqyrtim në një moment sa më të hershëm të zhvillimit të projektit dhe gjatë të gjitha fazave të projektimit, ndërtimit, operimit dhe kolaudimit të projektit për të konfirmuar sigurinë dhe integritetin strukturor të këtyre elementeve ose komponentëve strukturorë.

Siguria e materialeve të rrezikshme

22. Klienti do të parandalojë ose të minimizojë mundësinë e ekspozimit të punonjësve dhe të komunitetit të prekur nga projekti ndaj materialeve të rrezikshme⁴² që mund të dalin nga projekti duke zbatuar hierarkinë e kontrollit të rrezikut. Kur ekziston mundësia që punonjësit dhe komunitetet e prekur nga projekti të ekspozohen ndaj rreziqeve, klienti duhet të tregojë kujdesin e duhur për të menaxhuar ekspozimin e tyre nëpërmjet eliminimit, zëvendësimit ose izolimit të kushtit apo substancës që shkakton rrezikun.

⁴⁰ Standardet SHSP të BE-së nënkuptojnë kërkesa bazë në kërkesat ligjore të BE-së në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke përcaktuar kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për mbrojtjen e punonjësve.

⁴¹ Akses universal do të thotë akses i sigurt dhe gjithëpërfshirës për njerëzit e të gjitha moshave dhe aftësive në situata dhe rrethana të ndryshme.

⁴² Materialet e rrezikshme iu referohen substancave që kanë një ose më shumë veçori të rrezikshme të vetvetishme, të cilat mund të sjellin një pasojë negative të konsiderueshme në mjedis apo në shëndetin e njerëzve.

23. Kur materialet e rrezikshme janë pjesë e objekteve ose operacioneve ekzistuese që shoqërojnë projektin, klienti duhet të tregojë kujdesin e duhur gjatë veprimtarive të kolaudimit, mirëmbajtjes dhe nxjerrjes nga përdorimi, në mënyrë që të parandalojë ekspozimin e punonjësve dhe të komunitetit të prekur nga projekti ndaj këtyre materialeve të rrezikshme. Kur nuk mund të shmangët përdorimi i materialeve të tilla, klienti duhet të marrë masat e nevojshme për trajtimin, magazinimin, transportimin dhe asgjësimin e sigurt në përputhje me PMN-në.
24. Klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar transportin e sigurt të materialeve të rrezikshme, duke përfshirë mbetjet, dhe duhet të zbatojë masa për të shmangur ose pakësuar ekspozimin e komunitetit të prekur nga projekti.

Siguria e produkteve

25. Kur projekti kërkon prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve të konsumit të gjerë, klienti duhet të garantojë sigurinë e produkteve nëpërmjet proceseve të mira të projektimit dhe të prodhimit, si edhe nëpërmjet magazinimit, trajtimit dhe transportimit të duhur për shpërndarjen e produkteve. Duhet ndjekur praktika e mirë ndërkombëtare, duke përfshirë kërkesat e përgjithshme për sigurinë, specifike për standardet e sigurisë së produkteve dhe kodet e praktikës në një sektor ekonomik dhe vend të caktuar.
26. Gjatë procesit të vlerësimit të projektit, klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e shëndetit dhe sigurisë të konsumatorët, shoqëruar me produktet e tij gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës. Qasja për sigurinë e produkteve duhet të respektojë hierarkinë e kontrollit të rreziqeve dhe të sigurojë që konsumatorëve t'u jepet informacion i mjaftueshëm për rreziqet e shëndetit dhe të sigurisë së produktit. Për situatat që përfshijnë produkte që mund të paraqesin rreziqe serioze për shëndetin, klienti duhet të sigurojë tërheqjen e produktit nga tregu dhe të sigurohet që ka dhe po zbatohen politika dhe procedura e tërheqjes së produktit nga tregu.

Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në shërbimet komunitare

27. Kur projekti kërkon ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit, klienti duhet të garantojë sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të tilla dhe të zbatojë sistemet e duhura të menaxhimit të cilësisë, për t'u siguruar që këto shërbime të mos paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve ose komunitetit.
28. Kur projekti kërkon ofrimin e shërbimeve publike, klienti duhet të përfshijë, sa më shumë të jetë e mundur, parimet e aksesit universal.
29. Kur projekti kërkon ofrimin e shërbimeve publike dhe/ose përdorimin e antibiotikëve, klienti do të përfshijë mbikëqyrjen antimikrobike⁴³.

Trafiku dhe siguria rrugore

30. Klienti duhet të identifikojë, vlerësojë dhe monitorojë rreziqet e mundshme të trafikut dhe të sigurisë rrugore për punonjësit dhe komunitetet mundësisht të prekura nga projekti gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit dhe, sipas rastit, duhet të hartojë masa dhe plane për t'i adresuar ato. Për projektet që përdorin pajisje lëvizëse në rrugët publike dhe forma të tjera të infrastrukturës, klienti do të kërkojë të parandalojë incidentet dhe dëmtime të pjesëtarëve të publikut që vijnë si pasojë e përdorimit të këtyre pajisjeve.

31. Klienti duhet të mbajë parasysh standardet përkatëse të BE-së për menaxhimin e trafikut dhe të sigurisë rrugore⁴⁴, të identifikojë masat e sigurisë rrugore për përdoruesit e mjeteve rrugore të motorizuara dhe jo të motorizuara, dhe të përfshijë komponentë të sigurisë rrugore teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshëm dhe me kosto efektive në planifikimin e projektit, për të zbutur ndikimet e mundshme të sigurisë rrugore të komunitetet vendore të prekura. Sipas rastit, klienti duhet të ndërmarrë një kontroll të sigurisë rrugore për secilën fazë të projektit dhe të monitorojë rregullisht raportimet e incidenteve dhe të aksidenteve për të identifikuar dhe zgjidhur problemet apo prirjet negative të sigurisë. Për klientët me automjete ose flota automatësh (në pronësi ose të marra me qira), klienti do të paraqesë masa bazuar në PMN për të menaxhuar rreziqet e trafikut dhe të sigurisë rrugore⁴⁵ dhe t'u sigurojë punonjësve trajnimin e duhur për drejtimin dhe sigurinë e automjeteve. Klienti duhet të sigurojë mirëmbajtje të rregullt të të gjitha automjeteve të projektit.

Rreziqet natyrore

32. Klienti do të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e mundshme të shkaktuara nga rreziqet natyrore, si tërmeti, thatësitat, rrëshqitjet e dheut ose përmytjet, të cilat lidhen me projektin. Kjo mund të kërkojë që klientët të kryejnë një vlerësim të cënueshmërisë së projektit nga rreziqet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike, dhe të identifikojnë masat e duhura të aftësisë ripërtëritëse dhe të përshtatjes ndaj klimës, të cilat duhet të përfshihen në planifikimin e projektit.
33. Klienti do të shmangë dhe/ose të minimizojë rreziqet e shkaktuara nga rreziqet natyrore apo ndryshimet e përdorimit të tokës, të cilat mund të kontribuojnë veprimtaritë e projektit.

Ekspozimi ndaj sëmundjeve

34. Për të ndihmuar në parandalimin ose minimizimin e mundësisë së ekspozimit të punonjësve dhe të komunitetit të prekur nga projekti ndaj sëmundjeve, duke marrë parasysh ekspozimin e diferencuar dhe ndjeshmërinë e lartë të grupeve më të cënueshme, klienti do të zhvillojë procesin e zbutjes së duhur në konsultim me autoritetet përkatëse. Klienti duhet të marrë masat për të shmangur ose minimizuar transmetimin e sëmundjeve ngjitëse, që mund të shoqërohen me ardhjen e punonjësve të përkohshëm dhe/ose të përhershëm të projektit.
35. Kur në komunitetet e prekura nga projekti ka sëmundje të veçanta endemike, klienti nxitet të identifikojë mundësitë, gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, për përmirësimin e kushteve që mund të ndihmojnë në pakësimin e përhapjes së këtyre sëmundjeve, si te punonjësit ashtu edhe te komunitetet e prekura nga projekti. Klienti duhet të marrë masat për të shmangur ose minimizuar transmetimin e sëmundjeve ngjitëse dhe për të parandaluar rreziqet me bazë gjinore, që mund të shoqërohen me ardhjen e fuqisë punëtore të përkohshme dhe/ose të përhershme të projektit.

⁴³ Mbikëqyrja antimikrobike është një program i koordinuar, siç përcaktohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, i cili promovon përdorimin e përshtatshëm të antimikrobeve (duke përfshirë antibiotikët), përmirëson rezultatet e pacientit, ul rezistencën mikrobike, dhe pakëson përhapjen e infeksioneve të shkaktuara nga organizmat rezistente ndaj barnave të shumta.

⁴⁴ Në përputhje me objektivat e Direktivës 2008/96/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore".

⁴⁵ Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, si ISO 39001 Menaxhimi i Trafikut dhe Sigurisë Rrugore

Gatishmëria dhe përgjigjja në situatë emergjence

36. Klienti duhet të jetë i përgatitur për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur incidenteve, aksidenteve dhe situatave emergjente në përputhje me rreziqet operacionale të lidhura me projektin dhe me nevojën për të parandaluar ose minimizuar ndikimet e mundshme negative të tyre, dhe në përputhje me kërkesat rregullatore të zbatueshme dhe me PMN-në⁴⁶.
37. Klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e aksidenteve madhore dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet madhore, ose për të kufizuar ndikimet negative të tyre te punonjësit, komunitetet e prekura nga projekti dhe te mjedisi, me qëllim sigurimin e niveleve të larta të mbrojtjes së njerëzve dhe të mjedisit në mënyrë të njëtrajtshme dhe të efektshme. Masa të tilla duhet të identifikohen në politikën e gatishmërisë ndaj emergjencave/parandalimit të aksidenteve madhore dhe në një plan të përshtatshëm menaxhimi, të integruar në SMMS-në e përgjithshme të klientit. Ky plan duhet të përfshijë strukturat organizative, përgjegjësitë, procedurat, komunikimin, trajnimin, burimet dhe aspektet e tjera të nevojshme për zbatimin e kësaj politike, për të siguruar që klienti të ketë kapacitetin për t'iu përgjigjur në mënyrë të efektshme emergjencave që lidhen me rreziqet e projektit, në përputhje me PMN-në.
38. Për projektet ku është i pranishëm rreziku i aksidenteve madhore, klienti duhet të asistojë dhe të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse dhe komunitetin e prekur nga projekti për përgatitjet e tyre për t'iu përgjigjur me efektivitet situatave emergjente. Nëse autoritetet vendore apo personat që përgjigjen kanë shumë pak ose aspak kapacitet për t'iu përgjigjur me efektivitet, klienti duhet të luajë një rol aktiv në përgatitjen për emergjencat që shoqërojnë projektin dhe në përgjigjen ndaj tyre, dhe duhet të japë prova të mjaftueshme për të treguar se ka kapacitetin për t'iu përgjigjur incidenteve të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme, si drejtpërdrejt ashtu edhe tërthorazi.

Sigurimi

39. Klienti duhet të identifikojë dhe vlerësojë kërcënimet e sigurisë së projektit te punonjësit dhe komunitetet e prekura nga projekti. Kur identifikohen rreziqe, do të zbatohen masat e duhura për menaxhimin e sigurisë në përputhje me PMN-në për menaxhimin e këtyre rreziqeve.
40. Kur angazhon punonjës ose kontraktorë për të ofruar siguri me qëllim mbrojtjen e personelit dhe pronës së tij, klienti do të vlerësojë rreziqet e shkaktuara nga këto masa sigurie për personelin dhe pronën brenda dhe jashtë zonës së projektit. Për marrjen e këtyre masave, klienti duhet të udhëhiqet nga parimi i proporcionalitetit, PMN-ja dhe ligjet e zbatueshme lidhur me punësimin, rregullat e sjelljes, trajnimin, pajisjen dhe monitorimin e sjelljes së personelit. Klienti duhet të mos lejojë përdorimin e forcës, përveçse kur përdoret për qëllime parandaluese dhe mbrojtëse në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e rrezikut.

41. Nëse shërbimet e sigurisë janë përgjegjësi e autoriteteve qeveritare përkatëse, klienti duhet të bashkëpunojë, në masën e lejuar, me autoritetin qeveritar përkatës për të arritur rezultatet që janë në përputhje me këtë KP. Klienti duhet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e mundshme që lindin nga ky përdorim, duhet t'iu komunikojë autoriteteve publike përkatëse qëllimin e tij se personeli i sigurisë vepron në përputhje me pikën 40 më sipër, dhe duhet t'i nxitë autoritetet publike përkatëse që të bëjnë publike masat e sigurisë për objektet e klientit, që janë subjekt i shqetësimeve kryesore për sigurinë.
42. Klienti duhet (i) të bëjë kërkime të arsyeshme për të verifikuar se punonjësit ose punëtorët e kontraktuar të angazhuar nga klienti për të ofruar sigurinë nuk janë përfshirë në abuzime në të shkuarën; (ii) t'i trajnojë ata mjaftueshëm (ose të përcaktojë se ata janë trajnuar si duhet) në përdorimin e forcës (dhe, sipas rastit, alarmet për zjarr) dhe sjelljen e përshtatshme ndaj punonjësve dhe komuniteteve të prekura nga projekti; dhe (iii) t'iu kërkojë atyre të vepronjë sipas ligjit të zbatueshëm dhe çdo kërkesë të përcaktuar në KP 2 dhe në KP-të e tjera të specifikuar nga klienti.
43. Klienti duhet të ngrejë dhe mirëmbajë një mekanizëm ankesash për t'iu mundësuar punonjësve dhe komunitetit të prekur nga projekti të shprehin shqetësimet e tyre mbi masat e sigurisë dhe veprimet e personelit të sigurisë, dhe duhet t'i informojë komunitetet dhe punonjësit mbi disponueshmërinë dhe përdorimin e mekanizmit të ankesave, në përputhje me këtë KP dhe KP 10.
44. Klienti duhet të hetojë çdo akuzë për akte të paligjshme ose abuzive të personelit të sigurisë, duhet të marrë masa (ose të nxisë palët e duhura për të marrë masa) për të parandaluar përsëritjen dhe, kur është e nevojshme, të raportojë aktet e paligjshme dhe abuzive pranë autoriteteve publike dhe BERZH-it.

⁴⁶ Sikurse shtjellohet në Direktivën 2012/18/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2012, "Për mbajtjen në kontroll të rreziqeve të aksidenteve madhore të lidhura me lëndët e rrezikshme", dhe për ndryshimin e më pas shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 96/82/KE (Direktiva EU SEVESCO III).

Kërkesa e Performancës 5 e BERZH-it: Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme

Hyrje

1. Kjo Kërkesë Performance (KP) trajton ndikimet e blerjes së tokës lidhur me projektin⁴⁷, duke përfshirë kufizimet në përdorimin e tokës⁴⁸ dhe aksesin në asetet dhe burimet natyrore, të cilat mund të shkaktojnë shpërngulje fizike (zhvendosje, humbje të tokës ose strehimit), dhe/ose shpërngulje ekonomike (humbje të tokës, pasurive ose kufizime në përdorimin e tokës, pasurive dhe burimeve natyrore që çojnë në humbjen e burimeve të të ardhurave dhe të mjeteve të tjera të jetesës⁴⁹). Termi “zhvendosje e pavullnetshme” i referohet si ndikimeve ashtu edhe proceseve për të minimizuar dhe kompensuar këto ndikime. Zhvendosja konsiderohet e pavullnetshme kur individët ose komunitetet e prekura nuk kanë të drejtë të refuzojnë blerjen e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës, të pasurive të tjera dhe të burimeve natyrore, edhe nëse blerja e detyrueshme përdoret vetëm si masë e fundit pas procesit të negociatave.
2. Zbatimi i kësaj KP-je është në përputhje me aspektin universal dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut⁵⁰, veçanërisht e drejta për pronën private, e drejta për strehim të përshtatshëm⁵¹ dhe e drejta për përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të jetesës.

3. Nëse nuk menaxhohet si duhet, zhvendosja e pavullnetshme mund të sjellë vështirësi afatgjata dhe varfërim për personat⁵² dhe komunitetet e prekura, si edhe dëm mjedisor dhe ndikime negative socio-ekonomike në zonat ku shpërngulen. Klienti duhet të mbajë në konsideratë zona dhe plane alternative të realizueshme të projektit për të shmangur ose minimizuar blerjen e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës, pasuritë e tjera dhe burimet natyrore duke balancuar njëkohësisht kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe financiare, dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimeve gjinore dhe ndikimeve tek grupet e cënueshme. Kur nuk mund të shmangët nëpërmjet projektimit, duhet të minimizohet shpërngulja dhe të planifikohen e zbatohen masat e duhura për të zbutur ndikimet negative te personat e prekur dhe komunitetet pritëse.

Objektivat

4. Objektivat e kësaj KP-je janë:
 - shmangia ose, kur është e pamundur, minimizimi i zhvendosjes së pavullnetshme duke eksploruar zona dhe plane alternative të realizueshme të projektit;
 - shmangia e largimit të detyruar⁵³;
 - minimizimi i ndikimeve negative të pamundurave mjedisore dhe sociale nga zhvendosja e pavullnetshme te personat e prekur duke: (i) siguruar kompensim në kohë për humbjen e pasurive me kosto të plotë zëvendësimi⁵⁴; dhe (ii) siguruar që blerja e tokës, kufizimet për përdorimin e tokës, pasuritë e tjera dhe burimet natyrore, si dhe veprimtaritë e zhvendosjes së pavullnetshme zbatohen bazuar në konsultime domethënëse, pjesëmarrje dhe dhënie informacioni në përputhje me kërkesat e KP 10;

⁴⁷ “Blerja e tokës” i referohet të gjitha metodave të marrjes së tokës për qëllime projekti, të mund të përfshijnë blerjen e përhershme, shpronësimin e tokës dhe të pasurive, dhe blerjen e të drejtave të përkohshme ose të përhershme të aksesit, si servituti, e drejta e kalimit, vendosja e kufizimeve të aksesit për zonat e mbrojtura dhe zona të tjera. Blerja e tokës mund të përfshijë: (a) blerjen e tokës së pazaptuar ose të pasqyruar, pavarësisht nëse pronari i tokës mbështetet apo jo në këtë tokë për qëllime të krijimit të ardhurave dhe të mjeteve të jetesës; (b) rizotërimin e tokës publike që përdoret ose zaptohet nga individët apo familjet; dhe (c) ndikimet e projektit që mund të sjellin zhytjen në ujë të tokës ose shpalljen e kësaj toke si të pasqyruar ose të paaksesueshme. “Tokat” përfshin gjithçka që rritet në të ose që vendoset në mënyrë të përhershme, si kultura bujqësore, godina dhe përmirësimet e tjera, dhe trupat ujorë përkatës.

⁴⁸ “Kufizimet në përdorimin e tokës” i referohen kufizimeve apo ndalimeve në përdorimin e tokës për qëllime bujqësore, banimi ose tregtare ose të tjera, të cilat vendosen drejtpërdrejt dhe zbatohen si pjesë e projektit. Këto mund të përfshijnë kufizime në aksesin në parqe dhe zona të mbrojtura të shpallura me ligj, kufizime në aksesin në burime të tjera të pronës së përbashkët dhe në përdorimin e tokës brenda zonave të të drejtave për shoqëritë e shërbimeve ose zonave të sigurisë.

⁴⁹ “Mjetet e jetesës” iu referohen tërësisë së mjeteve që individët, familjet dhe komunitetet përdorin për të fituar jetesën, si: paga nga punësimi; të ardhurat në të holla të fituara nëpërmjet një ndërmarrjeje ose nëpërmjet shitjes së prodhimit, mallrave, produkteve artizanale apo shërbimeve; të ardhurat e qirasë nga toka ose ambientet; të ardhurat nga të korrat ose blegtoria, ndarja e të korrave (si marrëveshjet e ndryshme të ndarjes së të korrave) ose prodhimi blegtoral; mallrat e prodhuara për konsum vetjak ose prodhimi i përdorur për shkëmbim ose klering; mallrat ose prodhimi për konsum vetjak; ushqimi, materialet, karburanti dhe mallrat për përdorim personal dhe familjar ose për tregti që janë derivat i burimeve natyrore ose të përbashkëta; pensionet dhe llojet e ndryshme të pagesave të qeverisë.

⁵⁰ Konkretisht, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturale

⁵¹ “Strehimi i përshtatshëm” i referohet privatësisë së përshtatshme; hapësirës; qasjes fizike; sigurisë së të drejtave pronësores; qëndrueshmërisë dhe rezistencës strukturore; ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit; infrastrukturës bazë, si strukturat e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe të menaxhimit të mbetjeve; cilësisë mjedisore të përshtatshme dhe faktorëve lidhur me shëndetin; vendndodhjes së përshtatshme dhe të aksesueshme lidhur me punën dhe objektet bazë.

⁵² “Personi i prekur” i referohet personit fizik ose juridik që i nënshtrohet shpërnguljes fizike ose ekonomike si rrjedhojë e blerjes së tokës lidhur me projektin, dhe e kufizimeve në përdorimin e tokës, pasuritë e tjera ose burimet natyrore.

⁵³ “Largimi i detyruar” i referohet veprimeve dhe/ose mosveprimeve që përfshijnë shpërnguljen e detyruar ose të pavullnetshme të përhershme ose të përkohshme të individëve, grupeve dhe komuniteteve nga shtëpitë dhe/ose tokat dhe nga burimet pronë e përbashkët, të cilat ata i zaptojnë ose nga të cilat varen, duke eliminuar ose kufizuar në këtë mënyrë mundësinë e individit, grupit ose komunitetit për të banuar apo punuar në një banesë, rezidencë apo vendndodhje të veçantë, pa ofrimin ose aksesin në forma të përshtatshme të mbrojtjes ligjore ose të llojeve të tjera të parashikuara në këtë KP.

⁵⁴ “Kostoja e zëvendësimit” përcaktohet si metodë e vlerësimit të kompensimit të fitimit të mjaftueshëm për të zëvendësuar pasuritë, plus kostot e nevojshme të transaksionit lidhur me zëvendësimin e pasurive Kur ekzistojnë tregje funksionale, kostoja e zëvendësimit është vlera e tregut e përcaktuar nëpërmjet vlerësimit të pavarur dhe kompetent të pasurive, plus kostot e transaksionit. Kur nuk ekzistojnë tregje funksionale, kostoja e zëvendësimit mund të përcaktohet nëpërmjet mjeteve alternative, si llogaritja e vlerës së produktit për tokën ose pasuritë prodhuese, ose e vlerës së nënvlerësuar të materialit të zëvendësimit dhe punës për ndërtimin e strukturave ose pasurive të tjera të palëvizshme, plus kostot e transaksionit. Në të gjitha rastet kur shpërngulja fizike sjell humbje të strehimit, kostoja e zëvendësimit duhet të jetë të paktën e mjaftueshme për të mundësuar blerjen ose ndërtimin e strehimit që përmbush standardet komunitare minimale të pranueshme të cilësisë dhe sigurisë.

- përmirësimi ose, të paktën, rehabilitimi i mjeteve dhe standardeve të jetesës së personave të prekur krahasuar me nivelet përpara shpërnguljes; dhe
- përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të shpërngulur fizikisht, nëpërmjet sigurimit të strehimit të përshtatshëm (duke përfshirë shërbimet thelbësore dhe shërbimet komunale) me sigurinë e të drejtave pronësore⁵⁵ në vendet ku zhvendosen.

Fusha e zbatimit

5. Zbatueshmëria e kësaj KP-je përcaktohet gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social të përshkruar në KP 1.
6. Kjo kërkesë performance zbatohet për shpërnguljen fizike ose ekonomike, që mund të jetë e plotë ose e pjesshme, e përhershme ose e përkohshme, e cila vjen nga disa lloje veprimesh:
 - të drejtat mbi tokën⁵⁶ dhe/ose pasuritë, të fituara nëpërmjet shpronësimit ose procedurave të tjera të detyrueshme;
 - të drejtat mbi tokën dhe/ose pasuritë, të fituara nëpërmjet marrëveshjeve të negociuara, nëse mund të nisë shpronësimi ose proceset e tjera të detyrueshme në rast dështimi të negociimit;
 - vendosja e kufizimeve që çojnë në humbjen e aksesit në mbi tokën, pasuritë, burimet natyrore ose mjetet e jetesës, pavarësisht nëse këto të drejta kufizimi merren nëpërmjet negociimit, shpronësimit, blerjes së detyrueshme apo nëpërmjet rregullimit qeveritar;
 - rivendosja e individëve pa të drejta përdorimi zyrtare, tradicionale apo të njohura në kuadër të legjislacionit kombëtar, që zaptojnë ose përdorin tokën përpara datës kufi; dhe
 - shpërngulja e individëve si rrjedhojë e ndikimeve të projektit që i bëjnë tokat ose pasuritë e tyre të pashfrytëzueshme ose pa akses.
7. Kjo KP zbatohet edhe për shpërnguljen fizike ose ekonomike të kryer nga klienti ose qeveria lidhur me projektin përpara përfshirjes së BERZH-it. Kur shpërngulja ndodh përpara përfshirjes së Bankës, duhet të kryhet një audit për të identifikuar: (i) çdo mangësi në veprimtaritë e mëparshme në kuadër të kësaj KP-je; dhe (ii) masat që mund të kërkohej të ndërmerren për të siguruar përputhshmërinë me këtë KP. Plani i masave duhet të përshkruajë të gjitha veprimtaritë për të arritur përputhshmërinë me këtë KP në formën e një plani me afat kohor të përcaktuar, duke përfshirë buxhetin, marrëveshjet e zbatimit, caktimin e roleve dhe përgjegjësi, dhe kalendarin e zbatimit.

8. Kjo KP nuk zbatohet për:

- zhvendosjen që vjen nga transaksionet e vullnetshme të tokës (transaksione tregtare në të cilat shitësi nuk detyrohet, shtrëngohet, frikësohet apo korruptohet për të shitur dhe blerësi nuk mund të vijojë me shpronësimin ose procese

të tjera të detyrueshme nëse negociatat dështojnë), dhe kur këto këto transaksione prekin vetëm ata me të drejta të njohura me ligj. Megjithatë, kjo KP do të zbatohet kur këto transaksione të vullnetshme të tokës mund të sjellin shpërnguljen e personave, përveç shitësitt, të cilët zaptojnë, përdorin ose kërkojnë të drejta mbi tokën në fjalë, si qiramarrësit informalë ose përdorues të tjerë të tokës që nuk kanë të drejtë sipas legjislacionit kombëtar; dhe

- zhvendosjen e refugjatëve, personave të shpërngulur brenda vendit dhe e viktimave të fatkeqësive natyrore, konflikteve, krimit ose dhunës.⁵⁷

⁵⁵ "Siguria e të drejtave pronësore" i referohet individëve ose komuniteteve të zhvendosura, që janë zhvendosur në një zonë të cilën ata mund ta zaptojnë në mënyrë të ligjshme, ku ata janë të mbrojtur nga rreziku i largimit dhe ku të drejtat pronësore që iu sigurohet atyre janë të përshtatshme në aspektin social dhe kulturor.

⁵⁶ "Të drejtat mbi tokën" përfshijnë të drejtat e plota dhe të përhershme pronësore të njohura nga ligji vendas, pavarësisht nëse janë të regjistruara apo zakonore; të drejtat e përhershme ose të përkohshme të uzefruktit (përdorimit) që rrjedhin nga një marrëveshje formale ose joformale, apo nga zakoni, duke përfshirë qiradhënien afatshkurtër ose afatgjatë, qiramarrjen dhe ndarjen e të korrave, si dhe përdorimin formal ose joformal të burimeve natyrore komunitare, si pyjet, kullotat dhe trupat ujorë; të drejtat e kalimit të përcaktuara me ligj ose me zakon; dhe kufizimet e përdorimit ose aksesit të përcaktuara me ligj ose me zakon.

⁵⁷ Në rastet kur ka ndodhur shpërngulja si rrjedhojë e konfliktit përpara shpërnguljes së shkaktuar nga projekti, procesi i zhvendosjes së pavullnetshme do të drejtohet nga parimet udhëzuese mbi shpërnguljen e brendshme (Zyra e Komisionit të Lartë për të Drejtat e Njeriut).

Kërkesat

Të Përgjithshme

9. Në fazën e hershme të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social të përcaktuar në KP 1, klienti duhet të identifikojë nëse ka gjasa që të shkaktohet ndonjë shpërngulje fizike dhe/ose ekonomike nga projekti, dhe të vlerësojë nevojën për për tokë dhe burime shtesë.
10. Kur ka ndikime të shpërnguljes, procesi i vlerësimit duhet të konsiderojë kushtet bazë socio-ekonomike të personave të shpërngulur dhe risqet e ndikimit e mundshme të projektit tek ata. Vlerësimi duhet të përfshijë gjasat për t'u realizuar, dhe shkallën e ndikimit, si dhe të marrë në konsideratë këndvështrimet e personave të prekur dhe të palëve kyç të interesit.
11. Kur vlerësimi ka identifikuar se projekti mund të përfshijë rreziqe materiale dhe ndikime lidhur me shpërnguljen fizike dhe ekonomike të njerëzve dhe/ose komuniteteve, klienti duhet të angazhojë ekspertë të zhvendosjes për të ndihmuar në përgatitjen e një dokumenti të planifikimit të zhvendosjes, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e masave për të adresuar pasojat tek personat e shpërngulur në përputhje me hierarkinë e minimizimit të riskut. Natyra e dokumentit të planifikimit të zhvendosjes për t'u përgatitur nga klienti duhet të përcaktohet nga Banka si pjesë e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Dokumenti i planifikimit të zhvendosjes duhet të përfshijë analizën e zonave dhe planeve alternative të projektit për të treguar se si është shmangur ose minimizuar shpërngulja fizike dhe ekonomike. Qëllimi dhe niveli i detajeve të planit do të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e projektit, ndikimet e tij të mundshme të shpërnguljes dhe rëndësinë që paraqet për grupet e interesit.

Shmangia ose minimizimi i shpërnguljes

12. Klienti duhet të mendojë zona dhe plane alternative të realizueshme të projektit për të shmangur ose të paktën për të minimizuar shpërnguljen fizike dhe/ose ekonomike. Shmangia është qasja e preferuar në përputhje me hierarkinë e minimizimit të riskut në KP 1. Është mjaft e rëndësishme që të shmanget shpërngulja fizike ose ekonomike e personave që janë të cënueshëm në aspektin kulturor ose ekonomik. Megjithatë, shmangia mund të mos jetë qasja e preferuar në situatat kur shëndeti ose siguria e publikut do të ndikoheshin negativisht. Mund të ketë edhe situata kur zhvendosja mund të ofrojë mundësi të drejtpërdrejta zhvillimi për familjet ose komunitetet, duke përfshirë përmirësimin e kushteve të strehimit dhe shëndetit publik, forcimin e sigurisë së të drejtave pronësore ose përmirësime të tjera të standardeve vendase të jetesës.

Shmangia e largimit të detyruar (dëbimit)

13. Klienti nuk duhet të përdorë largimin e detyruar (dëbimin). Ushtrimi i kompetencave për marrjen e tokës, shpronësimin, blerjen e detyrueshme ose të kompetencave të ngjashme nga klienti nuk konsiderohet si largim i detyruar, nëse është në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe dispozitat e kësaj KP-je, dhe kryhet në përputhje me parimet bazë të procesit të drejtë (duke përfshirë dhënien e një njoftimi paraprak të përshtatshëm, mundësinë për të depozituar ankesa dhe ankime, dhe shmangien e përdorimit të forcës së panevojshme, të zhdrejtë ose të tepërt).

Marrëveshjet e negociuara

14. Klienti duhet të kërkojë të marrë të drejtat mbi tokën nëpërmjet marrëveshjeve të negociuara, madje edhe nëse i ka mjetet ligjore për të fituar aksesin mbi tokën pa pëlqimin e shitësit. Marrëveshjet e negociuara ndihmojnë për të shmangur ose minimizuar shpronësimin dhe vonesat administrative ose gjyqësore lidhur me shpronësimin zyrtar, dhe për të minimizuar ndikimet te personat e prekur lidhur me shpronësimin zyrtar. Marrëveshjet e negociuara mund të arrihen nëpërmjet ofrimit të kompensimit të drejtë dhe të përshtatshëm për personat ose komunitetet e prekura.

Marrja në konsideratë e grupeve të cënueshme

15. Klienti duhet të identifikojë, vlerësojë dhe trajtojë ndikimet mbi grupet e cënueshme në përputhje me KP 1, dhe konkretisht duhet të:
 - (i) kryejë, në kohën e studimeve socio-ekonomike, një analizë për të përcaktuar faktorët përkatës të cënueshmërisë në kontekstin e zonës së projektit, në bashkëpunim me palët përkatëse të interesit, duke përfshirë komunitetet e prekura;
 - (ii) identifikojë grupet e cënueshme bazuar në rezultatet e analizës së cënueshmërisë;
 - (iii) zhvillojë konsultime specifike me grupet e cënueshme; dhe
 - (iv) planifikojë masa asistence të përshtatura me nevojat specifike të grupeve të cënueshme, të përshkruajë këto masa në dokumentin e planifikimit të zhvendosjes, dhe sigurojë zbatimin dhe financimin e tyre si pjesë të buxhetit të përgjithshëm për blerjen e tokës dhe zhvendosjen.

Marrja në konsideratë e aspekteve gjinore

16. Procesi i shpërnguljes fizike ose ekonomike përfshin aspekte gjinore specifike që duhet të merren në konsideratë gjatë studimeve bazë, vlerësimit të ndikimit, dhe proceseve të zbatimit dhe monitorimit. Duhet të zbatohen masa për të siguruar pjesëmarrjen kuptimplotë të grave dhe burrave në çdo konsultim rreth zhvendosjes, duke përfshirë oraret e përshtatshme të takimeve, transportin, mbështetjen me kujdes për fëmijët, si dhe organizimin e takimeve vetëm për gratë kur është e mundur. Projektet duhet të kenë për qëllim që të kuptohen ndikimet e ndryshme të blerjes së tokës, kufizimet në përdorimin e tokës, dhe zhvendosjen e pavullnetshme të burrave dhe grave. Në varësi të rëndësisë së ndikimeve, kjo mund të përfshijë sa më poshtë, sipas nevojës:
 - (i) analizën brenda familjeve për të identifikuar dallimet në burimet e mjeteve të jetesës ndërmjet burrave dhe grave, duke përfshirë ato informale;
 - (ii) analizën e të drejtave të grave mbi tokën dhe përdorimin e saj, duke përfshirë të drejtat mbi bashkëpronësinë dhe përdorimin mbi tokën e përbashkët dhe pasuritë e tjera; dhe
 - (iii) analizën e ndikimit që zhvendosja ka tek mundësia e grave për të punuar.

17. E drejta për kompensim dhe realizimi i tij do të marrë në konsideratë çështjet gjinore, duke përfshirë (i) veprimtaritë prodhuese dhe familjare të grave, (ii) mënyrat e drejta të pagesës së kompensimit në të holla, dhe (iii) pjesën e pronësisë mbi pronën e zhvendosur. Klienti duhet të marrë në konsideratë ofrimin e metodave dhe/ose mënyrave alternative të kompensimit, veçanërisht në vendet dhe rajonet ku gratë kanë më pak gjasa që të kenë qasje në institucionet financiare zyrtare dhe/ose llogaritë bankare. Në rrethanat kur legjislacioni kombëtar dhe sistemet e të drejtave pronësore nuk i njohin të drejtat e grave për të zotëruar apo shkëmbyer pronën, duhet të merren masat për t'u siguruar, që gratë të fitojnë sigurinë e të drejtave pronësore.
18. Procesi i konsultimit duhet të sigurojë që do të merren parasysh perspektivat e grave dhe interesat e tyre të faktorizohen në të gjitha aspektet e planifikimit dhe zbatimit të zhvendosjes. Do të shqyrtohen dhe dokumentohen preferencat e grave dhe burrave lidhur me mekanizmat e kompensimit, zëvendësimin e tokës dhe qasjen alternative në pasuri dhe burime natyrore.
19. Asistenca në përmirësimin dhe restaurimin e mjeteve të jetesës⁵⁸, si përmirësimi i veprimtarive bujqësore ekzistuese, trajnimi mbi aftësitë, qasja në financime, sipërmarrja dhe mundësitë e punësimit, duhet të vihen njësoj në dispozicion të burrave dhe grave, dhe të përshtaten sipas nevojave të tyre përkatëse.

Studimet socio-ekonomike

20. Klienti duhet të kryejë sondazhe socio-ekonomike për të përshkruar nevojat bazë të personave të prekur kur projekti mund të kërkojë shpërnguljen fizike ose ekonomike. Këto studime duhet të përdorin një ndërthurje të metodave sasiore dhe cilësore, dhe duhet të krijohet në mënyrë të tillë për të lehtësuar më tej monitorimin e kushteve sociale dhe ekonomike të personave të prekur. Sondazhet socio-ekonomike bazë duhet të:
 - përcaktojnë profilin social dhe ekonomik të komuniteteve dhe personave të prekur, duke i kategorizuar të dhënat sipas gjinisë dhe moshës;
 - identifikojnë burimet e mjeteve të jetesës që janë prekur dhe rëndësinë e tyre në mjetet e përgjithshme të jetesës së personave të prekur;
 - identifikojnë regjimet e të drejtave pronësore mbi tokën në zonën e prekur;
 - identifikojnë çështjet gjinore që mund të ndikojnë në blerjen e tokës dhe procesin e zhvendosjes; dhe
 - identifikojnë faktorët përkatës të cënueshmërisë dhe përcaktojnë një listë të grupeve të cënueshme.

⁵⁸ "Përmirësimi dhe restaurimi i mjeteve të jetesës" i referohet pagesave ose veprimtarive specifike që kanë për qëllim të mbështetin personat e prekur në përmirësimin ose të paktën restaurimin e mjeteve të tyre të jetesës krahasuar me nivelet përpara shpërnguljes.

Censusi, inventari i pasurive të prekura dhe afati i fundit

21. Klienti duhet të kryejë një census të personave të prekur për të: (i) identifikuar personat që preken nga projekti; dhe (ii) përcaktuar se kush përfiton kompensim dhe asistencë. Censusi duhet të marrë në konsideratë edhe përdoruesit e burimeve sezonale, të cilët mund të mos jenë të pranishëm në zonën e projektit në kohën e realizimit të censusit.
22. Klienti duhet të mbajë një inventar⁵⁹ të pasurive të prekura, duke përfshirë tokën, strukturat, të mbjellat, objektet e përbashkëta dhe burimet natyrore, për të përcaktuar bazën për vlerësimin e mëtejshëm të këtyre pasurive.
23. Klienti duhet të përcaktojë një datë kufi (afat) për kualifikimin⁶⁰ qoftë: (i) siç parashikohet në legjislacionin e zbatueshëm; apo (ii) duke përdorur datën përfundimtare të censusit ose inventarit (cilado është e fundit). Klienti duhet të informojë personat e prekur për afatin përfundimtar. Informacioni lidhur me afatin përfundimtar duhet të dokumentohet mirë dhe të komunikohet në të gjithë zonën e projektit në intervale të rregullta, me shkrim dhe me gojë (sipas rastit), dhe në gjuhët vendase përkatëse. Këtu duhet të përfshihen paralajmërimet të afishuara se personat që vendosen në zonën e projektit pas afatit përfundimtar mund të jenë subjekt i largimit. Nuk kërkohet që klienti të kompensojë ose asistojë personat oportunistë që shkelin në zonën e projektit pas afatit përfundimtar.
24. Data kufi për kualifikimin duhet të jetë e vlefshme qoftë: (i) për periudhën e parashikuar në legjislacionin kombëtar; ose (ii) për një periudhë të arsyeshme kohore nga data e censusit ose inventarit. Kur kalon një periudhë e gjatë ndërmjet afatit përfundimtar dhe kompensimit të tokës së prekur nga klienti, duhet të përditësohet censusi, inventari dhe vlerësimi pasues.

Vlerësimi i tokave dhe pasurive të prekura

25. Vlerësimi duhet të jetë në koston e plotë të zëvendësimit dhe duhet të kryhet nga vlerësues të kualifikuar. Metodologjia e vlerësimit për përcaktimin e koston së zëvendësimit duhet të dokumentohet dhe përfshihet në dokumentet përkatëse të planifikimit të zhvendosjes. Për të siguruar kompensimin me kosto zëvendësimi, normat e planifikuara të kompensimit mund të kërkojnë përditësim në zonat e projektit ku inflacioni është i lartë ose periudha kohore ndërmjet llogaritjes së normave të kompensimit dhe realizimit të kompensimit ka shteruar.

Klasifikimi i përfituesve (individëve që kualifikohen për përfitueshmëri)

26. Personat e prekur mund të klasifikohen si më poshtë:
 - (i) personat që kanë të drejta formale ligjore mbi tokën (duke përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale të njohura sipas legjislacionit kombëtar) ose pasuritë;
 - (ii) personat që nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën ose pasuritë në kohën e censusit, por që kanë pretendime për tokën ose pasuritë që njihen ose mund të njihen sipas legjislacionit kombëtar; ose
 - (iii) personat që nuk kanë pretendime apo të drejta të njohura me ligj mbi tokën ose pasuritë që ata zotërojnë apo përdorin.

⁵⁹ "Inventari" duhet të përfshijë një llogaritje të detajuar, të përgatitur nëpërmjet një procesi konsultues, të paanshëm dhe transparent, të tërësisë së të drejtave të mbajtura ose të njohura nga personat e prekur, duke përfshirë ato të bazuara në zakon apo praktikë, të drejtat dytësore si e drejta e aksesit ose përdorimit për qëllime të mjeteve të jetesës, dhe të drejtat në zotërim të përbashkët.

⁶⁰ Përfshin përcaktimin e personave të shpërngulur dhe kriteret për përcaktimin e pranueshmërisë së tyre për kompensim dhe ndihmë tjetër zhvendosjeje, duke përfshirë edhe datat përkatëse kufi.

Kompensimi dhe përfitimet për personat e prekur

27. Kur nuk mund të shmanget blerja e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës, pasuritë e tjera dhe burimet natyrore (qofshin të përhershme apo të përkohshme, klienti duhet të ofrojë kompensim⁶¹ për personat e prekur për vlerën e plotë të zëvendësimit, dhe asistencë sipas nevojës për t'i ndihmuar të përmirësojnë ose të paktën të ruajnë standardet e tyre të jetesës dhe të mjeteve të jetesës, që janë subjekt i dispozitave të kësaj KP-je.

28. Klienti duhet të ofrojë asistencë për zhvendosje⁶² për të gjithë personat e shpërngulur dhe asistencë në përmirësimin ose restaurimin e mjeteve të jetesës për personat e shpërngulur fizikisht, pavarësisht kategorive të përmendura më sipër. Gjithashtu, detyrimet e klientit lidhur me kompensimin janë si më poshtë për secilën prej tre kategorive të përshkruara në pikën 26:

Kategoria (i) Ofroni kompensim (në natyrë ose në të holla) për pronat e tyre të njohura me ligj⁶³ dhe pasuri të tjera për vlerën e plotë të zëvendësimit.

Kategoria (ii) Ofroni mbështetje ligjore për personat e prekur që t'u njihet pretendimi i tyre për tokën, në mënyrë që atyre t'u ofrohet më tej kompensim për pronën e tyre të njohur me ligj me kosto të plotë zëvendësimi, dhe mbuloni koston e këtij procesi njohjeje.

Kategoria (iii) Ofroni kompensim për strukturat ose zhvillimet mbi tokë (duke përfshirë të mbjellat dhe pemët), humbjen e burimeve të të ardhurave dhe të mjeteve të tjera të jetesës.

29. Standardet e kompensimit për kategoritë e tokës dhe të aktiveve afatgjata do të bëhen publike dhe do të zbatohen në vazhdimësi. Normat e kompensimit mund të jenë subjekt i përshtatjes rritëse kur përdoren strategjitë e negocimit. Në të gjitha rastet, duhet të dokumentohet një bazë e qartë për llogaritjen e kompensimit, dhe kompensimi duhet të shpërndahej në përputhje me procedurat transparente.

30. Kompensimi duhet të ofrohet përpara shpërnguljes ose vendosjes së kufizimeve për aksesimin etokës ose pasurisë. Kur përpjekjet e përsëritura për të kontaktuar pronarët e munguar kanë dështuar, kur personat e prekur nga projekti kanë refuzuar ofertat për kompensim të drejtë, ose kur pretendimet konkurruese për pronësinë e tokave apo pasurive iu nënshtrohen procedimeve të gjata ligjore, klienti mund të depozitojë fonde kompensimi të ofruara nga plani i zhvendosjes në një llogari me interesa dhe të vijojë veprimtaritë e projektit në përputhje me legjislacionin kombëtar. Me zgjidhjen e çështjeve të të drejtave të pronësisë, kompensimi duhet të vihet menjëherë në dispozicion të personave të pranueshëm.

31. Kur mjetet e jetesës të personave të shpërngulur janë të lidhura me tokën⁶⁴ ose kur toka është në pronësi kolektive, klienti duhet të ofrojë kompensim bazuar në tokë, përveçse nëse rezulton i përzgjedhshëm apo i papranueshëm për personat e prekur.

32. Pagesa e kompensimit në të holla për tokën ose pasuritë e humbura me kosto të plotë zëvendësimi në vend të kompensimit në natyrë mund të jetë e përshtatshme kur: (i) mjetet e jetesës nuk janë të lidhura me tokën; (ii) mjetet e jetesës janë të lidhura me tokën, por toka e marrë për projektin është një pjesë e vogël e pasurisë së prekur dhe toka e mbetur është e realizueshme ekonomikisht; ose (iii) ekzistojnë tregjet aktive për tokën, strehimin dhe punën, personat e shpërngulur i përdorin këto tregje, dhe nuk ka furnizim të mjaftueshëm me tokë dhe strehim.

33. Në rastet kur personat e prekur refuzojnë ofertat e kompensimit që përmbushin kërkesat e kësaj KP-je dhe, si rrjedhojë, nisin procedurat e shpronësimit dhe procedura të tjera ligjore, klienti duhet të shqyrtojë mundësi për të bashkëpunuar me autoritetet qeveritare përgjegjëse për të arritur rezultate të pajtueshme me këtë KP, duke përfshirë kompensimin me kosto të plotë zëvendësimi, asistencën për zhvendosje dhe asistencën për përmirësimin ose restaurimin e mjeteve të jetesës.

34. Kur preken komunitetet e popullsisë indigjene, klienti duhet të përmbushë kërkesat e zbatueshme të kësaj KP-je, si dhe ato të KP 7.

Dhurimet e vullnetshme të tokës

35. Në disa rrethana, mund të propozohet që një pjesë ose e gjithë toka për t'u përdorur nga projekti të dhurohet në mënyrë të vullnetshme pa pagesën e kompensimit të plotë. Duke qenë i nënshtrohet miratimit paraprak nga Banka, kjo mund të jetë e pranueshme me kushtin që klienti të tregojë se janë përmbushur kërkesat e mëposhtme:

- dhuruesi ose dhuruesit e mundshëm janë informuar dhe konsultuar si duhet rreth projektit dhe zgjedhjeve në dispozicion të tyre;
- dhuruesi ose dhuruesit e mundshëm kanë konfirmuar vullnetin e tyre me shkrim;
- nuk është përdorur detyrimi, frikësimi apo rryshfeti;
- sipërfaqja e tokës që dhurohet nuk duhet të ulë nivelet aktuale të mjeteve të jetesës të dhuruesit; dhe dhurimi i tokës përfshin mospasjen e ndikimit të mbetur në mjetet e jetesës;
- nuk është përfshirë rivendosja e familjes;
- pritjet që dhuruesit të përfitojnë drejtpërdrejt nga projekti;
- për tokën kolektive ose të komunitetit, dhurimi mund të ndodhë me pëlqimin e individëve që përdorin ose zaptojnë tokën; dhe
- klienti duhet të mbajë një regjistër transparent të të gjitha konsultimeve dhe marrëveshjeve të arritura.

⁶¹ "Kompensimi" i referohet pagesës në të holla ose në natyrë për humbjen e tokës, pasurive të tjera ose burimeve natyrore dhe aksesit në to, të cilat blihen ose preken nga projekti.

⁶² "Ndihma për zhvendosjen" i referohet asistencës teknike dhe financiare të ofruar për personat e shpërngulur krahas kompensimit për të mbështetur përpjekjet e tyre për rivendosje në shtëpinë e re dhe restaurimin e mjeteve të tyre të jetesës.

⁶³ "Prona" i referohet një godine, toke, ose të dyjave bashkërisht, duke përfshirë aktivet afatgjata bashkëlidhur tokës, siç janë pemët dhe strukturat ndihmëse.

⁶⁴ "Mjetet e jetesës të lidhura me tokën" iu referohen veprimtarive si kultivimi i të mbjellave dhe kullotja e bagëtive, si dhe kultivimit të burimeve natyrore.

Humbja e strukturave komunitare, shërbimeve dhe objekteve publike

36. Kur një projekt përfshin humbjen e strukturave komunitare, shërbimeve dhe objekteve publike, ose të aksesit në to, klienti duhet t'i zëvendësojë këto për të siguruar një nivel më të mirë apo të ngjashëm të shërbimit, bazuar në konsultimin me komunitetin e prekur⁶⁵ dhe palët qeveritare përkatëse të interesit për të identifikuar dhe për të rënë dakord mbi alternativa të përshtatshme.

Përfshirja e palëve të interesit

37. Konsultimi kuptimplotë i personave dhe komuniteteve të prekura, duke përfshirë komunitetet pritëse⁶⁶, duhet të organizohet nga klienti gjatë gjithë procesit të planifikimit dhe zbatimit të zhvendosjes në përputhje me parimet dhe proceset e parashikuara në KP 10, dhe duhet të mbështetet nga bërja publike e informacionit përkatës, si më poshtë:
- bërja publike e informacionit përkatës dhe konsultimi kuptimplotë i personave dhe komuniteteve të prekura duhet të ndodhë gjatë shqyrtimit të planeve alternative të projektit;
 - zhvendosja dhe përmirësimi ose restaurimi i mjeteve të jetesës duhet të përfshijë mundësi dhe alternativa nga të cilat personat dhe komunitetet e prekura mund të zgjedhin;
 - konsultimi kuptimplotë duhet të zhvillohet gjatë gjithë planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të procesit të blerjes së tokës dhe të zhvendosjes, duke përfshirë përmirësimin ose restaurimin e mjeteve të jetesës;
 - zbatohen dispozita shtesë për konsultimet me popullsinë indigjene të shpërngulur, në përputhje me KP 7;
 - konsultimi gjatë fazës së planifikimit me të gjithë grupet e prekura dhe palët përkatëse të interesit, duke përfshirë burrat dhe gratë, dhe grupet e cënueshme, duhet të dokumentohet në planin e zhvendosjes që kërkohet nga kjo KP; dhe
 - konsultimi gjatë fazave të zbatimit dhe monitorimit duhet të dokumentohet.
38. Në hartimin e masave të konsultimit, klienti duhet të sigurohet që të gjitha grupet, duke përfshirë ato të cënueshme, të informohen dhe të vihen në dijeni për titujt e tyre të pronësisë, të drejtat, mundësitë dhe përfitimet.
39. Klienti duhet të mbështesë përpjekjet për konsultim dhe angazhim me dokumentacion të thjeshtë, praktik, të saktë dhe të përshtatshëm në aspektin kulturor, i cili do t'iu shpërndahet personave të prekur.

Mekanizmi i ankesave

40. Klienti duhet të ngrejë një mekanizëm ankesash efikas, sa më herët që të jetë e mundur, lidhur me procesin e blerjes së tokës dhe zhvendosjes, dhe të paktën përpara kryerjes së censusit, për të trajtuar shqetësimet specifike rreth masave të kompensimit, rivendosjes ose restaurimit të mjeteve të jetesës të ngritura nga personat e shpërngulur (ose të tjerë) në kohën e duhur. Menaxhimi i ankesave duhet të jetë në përputhje me objektivat dhe parimet lidhur me menaxhimin e ankesave që përfshihet në KP 10. Ai duhet të përfshijë mekanizmin e burimeve të projektuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të paanshme. Rezultatet e mekanizmit të ankesave (duke përfshirë numrin e ankesave të marra, të zgjidhura dhe atyre pezull) duhet të pasqyrohen në raportet e monitorimit.

Planifikimi dhe zbatimi

41. Për të trajtuar rreziqet dhe ndikimet e identikuara në vlerësimin mjedisor dhe social, klienti duhet të përgatisë një plan zhvendosjeje në përputhje me risqet dhe ndikimet e lidhura me projektin:
- (i) për projekte që konsistojnë në shpronësime minimale të tokës ose kufizime të pakta në përdorimin e tokës, si rrjedhojë e të cilave nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në mjetet e jetesës, plani duhet të vendosë kriteret e kualifikimit për personat e prekur, të përcaktojë procedurat dhe standardet për kompensimin, dhe të përfshijë marrëveshjet për konsultimet, monitorimin dhe trajtimin e ankesave;
 - (ii) për projekte që shkaktojnë shpërnguljen fizike, plani duhet të përcaktojë masa shtesë lidhur me rivendosjen e personave të prekur;
 - (iii) për projekte që përfshijnë shpërnguljen ekonomike me ndikime të konsiderueshme në mjetet e jetesës ose në krijimin e të ardhurave, plani duhet të përcaktojë masa shtesë lidhur me përmirësimin ose ruajtjen e mjeteve të jetesës; dhe
 - (iv) për projekte që mund të vendosin ndryshime në përdorimin e tokës që kufizojnë aksesin në burime në parqe ose zona të mbrojtura të shpallura me ligj, ose në burime të tjera të pronës kolektive nga të cilat banorët vendas mund të varen për qëllime të mjeteve të jetesës, plani duhet të krijojë një proces me pjesëmarrje për vendosjen e kufizimeve të përshtatshme mbi përdorimin, dhe të përcaktojë masat lehtësuese për të adresuar ndikimet negative në mjetet e jetesës që mund të sjellin këto kufizime.
42. Duhet të hartohet plani i zhvendosjes, në të cilin mund të përcaktohet natyra dhe shkalla e ndikimeve lidhur me blerjen e tokës në kohën e vlerësimit mjedisor dhe social, i cili duhet t'i paraqitet Bankës. Planin duhet të bazohet në informacion të përditësuar dhe të besueshëm rreth: i) projektit të propozuar dhe ndikimeve të tij të mundshme të personat e shpërngulur dhe grupet e tjera të prekura negativisht; ii) matricës së të drejtave që përcakton të drejtat e kompensimit (qoftë në të holla apo në natyrë) për secilin kategori të humbjeve dhe secilin grup të personave të prekur; iii) masave lehtësuese të përshtatshme dhe të realizueshme për të gjitha ndikimet e identikuara; iv) rregullimeve ligjore dhe institucionale të kërkuara për zbatimin efikas të masave të zhvendosjes; dhe v) buxhetit të alokuar posaçërisht për zhvendosjen që është në përpjesëtim me masat lehtësuese.

⁶⁵ "Komuniteti i prekur" i referohet komunitetit të prekur nga projekti siç përcaktohet në KP 1 dhe pjesëtarëve të tyre që përjetojnë shpërngulje fizike ose ekonomike. Komunitetet e prekura përfshijnë komunitetet pritëse

⁶⁶ "Komunitetet pritëse" iu referohen komuniteteve në dhe përreth zonave ku do të zhvendosen personat e shpërngulur fizikisht nga projekti.

43. Në raste specifike dhe subjekt i miratimit të Bankës, kuadri i zhvendosjes mund të jetë i pranueshëm si hap i parë drejt zhvillimit të një plani zhvendosjeje, nëse ka një arsye bindëse dhe të identifikuar qartë lidhur me fazën e zhvillimit të projektit që pengon zhvillimin e planit të plotë të zhvendosjes. Kuadri i zhvendosjes duhet të përgatitet nga klienti, në të cilin natyra ose shkalla e ndikimeve lidhur me blerjen e tokës janë të panjohura për shkak të fazës së zhvillimit të projektit, dhe për këtë arsye nuk mund të zhvillohet census i detajuar i personave dhe pasurive të prekura. Qëllimi i kuadrit të zhvendosjes është qartësimi i parimeve të zhvendosjes dhe i marrëveshjeve organizative. Me përcaktimin mjaft të detajuar të komponentëve të projektit, duhet të përgatitet një plan i detajuar zhvendosjeje në përputhje me risqet dhe ndikimet e mundshme, në përputhje me kërkesat e kësaj KP-je në bazë të kuadrit të zhvendosjes.
44. Dokumentet e planifikimit të zhvendosjes duhet të integrohen në sistemin e menaxhimit mjedisor dhe social që kërkohet nga KP 1. Për projektet e kategorisë A, ato duhet të dorëzohen si pjesë e VNMS-së që kërkohet në kuadër të KP 1 dhe duhet të bëhen publike sipas të njëjtit proces të shqyrtimit dhe angazhimit dhe afatit kohor të përcaktuar në KP 10. Kur shkalla e ndikimeve të shpërnguljes është e konsiderueshme, Banka mund të kërkojë bërjen publike të dokumenteve të planifikimit të zhvendosjes për projektet e kategorisë B. Informacioni konfidencial lidhur me individët dhe buxhetet e kompensimit duhet të hiqet nga dokumentet e planifikimit të zhvendosjes, të cilat janë parashikuar për t'u bërë publike.

Kapaciteti organizativ dhe angazhimi

45. Klienti duhet të zbatojë kërkesat e KP 1 për veprimtaritë e blerjes së tokës dhe të zhvendosjes kur gjejnë zbatim, dhe të ngrejë, mirëmbajë dhe forcojë posaçërisht, sipas nevojës, një strukturë organizative që përcakton rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin për të zbatuar blerjen e tokës dhe zhvendosjen në përputhje me këtë KP. Klienti duhet të caktojë personel të posaçëm, duke përfshirë përfaqësues të drejtuesve, me përgjegjësi dhe autoritet të përcaktuar qartë për të planifikuar dhe zbatuar veprimtaritë e blerjes së tokës dhe zhvendosjes. Klienti duhet të ofrojë vazhdimisht mbështetje dhe burime njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për të arritur përbushjen efikase dhe të vazhdueshme të angazhimeve të bëra lidhur me blerjen e tokës dhe zhvendosjen.

Projektet e sektorit privat me blerjen e tokës nën menaxhimin e qeverisë dhe me zhvendosjen

46. Blerja e tokës dhe zhvendosja mund të përfshijnë përgjegjësitë e qeverisë, madje edhe kur projekti zotërohet privatisht. Në këto raste, klienti duhet të: (i) përfshijë agjencitë qeveritare përgjegjëse që në fazë të hershme të procesit të zhvillimit të projektit për të shqyrtuar mënyra dhe mjete lidhur me arritjen e përputhshmërisë me këtë KP; (ii) kërkojë të luajë një rol aktiv në blerjen e tokës dhe në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zhvendosjes; dhe (iii) bashkëpunojë me agjencinë qeveritare përkatëse, në masën e lejuar nga agjencia, për të arritur rezultate që janë në përputhje me objektivat e kësaj KP-je. Gjithashtu, kur kapacitetet qeveritare janë të kufizuara, klienti duhet të mbështesë përpjekjet e qeverisë në proceset e blerjes së tokës dhe zhvendosjes.
47. Klienti është përgjegjës për identifikimin e hendeqeve ndërmjet legjislacionit vendas dhe praktikës qeveritare nga njëra anë dhe kërkesave të kësaj KP-je mbi të tjerat (pra, normat e kompensimit, pranueshmëria e zaptuesve joformalë, ose konsultimi dhe bërja publike). Me identifikimin e hendeqeve, klienti duhet të marrë përgjegjësinë për t'i mbushur këto hendeqe në mënyrë të pranueshme për qeverinë dhe Bankën.

48. Klienti duhet të përgatisë një plan ose një kuadër zhvendosjeje për të plotësuar dokumentet e përgatitura nga agjencia qeveritare përkatëse, nëse kërkohen për të përbushur këtë KP. Në këtë plan, klienti duhet të përfshijë: (i) një përshkrim të të drejtave të personave të shpërngulur që parashikohen në ligjet dhe rregulloret e zbatueshme; (ii) masat e propozuara për të mbushur çdo hendek ndërmjet këtyre të drejtave dhe kërkesave të kësaj KP-je; dhe (iii) përgjegjësitë financiare dhe të zbatimit të agjencisë qeveritare dhe/ose klientit në realizimin e këtij plani.

Monitorimi dhe vlerësimi

49. Klienti duhet të hartojë procedura për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e planit të zhvendosjes dhe të marrë veprime korrigjuese, nëse është e nevojshme, gjatë zbatimit për të arritur objektivat e kësaj KP-je. Monitorimi i procesit të blerjes së tokës, zhvendosjes dhe përmirësimit ose restaurimit të mjeteve të drejtave duhet të kryhet në përputhje me KP 1 dhe duhet të përfshijë pjesëmarrjen e palëve kyç të interesit, duke përfshirë komunitetet e prekura.
50. Shkalla e veprimtarive të monitorimit duhet të jetë në përputhje me rreziqet dhe ndikimet e projektit. Për të gjitha projektet me ndikime të konsiderueshme të shpërnguljes, klienti duhet të angazhojë profesionistë kompetentë për zhvendosjen për të monitoruar zbatimin e planeve të zhvendosjes, duhet të përgatisë veprime korrigjuese sipas nevojës, të ofrojë këshilla mbi përputhshmërinë me këtë KP, dhe të krijojë raporte periodike të monitorimit të brendshëm. Këto raporte monitorimi duhet të përfshijnë progresin e shënuar krahasuar me treguesit kyç të performancës të përcaktuar në planin e zhvendosjes, dhe duhet t'i dorëzohen Bankës si pjesë e raporteve periodike të monitorimit mjedisor dhe social që kërkohen nga KP 1.
51. Përgjegjësitë për t'i dorëzuar Bankës raportet e monitorimit i takojnë klientit, madje edhe kur blerja e tokës dhe zhvendosja zbatohen nga një palë e tretë, siç është qeveria.

52. Klienti duhet të sigurojë verifikimin e zbatimit të planit të zhvendosjes nëpërmjet dorëzimit dhe miratimit të raportit të realizimit të blerjes së tokës dhe të zhvendosjes⁶⁷ nga Banka, me përfundimin e të gjitha veprimtarive.
53. Kur shkalla e ndikimeve të shpërnguljes është e konsiderueshme, krahas monitorimit të brendshëm, Banka mund të kërkojë një ose të dyja pikat e mëposhtme:
- vlerësime periodike të jashtme të përputhshmërisë⁶⁸ me shpeshtësi dhe sipas termave të referencës të përcaktuar në planin e zhvendosjes, dhe në marrëveshje me Bankën; dhe/ose
 - një audit të jashtëm përfundimtar të veprimtarive të blerjes së tokës dhe të zhvendosjes për të përcaktuar nëse janë përmbushur kërkesat në këtë KP dhe dispozitat në planin e zhvendosjes, veçanërisht ato lidhur me përmirësimin ose zëvendësimin e strehimit ose të mjeteve të jetesës. Plani i zhvendosjes duhet të përcaktojë afatin kohor, objektin dhe treguesit e suksesit të kontrollit të përfundimit. Kontrolli i përfundimit duhet të kryhet nga profesionistë kompetentë për zhvendosjen pas realizimit të masave të përmirësimit ose restaurimit të mjeteve të jetesës, dhe pas matjes të rezultateve të tyre. Raporti i kontrollit të përfundimit do të identifikojë veprimet korrigjuese nëse evidentohen mangësi dhe, nëse është e nevojshme, duhet të përfshijë një plan të veprimeve korrigjuese.
54. Klientit mund t'i kërkohej të bëjë publike raportet e monitorimit (duke përfshirë raporte të rishikimit të përputhshmërisë dhe raportin e kontrollit të përfundimit) në të cilat shkalla e ndikimeve të shpërnguljes është e konsiderueshme.

Shpërngulja fizike dhe asistenca për zhvendosjen

55. Në rastet kur shpërngulja fizike nuk mund të shmanget nëpërmjet planit të projektit, klienti duhet të hartojë një plan zhvendosjeje që mbulon, të paktën, kërkesat e zbatueshme të kësaj KP-je, pavarësisht numrit të personave të prekur. Plani duhet të hartohet për të zburuar ndikimet negative të shpërnguljes dhe, siç rekomandohet, për të identifikuar mundësitë për zhvillim. Ai duhet të përfshijë buxhetin e zhvendosjes dhe kalendarin e zbatimit, dhe të përcaktojë të drejtat e të gjitha kategorive të personave të prekur (duke përfshirë komunitete pritëse). Plani duhet të përfshijë marrëveshje për të monitoruar efikasitetin e masave të shpërnguljes fizike dhe të mjeteve të jetesës gjatë zbatimit, si dhe vlerësimin me përfundim e zbatimit. Vëmendje e veçantë iu duhet kushtuar aspekteve gjinore dhe nevojave të grupeve të cënueshme. Klienti duhet të dokumentojë të gjitha transaksionet për të përfutur të drejtat mbi tokën, ofrimin e kompensimit dhe llojeve të tjera të asistencës lidhur me veprimtaritë e rivendosjes.

56. Klienti duhet t'iu ofrojë personave të shpërngulur një zgjidhje ndërmjet pronës zëvendësuese të një prone me vlerë të barabartë ose më të lartë me sigurinë e të drejtave pronësore, karakteristikave të barasvlerëshme ose më të mira, dhe avantazheve të vendndodhjes, ose kompensimit në të holla me kosto zëvendësimi, nëse dëshmohej se alternativat e pronës zëvendësuese nuk janë të mundshme apo të pranuar nga personat e prekur. Strukturat zëvendësuese (duke përfshirë strehimin) dhe/ose kompensimi në të holla duhet të vihen në dispozicion përpara rivendosjes. Zonat e zhvendosjes të ndërtuara për personat e shpërngulur duhet të ofrojnë minimalisht strehim të duhur, kushte jetese dhe qasje në shërbime të paktën të barasvlerëshme me ato ekzistuese përpara shpërnguljes, si dhe mundësi të qëndrueshme dhe me kosto efikase për të përmirësuar ose minimalisht ruajtur mjetet e jetesës. Kostoja e lëvizjes dhe rivendosjes së shërbimeve bazë në shtëpitë e reja duhet të paguhet nga klienti.
57. Klienti duhet të informojë personat e shpërngulur fizikisht lidhur me afatin kohor të lëvizjes fizike me njoftim të arsyeshëm dhe pas konsultimit, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, ndikimet e mundshme në kalendarët për bujqësinë dhe shkollimin.
58. Klienti duhet të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme negative të komunitetëve pritëse që mund të preken nga procesi i zhvendosjes. Masat zbutëse të konsultuara me komunitete pritëse duhet të përfshihen në planin e zhvendosjes.
59. Kur zhvillimi i zonave të zhvendosjes dhe rindërtimi i strukturave të strehimit ose i strukturave të tjera të prekura bëhet nga klienti, zbatohen të gjitha kërkesat e performancës.
60. Klienti duhet të ofrojë asistencë për zhvendosje të përshtatur me nevojat e çdo grupi të personave të prekur, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të grupeve të cënueshme.

Shpërngulja ekonomike dhe përmirësimi ose ruajtja e mjeteve të jetesës

61. Në rastin e projekteve që prekin mjetet e jetesës ose krijimin e të ardhurave, klienti duhet të planifikojë masa për të përmirësuar, ose të paktën restauruar, të ardhurat apo mjetet e jetesës të personave të prekur. Plani duhet të përcaktojë të drejtat e personave dhe/ose të komuniteteve të prekura, do t'i kushtojë vëmendje të veçantë aspekteve gjinore dhe nevojave të grupeve të cënueshme, dhe do të sigurojë që ato të ofrohen në mënyrë transparente, konsistente dhe të drejtë. Plani duhet të përfshijë marrëveshje për të monitoruar efikasitetin e masave për mjetet e jetesës gjatë zbatimit, si dhe vlerësimin me përfundim e zbatimit. Zbutja e shpërnguljes fizike duhet të konsiderohet e plotë kur në kontrollin e përfundimit arrihet në përfundimin se personat ose komunitetet e prekura kanë marrë të gjithë asistencën për të cilën janë të pranueshëm, dhe u është ofruar mundësia e duhur për të restauruar mjetet e tyre të jetesës.

⁶⁷ "Raporti i realizimit të blerjes së tokës dhe zhvendosjes" i referohet një raportit të finalizuar me përfundimin e veprimtarive të blerjes së tokës, zhvendosjes dhe restaurimit të mjeteve të jetesës, i cili përfshin: përmbledhjen e ndikimeve të projektit (shpërngulja fizike dhe ekonomike) dhe parimet që drejtojnë planin e zhvendosjes; përshkrimin e përpjekjeve për të shmangur dhe minimizuar shpërnguljen; përmbledhjen e aktivitetëve dhe rezultateve të konsultimit, duke përfshirë mënyrën se si ato kanë ndikuar në të drejtat dhe veçoritë e tjera të veprimtarive të blerjes së tokës, zhvendosjes dhe restaurimit të mjeteve të jetesës; përshkrimin e procesit të realizimit të kompensimit; përshkrimin e çdo problematike të ndeshur dhe të mënyrës së zgjidhjes së tyre; përmbledhjen e ankesave të marra dhe se si ato janë zgjidhur, duke përfshirë listën e çdo ankesë dhe çështjeje gjyqësore pezull në datën e dorëzimit të raportit; përshkrimin e burimeve të mobilizuara për të planifikuar dhe zbatuar veprimtaritë e blerjes së tokës, zhvendosjes dhe restaurimit të mjeteve të jetesës.

⁶⁸ "Rishikimi i jashtëm i përputhshmërisë" i referohet rishikimeve periodike të jashtme të veprimtarive të blerjes së tokës dhe të zhvendosjes, të ndërmarrura gjatë planifikimit dhe zbatimit të këtyre veprimtarive për të përcaktuar nëse janë përmbushur kërkesat e kësaj KP-je dhe dispozitat e planit të zhvendosjes. Ai do të përfshijë rekomandime për të korrigjuar çdo hendek të evidentuar.

62. Ndikimet në të ardhura ose në mjetet e jetesës që nuk janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e blerjes së tokës apo e kufizimeve në përdorimin e tokës duhet të përfshihen si pjesë e procesit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social në përputhje me kërkesat e KP 1. Masat për kompensimin dhe ruajtjen e mjeteve të jetesës për këto ndikime duhet të ndërmerren në përputhje me parimet e kësaj KP-je.

63. Në varësi të llojit të ndikimeve, masat për përmirësimin ose ruajtjen e mjeteve të jetesës duhet të përfshijnë sa më poshtë:

- kur blerja e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës prekin bizneset⁶⁹, kompensimi i pronarit ose operatorit të biznesit të prekur për: (i) koston e rithemelimit të veprimtarive diku tjetër; (ii) për humbjen e të ardhurave neto gjatë periudhës kalimtare⁷⁰; dhe (iii) për koston e transferimit dhe të riinstalimit të impiantit, makinerive apo pajisjeve të tjera, sipas rastit;
- në rastet kur projekti prek persona me të drejta ligjore mbi tokën që njihen ose janë të njohura sipas legjislacionit kombëtar, ofrimi i tokës ose pronës zëvendësuese me vlerë të barabartë ose më të madhe, ose kompensim në të holla me koston e zëvendësimit, sipas rastit;
- personat e shpërngulur ekonomikisht që nuk kanë pretendime të njohura ligjërisht mbi tokën duhet të kompensohen për pasuritë e humbura, jo tokë, (siç janë kulturat bujqësore, infrastruktura e ujitjes dhe përmirësimet e tjera që i bëhen tokës), me koston e zëvendësimit. Gjithashtu, klienti duhet të ofrojë

asistencë në vend të kompensimit të tokës të mjaftueshme për t'iu dhënë këtyre personave një mundësi për të rikrijuar mjetet e tyre të jetesës diku tjetër;

- kur preken burimet natyrore të përdorura kolektivisht, nisma që përmirësojnë rendimentin e burimeve të mbetura në të cilat ka qasje komuniteti, dhe kompensim në të holla ose në natyrë për humbjen e saj, ose ofrim e qasjes në burime alternative për burimin e humbur;
- ofrimi i asistencës shtesë me objekt të përcaktuar mirë dhe mundësi për të restauruar dhe, kur mundet, për të përmirësuar kapacitetin e nxjerrjes së të ardhurave, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës. Në rastin e veprimtarive tregtare që vuajnë humbje të përkohshme ose që u duhet të mbyllen si pasojë e shpërnguljes lidhur me projektin, si pronari i biznesit ashtu edhe punonjësit që humbin pagën ose vendin e punës, kanë të drejtë të përfitojnë një asistencë të tillë;
- ofrimi i mbështetjes gjatë periudhës kalimtare për personat e shpërngulur ekonomikisht, sipas nevojës, në bazë të një vlerësimi të arsyeshëm të kohës që nevojitet për të restauruar kapacitetin e nxjerrjes së të ardhurave, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës; dhe
- ofrimi i mundësive për personat dhe komunitetet e shpërngulura për të nxjerrë përfitimet e duhura të zhvillimit nga projekti.

⁶⁹ "Bizneset" përfshijnë dyqane, restorante, shërbime, struktura prodhimi dhe ndërmarrje të tjera, pavarësisht madhësisë dhe faktit nëse janë apo jo të licensuar.

⁷⁰ "Periudha kalimtare" i referohet periudhës midis kohës së shpërnguljes dhe kohës së restaurimit të mjeteve të prekura të jetesës.

Kërkesa e Performancës 6 e BERZH-it: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla

Hyrje

1. Kjo Kërkesë Performance (KP) pranon se ruajtja e biodiversitetit⁷¹ dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla⁷² janë themelore për qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale.
2. Kjo KP njih rëndësinë e ruajtjes së funksioneve ekologjike bazë të habitateve ⁷³, biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit⁷⁴. Të gjitha ekosistemet mbështetin një kompleksitet organizmesh të gjallë dhe ndryshojnë për sa i takon pasurisë, sasisë dhe rëndësisë së llojeve.
3. Objektivi i ruajtjes së biodiversitetit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve të gjalla duhet të vihet në drejtpeshim me mundësinë për shfrytëzimin në mënyrë optimale të vlerave të shumta ekonomike, sociale dhe kulturore të biodiversitetit dhe të burimeve natyrore të gjalla.

Objektivat

4. Objektivat e kësaj KP-je janë:
 - mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit duke përdorur një qasje të kujdesshme;
 - zbatimi i hierarkisë së minimizimit në projektimin dhe zbatimin e projekteve, me qëllim arritjen e humbjes neto zero dhe, kur është e mundur, arritjen e fitimit neto të biodiversitetit;
 - ruajtja e shërbimeve të ekosistemit; dhe
 - promovimi i praktikës së mirë ndërkombëtare në menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e burimeve natyrore të gjalla

Fusha e zbatimit

5. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet e financuara drejtpërdrejt nga BERZH-i, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të kësaj KP-je dhe mënyrën si do të trajtohen dhe menaxhohen ato përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të kësaj KP-je duhet të menaxhohet në kuadër të Sistemit të përgjithshëm të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të klientit dhe Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) specifik të projektit për të strukturuar projektin që të përmbushë këtë KP brenda një afati kohor të pranueshëm. Kërkesat për menaxhimin dhe vlerësimin mjedisor dhe social janë paraqitur në KP 1.

6. Kjo KP zbatohet edhe për situatat kur mjetet e jetesës të komuniteteve të prekura, duke përfshirë ato të popullsisë indigjene, aksesit i të cilëve ose përdorimi i biodiversitetit, shërbimeve të ekosistemit dhe/ose burimeve natyrore të gjalla mund të preket nga veprimtaritë e projektit. Në këtë KP është marrë në konsideratë edhe roli i mundshëm pozitiv i komuniteteve të prekura nga projektet, duke përfshirë popullsinë indigjene, në ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të gjalla.

Kërkesat

Ruajtja e biodiversitetit

Vlerësimi i risqeve dhe ndikimeve

7. Procesi i vlerësimit duhet të karakterizojë kushtet bazë në atë shkallë që të jetë përpjesëtimore dhe specifike për riskun e pritur dhe rëndësinë e ndikimeve. Vlerësimi i situatës fillestare duhet të marrë në konsideratë, por pa u kufizuar, risqet përkatëse në biodiversitet dhe shërbimet e ekosistemit, duke u përqendruar në humbjen e mundshme të habitatit, degradimin dhe copëzimin, invazionin e specieve të huaja, mbi-shfrytëzimin, korridorët e shtegtitimit, ndryshimet hidrologjike, ngarkesën dhe ndotjen ushqimore, si dhe ndikimet e lidhura me ndryshimet e klimës dhe përshtatjen ndaj tyre. Gjatë planifikimit dhe realizimit të vlerësimeve të situatës fillestare dhe të ndikimeve të lidhura me biodiversitetin, klienti duhet t'i referohet udhëzimit përkatës të praktikës së mirë, duke shfrytëzuar qasjen e studimit nga zyra dhe të studimit në terren, sipas nevojës. Kur nevojiten hetime të mëtejshme për të pasur një siguri më të madhe për rëndësinë e ndikimeve të mundshme, klienti duhet të kryejë studime dhe/ose monitorime shtesë përpara se të ndërmarrë veprimtaritë e lidhura me projektin, të cilat mund të shkaktojnë pasoja të pakthyeshme.
8. Përmes procesit të vlerësimit, klienti duhet të identifikojë dhe të karakterizojë, nga fillimi i ciklit të jetës së projektit, mundësitë, rreziqet dhe ndikimet në biodiversitet të lidhura me projektin. Shkalla e vlerësimit duhet të jetë e mjaftueshme për të karakterizuar ndikimet, në bazë të probabilitetit të tyre dhe në bazë të rëndësisë dhe shkallës së ndikimit, dhe duhet të pasqyrojë shqetësimet e komuniteteve që mund të preken dhe, kur ka, edhe të palëve të tjera të interesit. Vlerësimi duhet të shqyrtojë edhe ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe progresive dhe të vlerësojë efektivitetin dhe realizueshmërinë e masave zbutëse që do të zbatohen për projektin. Procesi i vlerësimit duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të ndikimeve të mundshme në peizazh, kufizimeve sezonale dhe/ose ndjeshmërive, si edhe ndikimet mbi paprekshmërinë ekologjike të këtyre ekosistemeve, pavarësisht statusit të tyre mbrojtës dhe pavarësisht shkallës së prekjës ose degradimit të tyre.

⁷¹ Për qëllime të kësaj KP-je, biodiversiteti përkufizohet sipas Konventës për biodiversitetin biologjik si "larmia mes organizmave të gjallë nga të gjitha burimet, që përfshijnë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike pjesë e të cilave janë; kjo përfshin diversitetin brenda llojeve, ndërmjet llojeve dhe ndërmjet ekosistemeve e peizazheve".

⁷² "Burime natyrore të gjalla" përkufizohen si "bimë dhe kafshë të kultivuara për përdorim dhe konsum nga njerëzit dhe kafshët, pavarësisht nëse janë në gjendje të lirë apo të kultivuar. Këtu përfshihen të gjitha llojet e pylltarisë, biokarburantet, bujqësia, duke përfshirë kulturat njëvjeçare dhe shumëvjeçare, dhe blegtorinë; si dhe peshkun e egër dhe atë të kapur, duke përfshirë të gjitha organizmat e detit dhe të ujërave të ëmbla, vertebrorë ose jo".

⁷³ Habitatet përkufizohen si një njësi gjeografike tokësore, të ujërave të ëmbla ose detare, ose si korridor ajror që mbështet një tërësi organizmesh të gjalla dhe ndërveprimet e tyre me mjedisin jo të gjallë.

⁷⁴ Shërbimet e ekosistemit janë përfitime që njerëzit, duke përfshirë bizneset, nxjerrin nga ekosistemet. Shërbimet e ekosistemit janë të ndara në katër lloje: (i) shërbime ofrimi, të cilat janë produkte që njerëzit i marrin nga ekosistemet; (ii) shërbime rregulluese, të cilat janë përfitimet që njerëzit marrin nga rregullimi i proceseve të ekosistemit; (iii) shërbime kulturore, të cilat janë përfitime jomateriale që njerëzit marrin nga ekosistemet; dhe (iv) shërbime mbështetëse, të cilat janë procese natyrore që mbështetin shërbime të tjera.

9. Në përputhje me PMN-në, vlerësimi duhet të marrë në konsideratë: (i) ndikimet e mundshme të projektit në shërbimet e ekosistemit, duke përfshirë ato që mund të përkeqësohen nga ndryshimet klimatike; dhe (ii) përdorimin dhe varësinë në këto shërbime ekosistemi të komuniteteve me gjasë të prekura dhe/ose popullsisë indigjene; dhe (iii) varësinë e projektit në këto shërbime ekosistemi. Kur projekti ka potencialin për të ndikuar në këto shërbime ekosistemi dhe kur klienti ushtron kontroll të drejtpërdrejtë menaxhimi, ose ushtron ndikim të konsiderueshëm, duhen shmangur ndikimet negative. Nëse këto ndikime nuk mund të shmangen, klienti duhet të zbatojë masa për të minimizuar ndikimet dhe/ose për të restauruar biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit.
10. Për projektet që mund të kenë ndikime të tilla të mundshme të popullsia indigjene dhe të komunitetet vendore, klienti duhet të ofrojë mundësi për ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të gjalla, në përputhje me: (i) kërkesat për trajtimin e çështjeve të shpërnguljes ekonomike të KP 5; (ii) kërkesat e veçanta në lidhje me menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme për popullsinë indigjene të KP 7; dhe (iii) kërkesat për angazhimin e palëve të interesit, të parashikuara në KP 10.

Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit, karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe habitatet kritike

11. Kur vlerësimi ka identifikuar ndikime të mundshme të lidhura me projektin që prekin biodiversitetin, klienti duhet t'i menaxhojë rreziqet e tij në përputhje me hierarkinë e minimizimit të riskut dhe PMN-në. Klienti duhet të ndjekë një qasje të kujdeseshme dhe të zbatojë praktika përshtatëse menaxhimi, në të cilat zbatimi i masave lehtësuese dhe menaxhuese reagon sipas ndryshimit të kushteve dhe rezultateve të monitorimit të projektit gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit.
12. Pavarësisht sa më lart, disa aspekte të prekura nga projekti mund të konsiderohen "karakteristika kryesore të biodiversitetit"⁷⁵ ku përfshihen: (i) habitatet e rrezikuara; (ii) llojet e pambrojtura; (iii) karakteristika kryesore të biodiversitetit të identifikuar nga një tërësi e gjerë palësh interesi ose autoritetesh; dhe (iv) struktura dhe funksionet ekologjike të nevojshme për të ruajtur qëndrueshmërinë e karakteristikave kryesore të biodiversitetit, që përshkruhen në këtë pikë.
13. Kur vlerësimi ka identifikuar se projekti mund të ketë ndikime të konsiderueshme, negative dhe të pakthyeshme mbi karakteristikat kryesore të biodiversitetit, klienti nuk duhet të zbatojë asnjë veprimtari të lidhur me projektin nëse:

- klienti tregon se ka alternativa të tjera teknike dhe ekonomike të realizueshme;
- palët e interesit nuk janë konsultuar në përputhje me KP 10;
- projekti nuk lejohet sipas ligjeve mjedisore në fuqi, që njohin karakteristikat kryesore të biodiversitetit; dhe
- nuk zbatohen masat e duhura zbutëse, në përputhje me hierarkinë e minimizimit të riskut, për të siguruar që të mos ketë asnjë humbje neto⁷⁶ dhe që mundësisht të ketë një fitim neto për karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe habitatet dhe funksionet ekologjike që i mbështetin ato në periudhën afatgjatë, për të arritur rezultate të matshme të ruajtjes.

14. Karakteristikat më të ndjeshme të biodiversitetit përkufizohen si habitat kritik, i cili përfshin një prej elementeve të mëposhtme: (i) ekosisteme unike ose tejet të rrezikuara; (ii) habitate me rëndësi të konsiderueshme për llojet e rrezikuara⁷⁷ ose tejet të rrezikuara; (iii) habitate me rëndësi të konsiderueshme për llojet endemike ose gjeografikisht të kufizuara; (iv) habitate që mbështetin llojet shtegtare ose tubuese me rëndësi globale; (v) zonat e shoqëruara me proceset kyç të evolucionit.

15. Habitatat me rëndësi kritike nuk duhet copëzuar, konvertuar apo degraduar më tej deri aty sa të komprometohet integriteti ekologjik ose rëndësia e biodiversitetit. Për pasojë, në zonat me habitate të rëndësishme kritike, klienti nuk duhet të zbatojë asnjë veprimtari të projektit nëse nuk përmbushen kushtet e mëposhtme:

- nuk ekzistojnë alternativa të tjera të realizueshme brenda rajonit për zhvillimin e projektit në habitate me vlerë më të ulët biodiversiteti;
- palët e interesit nuk janë konsultuar në përputhje me KP 10;
- projekti lejohet sipas ligjeve mjedisore në fuqi, që njohin karakteristikat kryesore të biodiversitetit;
- projekti nuk sjell ndikime negative të matshme⁷⁸ mbi ato karakteristika të biodiversitetit për të cilat është caktuar habitatat me rëndësi kritike, siç përcaktohet në pikën 14;
- projekti është planifikuar për të nxjerrë fitime neto⁷⁹ për habitatin kritik të ndikuar nga projekti;

⁷⁵Karakteristikat kryesore të biodiversitetit janë një nënbashkësi e biodiversitetit që është veçanërisht e pazvëndësueshme ose më e ndjeshme, por me një nivel prioriteti më të ulët se habitatet kritike (të përkufizuara në pikën 13).

⁷⁶ "Jo humbje neto" përcaktohet si pika në të cilën humbjet në biodiversitet të lidhura me projektin janë të baraspeshuara me fitimet që dalin nga masat e marra për t'i shmangur dhe minimizuar këto ndikime, për të ndërmarrë restaurimin në terren dhe për të kompensuar në fund ndikimet e konsiderueshme të mbetura, nëse ka, në shkallën e duhur gjeografike.

⁷⁷ Sipas Listës së Kuqe të Llojeve të Rrezikuara, të Njësisë Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Përcaktimi i habitatit me rëndësi kritike mbështetet në lista të tjera si më poshtë: (i) nëse lloji është në listë kombëtare/rajonale si lloj në rrezik ose në rrezik kritik, në vendet që kanë aderuar në udhëzuesin e IUCN-së, përcaktimi i habitatit kritik duhet të bëhet projekt pas projekti në konsultim me profesionistët kompetentë; dhe (ii) në rastet kur kategorizimet e llojeve në listën kombëtare ose rajonale nuk përkujtojnë saktësisht me ato të IUCN-së (për shembull, disa vende i përcaktojnë llojet më në përgjithësi si "të mbrojtura" ose "të kufizuara"), duhet të kryhet një vlerësim për të përcaktuar arsyetimin dhe qëllimin e përfshirjes në listë. Në këtë rast, përcaktimi i habitatit kritik duhet të mbështetet në një vlerësim të tillë.

⁷⁸Ndikimet e matshme negative nënkuptojnë se ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit do të përkeqësojnë vijimësinë në zonën e studimit me vlerë biodiversiteti që sjell përcaktimin si habitat kritik.

⁷⁹ Fitimet neto janë rezultatet shtesë nga ruajtja që mund të arrihen për vlerat e biodiversitetit për të cilat është përcaktuar habitatat kritik. Fitimet neto mund të arrihen nëpërmjet zhvillimit të një kompensimi për biodiversitetin dhe/ose, në rastet kur klienti mund të përmbushë kërkesat e pikës 14 të kësaj Kërkese Performance pa një kompensim për biodiversitetin, klienti duhet t'i arrijë fitimet neto nëpërmjet zbatimit të programeve që mund të zbatohen në vend (në terren) për ta përmirësuar habitatin dhe për ta mbrojtur dhe ruajtur biodiversitetin.

- projekti nuk pritet të çojë në pakësim neto të popullatës⁸⁰ të asnjë lloji të rrezikuar apo shumë të rrezikuar, brenda një periudhe kohore të arsyeshme;⁸¹ dhe
 - në programin e menaxhimit përshtatës të klientit duhet integruar një program afatgjatë monitorimi dhe vlerësimi për biodiversitetin, i hartuar me saktësi dhe si duhet, me qëllim vlerësimin e statusit të habitatit me rëndësi kritike.
16. Në raste të tilla, kur një klient është në gjendje t'i përbushë këto kërkesa, strategjia lehtësuese e projektit duhet të përshkruhet në një plan për menaxhimin e biodiversitetit ose plan veprimi për biodiversitetin⁸², sipas rastit.
17. Kërkesa për një vlerësim të habitatit kritik duhet të identifikohet gjatë fazës së shqyrtimit të vlerësimit të ndikimit të projektit dhe, kur është e përshtatshme, duhet të rishikohet në përfundim të vlerësimit bazë. Kur vlerësimi ka identifikuar se projekti mund të ketë ndikime negative mbi një habitat me rëndësi kritike, klienti duhet të angazhojë ekspertë të jashtëm me përvojë për të kryer vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative mbi këtë habitat kritik.
18. Si masë e fundit, mund të planifikohen dhe zbatohen kompensime të biodiversitetit për të arritur rezultate të matshme, shitesë dhe afatgjata të ruajtjes,⁸³ për të cilat është e arsyeshme që të pritet të mos sjellin humbje neto dhe, e mira do të ishte, të sjellin fitim neto në biodiversitet. Planifikimi i kompensimit të biodiversitetit duhet të bëhet në pajtim me parimin “kokë për kokë ose më mirë”⁸⁴ dhe duhet të kryhet në përputhje me KP-të e Bankës dhe PMN-në. Klientit do t'i duhet të dedikojë burimet e duhura njerëzore dhe të dëshmojë realizueshmëri teknike dhe financiare afatgjatë të kryerjes së kompensimit.
19. Në rastet kur propozohen kompensime të biodiversitetit për karakteristikat kryesore të biodiversitetit ose habitatin kritik, klienti duhet të hartojë një strategji kompensimi të biodiversitetit ose një plan menaxhimi të kompensimit të biodiversitetit, sipas rastit, për të dëshmuar se ndikimet e konsiderueshme të mbetura të projektit në biodiversitet do të zbuten në mënyrën e duhur. Në këto raste, klienti duhet të angazhojë ekspertë të pavarur me njohuri mbi përgatitjen dhe zbatimin e kompensimit të biodiversitetit.

20. Nuk mund të kompensohen të gjitha ndikimet negative të mbetura në karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe/ose në habitatin kritik. Në këto raste, klienti duhet të riplanifikojë projektin për të shmangur nevojën për një kompensim të tillë, dhe për të përbushur kërkesat e kësaj KP-je

Zonat e mbrojtura me ligj dhe të njohura ndërkombëtarisht për vlerat e biodiversitetit

21. Kur projekti realizohet brenda një zone ose ka mundësi të ndikojë negativisht në një zonë të mbrojtur me ligj⁸⁵, dhe/ose njihet në nivel ndërkombëtar⁸⁶, apo propozohet për një status të tillë nga qeveria në nivel qendror, klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme të lidhura me projektin dhe të zbatojë hierarkinë e zbutjes, në mënyrë të atillë që ndikimet e projektit të mos e cenojnë tërësinë e zonës, objektivat e ruajtjes dhe/ose rëndësinë e biodiversitetit të kësaj zone.
22. Nëse vlerësimi identifikon se projekti ka potencialin për të ndikuar negativisht në objektivat e ruajtjes dhe prekshmërinë e zonës, karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe/ose habitatin kritik brenda zonave të mbrojtura me ligj ose të njohura në nivel ndërkombëtar si zona me vlerë për biodiversitetin, klienti duhet të kërkojë t'i shmangë këto ndikime. Gjithashtu, klienti duhet të:
- tregojë se çdo zhvillim i propozuar lejohet me ligj, ku mund të theksohet se një vlerësim i veçantë i ndikimeve të lidhura me projektin në zonat e mbrojtura është kryer sipas legjislacionit kombëtar;
 - veprojnë në përputhje me planet e menaxhimit të njohura nga qeveria për këto zona;
 - konsultohet me menaxherët e zonave të mbrojtura, autoritetet përkatëse, komunitetet vendore dhe palët e tjera të interesit për projektin e propozuar, në përputhje me KP 10; dhe
 - zbatojë programe shtesë, sipas rastit, për të nxitur dhe përmirësuar objektivat e ruajtjes së zonës së mbrojtur.

Invazioni i specieve të huaja

23. Klienti duhet të shmangë dhe të parandalojë futjen, pa dashje ose me dashje, të specieve të huaja, që mund të kenë ndikime negative të konsiderueshme në biodiversitet, dhe konkretisht:
- klienti nuk duhet të fusë me dashje specie të huaja në zonat ku nuk gjenden normalisht, nëse kjo nuk bëhet në përputhje me kuadrin rregullator që

⁸⁰ Pakësimi neto është humbja e vetme ose progresive e individëve që iu pengon llojeve vijimësinë në shkallë globale dhe/ose rajonale/kombëtare për shumë breza ose gjatë një periudhe të gjatë kohore. Shkalla (për shembull, globale dhe/ose rajonale/kombëtare) e pakësimit të mundshëm neto përcaktohet në bazë të renditjes së llojeve në Listën e Kuqe (botërore) të Llojeve të Rrezikuara të IUCN-së dhe/ose në listat rajonale/kombëtare. Për llojet e renditura edhe në Listën e Kuqe (botërore) të Llojeve të Rrezikuara të IUCN-së edhe në listat rajonale/kombëtare, pakësimi neto duhet të mbështetet në popullatën kombëtare/rajonale.

⁸¹ Afati kohor, brenda të cilit klientët duhet të dëshmojnë se “nuk ka pakësim neto” të llojeve shumë të rrezikuara dhe të rrezikuara duhet të përcaktohet rast pas rasti dhe në konsultim me ekspertët e jashtëm.

⁸² Planet e veprimi për biodiversitetin (PVB) përfshijnë zakonisht një sërë qëllimesh, objektivash dhe masash menaxhimi dhe etapash të programuara për të zbutur ndikimet e mbetura për të arritur humbje/fitime neto të karakteristikave kryesore të biodiversitetit ose habitatit kritik. Qëllimi/objektivat duhet të jenë realiste dhe të bazohen në synime të matshme. Secili objektivi duhet të përcaktojë një sërë veprimesh dhe të përfshijë tregues të realizimit dhe nënobjektiva monitorimi, dhe palën përgjegjëse dhe një afat kohor. PVB duhet të hartohen në konsultim me palët përkatëse të interesit, duke përfshirë qeverinë, ekspertët të jashtëm, organizata vendase/ndërkombëtare të ruajtjes dhe komunitet e prekura nga projekti.

⁸³ Rezultatet e matshme të ruajtjes për biodiversitetin duhet të dëshmojnë në terren (në kushte natyrale, jo në izolim apo në depo) dhe në një shkallë gjeografike të përshtatshme (p.sh., në nivel vendor, kombëtar ose rajonal).

⁸⁴ Parimi “kokë për kokë ose më mirë” do të thotë se në shumicën e rasteve duhet të planifikohen kompensime në biodiversitet për të ruajtur të njëjtat vlera të biodiversitetit që preken nga projekti (një kompensim “në natyrë”). Megjithatë, në disa situata, zonat e biodiversitetit që do të preken nga projekti mund të mos jenë as prioritet kombëtar dhe as prioritet vendor, dhe mund të ketë zona të tjera biodiversiteti me vlera të ngjashme që kanë prioritet më të lartë për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, dhe që janë në kërcënim të menjëhershëm ose në nevojë për mbrojtje dhe menaxhim efikas. Në këto situata, mund të jetë e përshtatshme të merret në konsideratë kompensimi “jo në natyrë” që përfshin “shitjen për të blerë diçka më të shtrenjtë” (pra, kur kompensimi synon biodiversitetin me prioritet më të lartë sesa ai i prekur nga projekti).

⁸⁵ Kjo PR orientohet nga përkufizimi i IUCN-së për “Zonat e mbrojtura”.

⁸⁶ Zonat e identikuara sipas konventave apo marrëveshjeve ndërkombëtare, duke përfshirë, ndër të tjera, Zonat e Trashëgimisë Natyrore Botërore të UNESCO-s, Rezervatat “Njeriu dhe biosfera” të UNESCO-s dhe Lista e Ramsarit për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare.

rregullon një gjë të tillë. Në asnjë rrethanë nuk duhen futur në mjedisë të reja specie që njihen si invazive:

- klienti duhet të identifikojë rreziqet, ndikimet dhe mundësitë e zbutjes të lidhura me kalimin ose çlirimin pa dashje të specieve të huaja;⁸⁷ dhe
- kur speciet e huaja janë vendosur që më parë në vendin ose rajonin e projektit të propozuar, klienti duhet të tregojë kujdesin e duhur për të mos i përhapur llojet invazive në zonat ku nuk janë vendosur ende.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla

24. Projektet që përfshijnë prodhimin parësor të burimeve natyrore të gjalla, duke përfshirë prodhim bujqësor ose blegtoral, pylltari natyrore ose të kultivuar, akuakulturë ose peshkim, dhe prodhim e përdorim të biomasës për energji ose prodhim të bio-karbureve duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kësaj KP-je, krahas të mëposhtmeve:
- Klienti duhet t'i menaxhojë burimet natyrore të gjalla duke zbatuar kërkesat kombëtare rregullatore kombëtare, PMN-në dhe standardet thelbësore mjedisore përkatëse të BE-së, që janë të zbatueshme në nivel projekti.
 - Kur është e përshtatshme, klienti duhet të miratojë standardet e njohura në nivel global, rajonal ose kombëtar të certifikimit që (i) bazohen në procesin konsultues me shumë palë interesi dhe (ii) ku akreditimi i nënshtrohet verifikimit ose certifikimit të pavarur nëpërmjet organeve të duhura të akredituara për këto standarde. Në mungesë të standardeve përkatëse dhe/ose sistemeve të certifikimit, klienti duhet të angazhohet për të zbatuar praktikën e duhura të menaxhimit të qëndrueshëm sipas sektorit ekonomik në përputhje me PMN-në.
 - Kur është e realizueshme, klienti duhet t'i vendosë projektet e bizneseve bujqësore me bazë tokën në tokë të papyllëzuar ose në tokë që është konvertuar nga gjendja e saj natyrore për të minimizuar ndikimet në karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe/ose habitatin kritik.
 - Prodhimi dhe/ose përdorimi i llojeve me potencial për përhapje nuk duhet të përdoren pa kontrollin e duhur për të parandaluar daljen/përhapjen e tyre jashtë zonës së prodhimit.
 - Për projekte të peshkimit⁸⁸ ose akuakulturës, klienti duhet të vlerësojë dhe minimizojë rrezikun e daljes së llojeve jo-invazive në mjedisin ujor. Klienti duhet të vlerësojë dhe minimizojë edhe mundësinë e transferimit të sëmundjeve dhe/ose parazitëve në mjedis.
 - Klientët e përfshirë në mbarështimin, transportimin dhe therjen e kafshëve për mish ose për nënprodukte (për shembull, qumësht, vezë, lesh) duhet të ndjekin dhe të zbatojnë kërkesat rregullatore kombëtare, standardet përkatëse të BE-së për mirëqenien e kafshëve dhe PMN-në, cilado që ka standardet më të rrepta në lidhje me teknikat e mbarështimit të kafshëve.
 - Për të minimizuar rezistencën antimikrobike (AMR)⁸⁹, klienti duhet të përdorë vetëm antibiotikë për kafshët e shëndetshme prodhuese të ushqimit në përputhje me standardet thelbësore mjedisore të BE-së.
 - Në vende anëtare të BE-së, organizmat e modifikuar gjenetiki (OMGJ) nuk mund të përdoren ose

⁸⁷ Për sa i takon transportin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, kjo KP bazohet në Konventën Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Menaxhimin e Ujit e Balastit dhe Sedimenteve të Anijeve (BĒĒM). Klientëve që kërkojnë financim nga BERZH-i për një projekt që përfshin veprimtari të tilla transporti iu kërkohet të respektojnë detyrimet e duhura të vendosura në kuadër të kësaj konvente.

⁸⁸ Veprimtari të peshkimit nuk kufizohen domosdoshmërisht në mbarështim. Ripopullimi ose futja e llojeve ose popullatave të ndryshme, sidomos në mjedisë të mbyllura siç janë liqenet, duhet të sigurojë që rezerva e re të mos shkatërrojnë apo shpërngulë llojet ekzistuese vendore endemike/natyrore të peshqve.

⁸⁹ Sipas Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OIE), agjentë mikrobikë janë medikamentet që përdoren për të trajtuar infeksionet, sidomos ato me origjinë bakteriale. Këto medikamente janë thelbësore për të mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, si dhe mirëqenien e kafshëve. Përdorimi i tepërt apo i papërshtatshëm mund të çojë në shfaqjen e baktereve rezistente, të cilat nuk reagojnë ndaj trajtimit antibiotik. Kësaj i referohemi zakonisht si rezistencë antimikrobike ose AMR.

çlirohen në mjedis pa miratimin e dhënë nga autoritetet kompetente. Në vendet e tjera ku operon BERZH-i, OMGJ-të nuk mund të përdoren ose çlirohen në mjedis pa një vlerësim të rrezikut, të kryer në përputhje me standardet thelbësore mjedisore të BE-së.

Zinxhiri i furnizimit

25. Si pjesë e procesit të vlerësimit të zinxhirit të furnizimit të paraqitur në KP 1, klienti duhet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet dhe ndikimet në biodiversitet, të shkaktuara nga furnitorët parësorë.⁹⁰
26. Nëse në këtë vlerësim të rrezikut evidentohet se karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe/ose habitatit kritik mund të ndikohen negativisht nga furnitorët parësorë të klientit, ose kur këto rreziqe raportohen në hallka të ulëta të zinxhirit të furnizimit të mallrave dhe materialeve që janë thelbësore për funksionet operacionale bazë të projektit, klienti duhet të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për ta korrigjuar këtë në përputhje me PMN-në gjatë një afati kohor për të cilin është rënë dakord me BERZH-in.
27. Kur klienti blen artikuj bazë nga burime natyrore, duke përfshirë ushqimin, lëndën drusore dhe fibrat, të cilat dihet se e kanë origjinën nga zona ku ekziston rreziku i konvertimit apo degradimit të konsiderueshëm të karakteristikave kryesore të biodiversitetit dhe/ose të habitateve kritike, në vlerësimin mjedisor dhe social të klientit duhet të përfshihet edhe një vlerësim i sistemeve dhe praktikave të verifikimit të përdorura nga furnitorët parësorë. Klientët duhet t'i japin përparësi blerjes së burimeve natyrore të gjalla që prodhohen në përputhje me parimet e njohura në nivel ndërkombëtar dhe me standardet e menaxhimit të qëndrueshëm, kur janë të disponueshme për produktin që blihet.
28. Klienti duhet të përcaktojë, minimalisht, politika, procedura dhe praktika verifikimi që duhet të:
 - identifikojnë origjinën e furnizimit dhe llojin e habitatit të zonës burimore;
 - shmangin prokurimin nga furnitorë që kontribuojnë në konvertimin ose degradimin e konsiderueshëm të karakteristikave kryesore të biodiversitetit, të habitateve kritike dhe/ose zona të shpallura të mbrojtura; dhe
 - sigurojnë një rishikim të vazhdueshëm të furnitorëve parësorë të klientit.
29. Aftësia e klientit për t'u dhënë zgjidhje plotësisht këtyre rreziqeve varet nga niveli i kontrollit ose ndikimit që ka klienti mbi furnitorët parësorë të tij.

⁹⁰ Shihni KP 1, shënimi në fund të faqes 22 për përkufizimet e furnitorëve kryesorë dhe funksioneve operacionale bazë të projektit.

Hyrje

1. Kjo Kërkesë Performance (KP) pranon se popullsitë indigjene janë grupe shoqërore me identitete dhe mjete jetese të dallueshme nga grupet mbizotëruese në shoqëritë kombëtare. Ato mund të jenë ndër segmentet më të marginalizuara dhe të cënueshme të popullsisë. Statusi i tyre ekonomik, shoqëror dhe juridik mund të kufizojë mundësitë e tyre për të mbrojtur të drejtat dhe interesin e tyre mbi tokën dhe burimet (si natyrore ashtu edhe kulturore). Kjo, e ndërthurur me varësinë e tyre ekonomike dhe shpirtërore në këto toka dhe burime, mund t'i bëjë ato mjaft të prekshme nga çdo ndikim negativ i projekteve. Kjo KP pranon se popullsitë indigjene kanë njohuri dhe aftësi unike, dhe janë partnerë të mundshëm në zhvillimin e qëndrueshëm, duke kontribuar dhe përfituar nga planifikimi dhe zbatimi i veprimtarive të lidhura me projektin.
2. Kjo KP pranon se qeveritë luajnë një rol qendror në mbrojtjen e të drejtave të popullsisë indigjene. Ajo përcakton përgjegjësitë e klientit për të vlerësuar potencialin që ka një projekt për të ndikuar te popullsitë indigjene, për t'u angazhuar në mënyrë kuptimplote me popullsitë indigjene të prekura dhe, në rrethana të caktuara të parashikuara në këtë KP, për të marrë pëlqimin e tyre të lirë, paraprak dhe të informuar (PLPI). Kjo KP përcakton edhe detyrimet për të bashkëpunuar me popullsitë indigjene të prekura në planifikimin dhe zbatimin e masave për të shmangur, minimizuar, zbutur dhe kompensuar ndikimet negative dhe për të ndarë përfitimet e projektit.

Objektivat

3. Objektivat e kësaj KP-je janë:
 - sigurimi se projekti respekton plotësisht dinjitetin, të drejtat, aspiratat, kulturat, ligjet zakonore dhe mjetet e jetesës të popullsisë indigjene;
 - parashikimi dhe shmangia e rreziqeve dhe ndikimeve negative⁹¹ të projekteve në jetën dhe mjetet e jetesës së komuniteteve të popullsisë indigjene ose, kur shmangia nuk mund të realizohet, minimizimi, zbutja ose kompensimi për këto ndikime;
 - nxitja e përfitimeve dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm për popullsitë indigjene në mënyrë të aksesueshme, të përshtatshme në aspektin kulturor dhe gjithëpërfshirëse për burrat dhe gratë indigjene;
 - krijimi dhe ruajtja e një marrëdhënieje të vazhdueshme me popullsitë indigjene të prekura nga projekti gjatë gjithë ciklit të jetës së tij;
 - sigurimi i pjesëmarrjes efikase të popullsisë indigjene në përgatitjen e veprimtarive të projektit ose të masave zbutëse që mund të kenë ndikim pozitiv ose negativ tek ato; dhe

⁹¹Ndikimet negative mund të përfshijnë, por nuk kufizohen, ndikimet që ndodhin si rrjedhojë e humbjeve të pasurive apo burimeve, kufizimit në përdorimin e tokës, ose kryerjes së veprimtarive tradicionale të jetesës, si rezultat i veprimtarive të projektit.

⁹²Disa karakteristika mund të kenë humbur ose të jenë më pak të dukshme për disa grupe apo komunitete nëpërmjet integritimit në shoqërinë ose ekonominë e gjerë, ndonjëherë si rrjedhojë e politikës qeveritare.

- sigurimi i negociatave në mirëbesim me popullsitë indigjene dhe marrja e PLPI-së së tyre në rrethana specifike të përshkuara në këtë KP.

Fusha e zbatimit

4. Në këtë KP, termi “popullsitë indigjene” përdoret në kuptimin teknik për t’iu referuar një grupi shoqëror dhe kulturor, të dallueshëm nga grupet mbizotëruese në shoqëritë kombëtare, që kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme⁹²:
 - vet-identifikimi i anëtarë të një grupi etnik ose kulturor indigjen të dallueshëm, dhe njohja e këtij identiteti nga të tjerët;
 - përkatësia kolektive në habitate gjeografikisht të dallueshme, në toka tradicionale ose në territore të të parëve në zonën e projektit dhe në burime natyrore në këto habitate dhe territore;⁹³
 - institucionet zakonore kulturore, ekonomike, sociale ose politike, ligjet ose rregulloret që janë më vete nga institucionet e shoqërisë ose të kulturës mbizotëruese; dhe
 - gjuhë ose dialekt të dallueshëm, shpesh të ndryshëm nga gjuha ose dialekti zyrtar i vendit ose rajonit.
5. Një grup, ose anëtarët e një grupi, që bëjnë jetë nomade ose shtegtare, jetojnë në komunitete të përziera ose urbane dhe/ose vetëm sa shkojnë për vizitë në tokat e tyre tradicionale në mënyrë sezonale, mund të përjetojnë largim të detyruar. As mënyra e tyre aktuale e jetesës dhe as ky largim i detyruar nuk mund ta bëjë këtë grup të papranueshëm për zbatimin e kësaj KP-je.
6. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për t’i përmbushur këto duhet të menaxhohet në përputhje me këtë KP dhe KP-të 1, 5, 8 dhe 10, kur gjejnë zbatim.

Kërkesat

Vlerësimi

7. Klienti duhet të përcaktojë zbatueshmërinë e kësaj KP-je, sa më herët që të jetë e mundur, në ciklin e jetës së projektit, por jo më vonë se gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Kur në organizatën e klientit ka mungesë të aftësive të përshtatshme, klienti duhet të kërkojë këshilla nga specialistë socialë të pavarur dhe me përvojë për të konstatuar nëse një grup i veçantë i përmbush kriteret në pikat 4-6 të kësaj KP-je.

⁹³Grupi që e ka humbur “përkatësinë kolektive në habitate gjeografikisht të dallueshme ose territore të të parëve në zonën e projektit” për shkak të largimit me forcë vazhdon të ketë të drejtë të drejtë të përfitojë sipas kësaj KP-je. “Largimi me forcë” është humbja e përkatësisë kolektive në habitate gjeografikisht të dallueshme ose territore të të parëve për shkak të konfliktit, programeve shtetërore të zhvendosjes, heqjes së tokës nga përdorimi, fatkeqësive natyrore ose përfshirjes së territoreve të tilla në një zonë urbane. Në kuptim të kësaj KP-je, “zonë urbane” normalisht do të thotë një qytet ose një qytezë e madhe dhe merr në konsideratë të gjitha karakteristikat e mëposhtme, asnjëra prej të cilave nuk është përfundimtare: (a) përcaktimi ligjor i zonës si urbane me legjislacion kombëtar; (b) dendësi popullore e madhe; dhe (v) përqindje e lartë veprimtarish ekonomike jobujqësore në krahasim me veprimtaritë bujqësore.

8. Për sa u përket projekteve që mund të prekin popullsitë indigjene, klienti duhet të kryejë një vlerësim të ndikimeve të popullsitë indigjene. Fillimisht, klienti duhet të shmangë efektet negative dhe, kur nuk është e mundur, të përgatitë një plan zhvillimi për të minimizuar dhe/ose zbutur çdo ndikim negativ të mundshëm dhe të identifikojë mundësitë për përfitim nga popullsitë indigjene të prekura.
9. Në rastet kur projekti nuk ka filluar ende, klienti duhet të autorizojë kryerjen e një studimi objektiv dhe të pavarur, që identifikon të gjitha komunitetet e popullsisë indigjene, të cilët mund të preken në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe, në konsultim me popullsitë indigjene të prekura, të vlerësojë efektet e mundshme të projektit mbi grupet dhe këndvështrimet e tyre lidhur me projektin. Ky vlerësim duhet të marrë në konsideratë çështjet më specifike të popullsisë indigjene nga ndryshimet në mjedisin dhe mënyrën e tyre të jetesës.
10. Në rastet kur kanë filluar tashmë ndërtimi, veprimtaritë ose operacionet e lidhura me projektin, klienti duhet të ofrojë të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse për të treguar se kanë kërkuar dhe vepruar mbi opinionet e popullsisë indigjene të prekura nga projekti. Këto dokumente përfshijnë ato lidhur me performancën e shkuar të klientit, efektet e deritanishme të popullsitë indigjene dhe një regjistër të dokumenteve tashmë të dorëzuara pranë autoriteteve.
11. Nëse kërkesat e kësaj KP-je nuk janë përmbushur, klienti duhet të kryejë një vlerësim siç parashikohet në pikat 7-10 të kësaj KP-je. Ky vlerësim duhet të: (i) rishikojë efektet e deritanishme në jetën dhe mjetet e jetesës të popullsisë indigjene; (ii) identifikojë çdo mangësi në kërkesat e këtij standardi; dhe (iii) identifikojë veprimet korrigjuese që mund të kërkojnë për të arritur rezultatet e synuara të kësaj KP-je. Më pas, klienti duhet të bjerë dakord për një plan veprimi me BERZH-in.

- o komunitetet indigjene janë me shumë aspekte; konsultimet dhe pjesëmarrja duhet të përfshijnë grupet me përkatësi gjinore të ndryshme, nga breza të ndryshëm dhe grupe të përjashtuara.

PLPI

13. Nuk ka një përkufizim të pranuar në nivel botëror për PLPI-në. Megjithatë, për qëllime të kësaj KP-je, pëlqimi i referohet mbështetjes kolektive të popullsisë indigjene të prekura për veprimtaritë e propozuara të projektit që i prekin ato. PLPI-ja bazohet dhe zgjeron procesin e konsultimit kuptimplotë të përcaktuar më sipër dhe arrihet nëpërmjet negociatave në mirëbesim ndërmjet klientit dhe popullsisë indigjene të prekura, në përfundim të të cilit këto të fundit arrijnë të marrin një vendim, në përputhje me traditat e tyre kulturore, zakonet dhe praktikatat. PLPI-ja nuk kërkon unanimitet dhe mund të arrihet madje edhe kur individë ose grupe brenda ose ndërmjet popullsisë indigjene nuk bien shprehimisht dakord.
14. PLPI-ja e popullsisë indigjene të prekura kërkohej në rrethanat kur një projekt: (a) prek tokat ose burimet e tyre zakonore; (ii) i zhvendos ato nga tokat e tyre tradicionale ose zakonore; ose (iii) prek apo propozon të përdorë burimet e tyre kulturore.
15. Në këto rrethana, klienti duhet të angazhojë ekspertë të pavarur të kualifikuar për të ndihmuar në zhvillimin dhe dokumentimin e negociatave në mirëbesim dhe në procesin e PLPI-së.

Ndikimet në tokat dhe burimet zakonore

Konsultimi kuptimplotë dhe PLPI

Konsultimi kuptimplotë

12. Klienti duhet të vendosë një marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetet e prekura të popullsisë indigjene, sa më herët që të jetë e mundur, në procesin e planifikimit të projektit dhe të zhvillojë një proces të konsultimit kuptimplotë, siç parashikohet në KP 10, në përputhje me rreziqet dhe ndikimet e mundshme të projektit të popullsitë indigjene. Gjithashtu, procesi i konsultimit duhet të përfshijë sa më poshtë:
 - përfshirjen e organeve përfaqësuese të popullsisë indigjene (për shembull, e këshillit të pleqësisë ose e këshillit të fshatit, mes të tjerave), e organizatave të popullsisë indigjene, si dhe e anëtarëve të komuniteteve indigjene të prekur;
 - mirëkuptimin dhe respektimin e çdo ligji zakonor përkatës;
 - parashikimin e kohës së mjaftueshme për procesin vendimmarrës kolektiv të popullsisë indigjene;
 - pjesëmarrjen efikase të popullsisë indigjene në përgatitjen e veprimtarive të projektit ose të masave zbutëse që mund të kenë ndikim pozitiv ose negativ tek ato; dhe
 - njohjen e përbërjes heterogjene të komunitetit, duke marrë në konsideratë:
 - o popullsitë indigjene mund jetojnë në komunitete mikse me njerëz të cilët nuk janë indigjenë; dhe
16. Popullsitë indigjene janë të lidhura shpesh me tokat e tyre zakonore dhe me pyjet, ujërat, llojet e egra dhe burimet e tjera natyrore. Këto lidhje kanë të bëjnë me mjetet e jetesës, aspektet kulturore, ceremoniale ose shpirtërore, dhe mund të përkufizojnë identitetin dhe komunitetin e popullsisë indigjene. Prandaj, zbatohen konsiderata të veçanta nëse projekti i prek këto lidhje. Megjithatë, sipas legjislacionit kombëtar, këto toka mund të mos jenë në pronësi të ligjshme, përdorimi i këtyre tokave nga komunitetet e popullsisë indigjene, duke përfshirë përdorimin sezonal ose ciklik, shpesh mund të provohet dhe dokumentohet.
17. Nëse klienti propozon ta ketë vendndodhjen e projektit ose të zhvillojë në formë tregtare burimet natyrore në tokat zakonore në përdorim, dhe mund të priten ndikime negative të mjetet e jetesës ose përdorimit kulturor, ceremoniale ose shpirtërore, që përkufizojnë identitetin dhe komunitetin e popullsisë indigjene, klienti duhet të marrë PLPI-në e tyre. Krahas kësaj, klienti duhet të:
 - dokumentojë përdorimin e tokës dhe të burimeve të popullsisë indigjene nga ekspertë, në bashkëpunim me komunitetet indigjene të prekura, pa paragjykuar pretendimet mbi tokën të popullsisë të tjera indigjene; vlerësimi duhet të përfshijë gjininë dhe të marrë në konsideratë veçanërisht rolet e grave në menaxhimin dhe përdorimin e këtyre burimeve;
 - dokumentojë përpjekjet e veta për të shmangur ose, të paktën, për të minimizuar madhësinë e tokës në përdorim, shfrytëzim dhe/ose pronësi të popullsisë indigjene që propozohet për projektin;
 - informojë komunitetet indigjene të prekura për të drejtat e tyre në lidhje me këto toka sipas ligjeve kombëtare, duke përfshirë çdo ligj kombëtar që njih të drejtat ose përdorimin zakonor;

- japë kohë të mjaftueshme për komunitetet indigjene të prekura që të arrijnë një marrëveshje të brendshme, pa imponuar klienti vullnetin e tij drejtpërdrejt ose tërthorazi;
- sigurojë akses të vazhdueshëm në burime natyrore, duke siguruar zëvendësimin e barasvlershëm të burimeve ose, si alternativë përfundimtare, ofrimin e kompensimit; dhe
- sigurojë për komunitetet e prekura të popullsisë indigjene aksesin, përdorimin dhe kalimin në tokën në të cilën po ndërton klienti, duke iu nënshtruar gjithmonë kërkesave për ruajtjen e shëndetit, sigurisë dhe sigurimit.

Zhvendosja e popullsisë indigjene nga tokat tradicionale ose zakonore

18. Klienti duhet të shqyrtojë plane alternative të realizueshme projektit për të shmangur zhvendosjen e popullsisë indigjene nga tokat tradicionale ose zakonore që kanë zotëruar bashkërisht. Kur zhvendosja është e pashmangshme, klienti duhet të minimizojë sipërfaqen e tokës së përdorur dhe të mos e bëjë këtë zhvendosje pa marrë PLPI-në e popullsisë indigjene të prekura. Çdo zhvendosje e popullsisë indigjene duhet të jetë në përputhje me kërkesat e KP 5. Gjithashtu, popullsitë indigjene duhet të marrin kompensim të drejtë dhe të barabartë nga klienti për tokat, territoret dhe burimet që kanë zotëruar tradicionalisht ose që kanë pasur në shfrytëzim apo përdorim, dhe të cilat janë konfiskuar, marrë, shfrytëzuar, përdorur ose dëmtuar si pasojë e projektit pa PLPI-në e tyre.
19. Kur është e realizueshme, popullsitë indigjene të zhvendosura duhet të kenë mundësi të kthehen në tokat e tyre tradicionale ose zakonore, nëse pushon së ekzistuari arsyeja për zhvendosjen e tyre. Në raste të tilla, toka duhet të rikthehet plotësisht në gjendjen e mëparshme.

Trashëgimia kulturore

20. Kur një projekt mund të ndikojë ndjeshëm në trashëgiminë kulturore materiale lidhur me identitetin dhe/ose aspektet kulturore, ceremoniale ose shpirtërore të popullsisë indigjene, duhet t'i jepet përparësi shmangies së këtyre ndikimeve. Kur ndikimet e konsiderueshme janë të pashmangshme, klienti duhet të marrë PLPI-në e popullsisë indigjene të prekura dhe të përmbushë kërkesat e KP 8.
21. Kur një projekt propozon të përdorë burimet, dijet, novacionet ose praktikat kulturore të popullsisë indigjene për qëllime tregtare, klienti duhet t'i informojë popullsitë indigjene për: (i) të drejtat e tyre sipas kësaj KP-je; (ii) objektin dhe natyrën e zhvillimit tregtar të propozuar; (iii) pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë; dhe (iv) do të marrë PLPI-në e tyre. Klienti duhet të përcaktojë dhe zbatojë edhe mekanizmat që nxitin ndarjen e ndershme dhe të drejtë të përfitimeve nga shfrytëzimi tregtar i dijeve, novacioneve ose praktikave të tilla, në përputhje me zakonet dhe traditat e popullsisë indigjene të prekura.

Kompensimi dhe ndarja e përfitimeve

22. Klienti duhet të sigurojë, në marrëveshje me komunitetin vendas, se popullsitë indigjene të prekura kompensohen në mënyrë të drejtë për çdo humbje të mjeteve të jetesës të shkaktuar si rrjedhojë e veprimtarive të lidhura me projektin. Kur llogaritet kompensimi, klienti duhet të përmbushë kërkesat e KP 5 dhe të marrë në konsideratë efektet negative të projektit mbi mjetet zakonore të jetesës⁹⁴, duke përfshirë praktikën nomade/shtegtare, si dhe jetën familjare të popullsisë indigjene, duke i kushtuar rëndësi të veçantë pagës së veprimtarive jetësore me pagesë dhe pa pagesë të grave. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me përfaqësues të popullsisë indigjene dhe me ekspertë. Dispozitat e kësaj pike zbatohen edhe në rastet kur klienti duhet të paguajë kompensim për organet qeveritare vendore ose rajonale.
23. Do të zhvillohen mekanizma të pranueshëm reciprokisht dhe të realizueshëm ligjërisht për transferimin e kompensimit dhe/ose burimeve. Këto mund të ofrohen në mënyrë kolektive kur toka dhe burimet janë në pronësi kolektive. Klienti duhet të ofrojë asistencë për të mundësuar ngritjen e sistemeve të përshtatshme të menaxhimit dhe qeverisjes, të cilat sigurojnë shpërndarje efektive të kompensimit për të gjithë anëtarët e pranueshëm ose përdorim kolektiv të kompensimit në mënyrë të atillë që të përfitojnë të gjithë anëtarët e grupit.
24. Klienti duhet t'iu ofrojë popullsisë indigjene të prekura mundësi për përfitime zhvillimore të përshtatshme në aspektin kulturor. Këto mundësi duhet të jenë në përputhje me shkallën e ndikimeve të projektit, me qëllim përmirësimin e standardit të tyre të jetesës dhe të mjeteve të jetesës në mënyrë të përshtatshme dhe nxitjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të burimeve natyrore nga të cilat ato varen. Përfitimet nga zhvillimi do të ofrohen në kohën e duhur.
25. Veprimet e propozuara të klientit për të minimizuar, zbutur dhe kompensuar efektet negative, dhe për të identifikuar dhe ndarë përfitimet, duhet të përfshihen në një plan me afat kohor të përcaktuar, siç është plani i zhvillimit të popullsisë indigjene (PZHPI), ose një plan për zhvillimin e komunitetit të gjerë me komponentë të veçantë për popullsitë indigjene. Ky plan duhet të hartohet në konsultim me popullsitë indigjene të prekura. Klienti duhet të angazhojë edhe ekspertë të kualifikuar me ekspertizë teknike përkatëse dhe të përshtatshme për të përgatitur planin. PZHPI-ia duhet të vlerësojë sistematikisht ndikimet e ndryshme të projektit lidhur me gjininë dhe brezat e ndryshëm, dhe të përfshijë veprime për t'i trajtuar këto ndikime në grupe të ndryshme të komunitetit. Niveli i detajeve dhe objekti i një PZHPI-je do të ndryshojë në varësi të projektit dhe të natyrës e objektit të veprimtarive të projektit

⁹⁴ Natyra e "mjeteve zakonore të jetesës" interpretohet në mënyrë fleksibël (pra, duke përfshirë përshtatjet bashkëkohore, si turizmin etnik dhe përpunimin ushqimor).

26. Kur ekzistojnë faktorë të nënkuptuar që përjashtojnë popullsitë indigjene dhe individët nga përfitimet e projektit, siç janë mundësitë e punësimit, për shkak të prejdardhjes etnike, veprimtaritë e projektit duhet të përfshijnë masa korigjuuese si: (i) informim i organizatave të popullsive indigjene dhe individëve, mbi të drejtat e tyre në legjislacionin e punës, social, financiar dhe të biznesit, si dhe mbi mekanizmat në dispozicion për mbështetje; (ii) shpërndarje e duhur dhe efektive e informacionit, trajnim dhe masa për të eliminuar pengesat për përfitimet dhe burimet, siç janë kreditimi, punësimi, shërbimet e biznesit, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet arsimore, e të tjera përfitime të lindura ose të lehtësuara nga projekti; dhe (iii) dhënie e një shkalle të njëjtë mbrojtje për punëtorët indigjenë, sipërmarrësit dhe përfituesit, sipas legjislacionit kombëtar, sikundër për individët e tjerë në sektorë dhe kategori të ngjashme, duke marrë parasysh çështjet e gjinisë dhe segmentimin etnik në tregjet e mallrave e të punës, si dhe faktorët gjuhësorë.

Mekanizmi i ankesave

27. Klienti duhet të sigurojë se mekanizmi i ankesave që është ngritur për projektin, siç përshkruhet në KP 10, është i përshtatshëm nga aspekti kulturor dhe i arritshëm nga popullsitë indigjene, dhe duhet të marrë në konsideratë mundësinë për rekurs në gjykatë dhe praninë e mekanizmave zakonorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo mund të kërkojë më pak mbështetje te procedurat e shkruara dhe më shumë përdorim të kanaleve verbale të raportimit.

Konsiderata të tjera

28. Gjatë zbatimit të projektit, klienti duhet të sjellë në vëmendje të BERZH-it çdo konflikt ndërmjet popullsive indigjene dhe klientit, të cilat mbeten të pazgjidhura, pavarësisht se kanë kaluar nëpërmjet mekanizmit të ankesave të projektit.
29. Kur qeveria a një rol të përcaktuar në menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve të popullsitë indigjene lidhur me projektin, klienti duhet të bashkëpunojë me agjencinë qeveritare përgjegjëse, në shkallën e mundur dhe të lejuar nga agjencia, për të arritur rezultate që janë në përputhje me objektivat e kësaj KP-je. Gjithashtu, kur qeveria ka kapacitet të kufizuar, klienti duhet të luajë rol aktiv gjatë planifikimit, zbatimi dhe monitorimit të veprimtarive në shkallën e lejuar nga agjencia.

Hyrje

1. Kjo Kërkesë Performance (KP) njuh rëndësinë që ka trashëgimia kulturore për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Qëllimi është të mbrohet trashëgimia kulturore dhe të orientohen klientët në shmangien ose zbutjen e ndikimeve të negative mbi trashëgiminë kulturore gjatë aktiviteteve të tyre tregtare. Nga klientët pritet të tregojnë kujdes në qasjen e tyre për menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.
2. Si trashëgimia materiale, ashtu edhe ajo jo-materiale, janë pasuri të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, dhe janë pjesë përbërëse e vijimësisë së identitetit dhe të praktikave kulturore (duke përfshirë zotësitë tradicionale, njohuritë, besimet dhe/ose dialektet dhe gjuhët e pakicës).
3. Në ndjekje të qëllimeve të mbrojtjes dhe ruajtjes, kjo KP orientohet nga konventat ndërkombëtare dhe instrumente të tjera të zbatueshme. Ajo njuh edhe nevojën që të gjitha palët të respektojnë ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore e që mund të preken nga një projekt, si dhe detyrimet në bazë të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendet pritëse. Këto ligje mund të jenë për trashëgiminë kulturore ose për antikitetet, planifikimin ose lejet e ndërtimit, zonat e ruajtura, zonat e mbrojtura dhe ligje e rregulloret të tjera që rregullojnë mjediset historike të ndërtuara, apo ligje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e kulturave të popullive indigjene. Kërkesat e detajuara për mbrojtjen e popullive indigjene paraqiten në KP 7.

Objektivat

4. Objektivat e kësaj KP-je janë:
 - mbështetja e mbrojtjes dhe e ruajtjes së trashëgimisë kulturore;
 - zbatimi i qasjes së hierarkisë së minimizimit të riskut për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga ndikimet negative që mund të lindin nga projekti;
 - nxitja e ndarjes së barabartë të përfitimeve nga përdorimi i trashëgimisë kulturore në veprimtari tregtare; dhe
 - kur identifikohen elemente të konsiderueshme të trashëgimisë kulturore, nxitja e ndërgjegjësimit, vlerësimit dhe përmirësimit të trashëgimisë kulturore, si dhe përfitimet e mundshme socio-ekonomike për komunitetet vendore.

Fusha e zbatimit

5. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet e financuara drejtpërdrejt nga BERZH-i, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të kësaj KP-je dhe se si do të trajtohen ato si pjesë përbërëse e Sistemit të përgjithshëm të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të klientit dhe/ose Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) të projektit. Kërkesat për menaxhimin dhe vlerësimin mjedisor dhe social janë paraqitur në KP 1. Gjithashtu, klienti duhet ta zbatojë këtë KP gjatë zbatimit të projektit, nëse projekti prek ose ka mundësi të prekë trashëgiminë kulturore (materiale dhe jomateriale) e cila nuk ka qenë identifikuar më parë.

6. Në kuptimin e kësaj KP-je, termi trashëgimi kulturore përkufizohet si një grup burimesh të trashëguara nga e shkuara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht se kush është pronar, si pasqyrim dhe shprehje të vlerave, besimeve, dijeve dhe traditave evoluese të tyre. Ky term përfshin trashëgiminë kulturore materiale dhe jo-materiale, e cila njihet në nivel vendor, rajonal apo kombëtar, ose brenda komunitetit ndërkombëtar:
 - trashëgimia kulturore materiale përfshin sendet e lëvizshme ose të palëvizshme, vendet, grupet e objekteve, si dhe hapësirat kulturore ose të shenjta që shoqërohen me to dhe veçoritë e peizazhet natyrore me rëndësi arkeologjike, etnologjike, paleontologjike, historike, arkitekturore, fetare, estetike ose me vlera të tjera kulturore; dhe
 - trashëgimia kulturore jo-materiale përfshin praktikat, përfaqësimet, shprehjet, dijet dhe zotësitë që komunitetet, grupet dhe, në disa raste, individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore dhe të cilat kalohen nga njëri brez në tjetrin.
7. Duke pranuar se vende, sende ose tradita kulturore me vlerë ose rëndësi të trashëgimisë kulturore mund të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi gjatë zhvillimit të projektit, projekti është objekt i dispozitave të kësaj KP-je, nëse:
 - kërkon gërmime të mëdha, prishje, lëvizje dheu, drenazhim, përmblytje ose ndryshime të tjera në mjedisin fizik;
 - ndodhet brenda ose pranë një zone të trashëgimisë kulturore, e njohur si e tillë nga vendi përkatës; dhe/ose
 - mund të kenë një ndikim negativ te format jo-materiale të trashëgimisë kulturore të njerëzve, duke përfshirë edhe popullsitë indigjene.
8. Kërkesat e kësaj KP-je janë të zbatueshme për trashëgiminë kulturore, pavarësisht nëse trashëgimia kulturore ka qenë e mbrojtur ligjërisht ose e shqetësuar më parë. Për sa i përket trashëgimisë kulturore jomateriale, kërkesat e kësaj KP-je zbatohen vetëm nëse komponenti fizik i projektit do të ketë ndikim material në këtë trashëgimi kulturore, ose nëse projekti ka për qëllim ta përdorë këtë trashëgimi kulturore për qëllime tregtare.

Kërkesat

Konsultimi me personat dhe komunitetet e prekura, dhe palët e tjera të interesit

9. Klienti duhet të zhvillojë konsultim kuptimplotë dhe të ofrojë informacion lidhur me projektin për të gjitha palët kyç të interesit, me qëllim: (a) identifikimin e trashëgimisë kulturore që mund të preket; (b) të kuptuarit e rëndësisë së trashëgimisë kulturore për palët e interesit, duke përfshirë komunitetet vendore; (c) vlerësimin e ndikimeve dhe rreziqeve; (d) zbatimin e hierarkisë së minimizimit të riskut; dhe (e) identifikimin e mundësive për përfitimin e mundshëm të komunitetit. Identifikimi i palëve të interesit dhe zhvillimi i konsultimit kuptimplotë do të bëhet në përputhje me kërkesat e KP 10 dhe duhet të përfshihen kujdestarët dhe përdoruesit kyç të trashëgimisë kulturore të identifikuar. Këtu duhet të përfshihen gratë dhe grupet e cënueshme.

10. NËpËrmjet konsultimeve me personat dhe komunitete e prekura, dhe me palët e tjera të interesit, klienti duhet të përcaktojë nëse bërja publike e informacionit lidhur me trashëgiminë kulturore mund të çënojë sigurinë ose paprekshmërinë e trashëgimisë kulturore. Në situata të tilla, klienti duhet ta mbajë konfidencial informacionin lidhur me trashëgiminë kulturore, dhe mund të shmangë bërjen publike të informacionit sensitiv.

Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimeve

11. Në një fazë të hershme të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë nëse trashëgimia kulturore ka të ngjarë apo jo të preket negativisht nga projekti dhe të vlerësojë probabilitetin e gjetjeve rastësore. Në këtë proces, klienti duhet të konsultohet me autoritetet përkatëse, ekspertët, komunitetet vendore dhe palët e tjera të interesit, sipas rastit.
12. Procesi i vlerësimit duhet të përshkruajë rreziqet dhe ndikimet bazë dhe të mundshme të projektit në trashëgiminë kulturore. Shkalla e vlerësimit duhet të jetë e mjaftueshme për të përshkruar rëndësinë e mundshme, gjasat dhe seriozitetin e ndikimit, si dhe të marrë në konsideratë këndvështrimet e palëve kyç të interesit. Klienti duhet të hartojë dhe zbatojë masa lehtësuese për të adresuar ndikimet në trashëgiminë kulturore në përputhje me hierarkinë e zbutjes dhe praktikën e mirë ndërkombëtare. Kur vlerësimi ka evidentuar se projekti mund të ketë rreziqe dhe ndikime materiale në trashëgiminë kulturore, klienti duhet të angazhojë ekspertë të trashëgimisë kulturore për të ndihmuar në përgatitjen e planit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore, sipas rastit.
13. Klienti duhet të zbatojë praktika të njohura në nivel ndërkombëtar për studimet në terren, dokumentacionin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore lidhur me projektin, dhe të sigurojë zbatimin e këtyre praktikave për kontraktorët dhe palët e tjera të treta.

Procedura e gjetjeve rastësore

14. Klienti duhet të sigurojë që të ketë në zbatim dhe të përfshira në kontrata dispozita për menaxhimin e gjetjeve rastësore, të përkufizuara si trashëgimi kulturore materiale, të hasura papritur gjatë zbatimit të projektit, sipas rastit. Dispozita të tilla duhet të përfshijnë njoftimin e organeve kompetente përkatëse në lidhje me sendet apo objektet e gjetura; trajnimin e personelit të projektit, duke përfshirë kontraktorin dhe punonjësit e nën-kontraktorit, lidhur me procedurat që ndiqen në rast të zbulimit të gjetjeve rastësore; dhe mbrojtjen e zonës ku ka pasur gjetje, për të shmangur çdo shqetësim apo shkatërrim. Klienti nuk duhet të shqetësojë asnjë gjetje rastësore, pa u bërë një vlerësim nga një ekspert i trashëgimisë kulturore dhe pa u identifikuar veprimet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe me këtë KP.

Zonat e mbrojtura me ligj dhe të njohura ndërkombëtarisht

15. Kur projekti ka potencialin për të sjellë ndikime negative në trashëgiminë kulturore në një zonë që është e mbrojtur nëpërmjet masave ligjore ose masave të tjera efektive, dhe/ose është e njohur në nivel ndërkombëtar, apo është propozuar për të marrë këtë status nga qeveria kombëtare, klienti duhet të kërkojë që t'i shmangë këto ndikime. Në situatat kur ndikimet nuk mund të shmangen dhe nuk janë të mundura alternativa të tjera, klienti duhet të vazhdojë me zhvillimin e projektit, vetëm nëse zbatohen kërkesat e mëposhtme:
 - përbush kërkesat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me trashëgiminë kulturore të prekur;

- tregon se çdo zhvillim i propozuar lejohet me ligj, i cili kërkon që të kryhet një vlerësim i veçantë i ndikimeve të lidhura me projektin në zonat e mbrojtura;
- respekton dispozitat e planeve të menaxhimit të qeverisë për këto zona nëpërmjet përgatitjes dhe zbatimit të vlerësimit të trashëgimisë kulturore dhe të planit shoqëruar të menaxhimit;
- konsultohet me menaxherët e zonave të mbrojtura, autoritetet përkatëse, komunitetet vendore dhe palët e tjera të interesit për projektin e propozuar, në përputhje me KP 10; dhe
- shqyrton mundësitë dhe zbaton programe për të nxitur ruajtjen e mandatit të zonës së mbrojtur dhe kontribuon në zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve vendore, në përputhje me planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur.

Përdorimi i trashëgimisë kulturore nga projekti

16. Kur një projekt kërkon të përdorë burimet kulturore, dijet, novacionet ose praktikën e komuniteteve vendore që mishërojnë mënyra tradicionale të jetesës, për qëllime tregtare, klienti duhet t'i informojë në kohë këto komunitete për: (i) të drejtat e tyre sipas legjislacionit kombëtar; (ii) objektin dhe natyrën e zhvillimit tregtar të propozuar; dhe (iii) pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë. Klienti duhet ta fillojë një shfrytëzim të tillë tregtar vetëm nëse: (i) hyn në negociime në mirëbesim me komunitetet e prekura vendore që mishërojnë mënyra tradicionale jetese; (ii) e dokumenton pjesëmarrjen e informuar të tyre dhe rezultatit e suksesshëm të negociimit; dhe (iii) u siguron komuniteteve vendore të prekura ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi tregtar i dijeve, novacioneve ose praktikave të tilla, në përputhje me zakonet dhe traditat e tyre. Kur një projekt propozon të përdorë burimet, dijet, novacionet ose praktikën kulturore të popullsisë indigjene, duhet të zbatohen kërkesat e KP 7.
17. Klienti duhet të marrë masa për t'u mbrojtur nga vjedhja dhe trafikimi i objekteve të lëvizshme të trashëgimisë kulturore të prekura nga projekti, dhe duhet të njoftojë autoritetet përkatëse për veprimtari të tilla.

Kërkesa e Performancës 9 e BERZH-it: Ndërmjetësit Financiarë

Hyrje

1. Kjo kërkesë performance pranon se ndërmjetësit financiarë (NF) janë një instrument kyç për promovimin e tregjeve financiare të qëndrueshme dhe sigurojnë një mjet për të kanalizuar financimin drejt sektorit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Ndërmjetësit financiarë përfshijnë një larmi ofruesish shërbimesh, përfshi fondet e kapitalit privat, bankat, shoqëritë e qirave financiare (leasing), shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensione.
2. Natyra e ndërmjetësuesve financiarë do të thotë që ndërmjetësit financiarë do t'u delegohet vlerësimi mjedisor dhe social, menaxhimi i riskut dhe monitorimin, krahas menaxhimit të përgjithshëm të portofolit. Natyra e delegimit mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të disa faktorëve, siç është lloji i financimit të ofruar. Efektiviteti i menaxhimit mjedisor dhe social i ndërmjetësve financiarë duhet të vlerësohet dhe të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, gjatë të gjithë ciklit të jetës së projektit.

Objektivat

3. Objektivat e kësaj kërkesë performance janë:
 - përcaktimi se si FN-të do të vlerësojnë dhe menaxhojnë riskun dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të lidhura me nënprojektet që ata financojnë;
 - nxitja e praktikave të mira të menaxhimit mjedisor dhe burimeve njerëzore në projektet e financuara nga FN-të; dhe
 - nxitja e menaxhimit të mirë mjedisor dhe burimeve njerëzore brenda ndërmjetësve financiarë.

Fusha e zbatimit

4. Në kuptimin e kësaj kërkesë të performancës, termi "nënprojekt" i referohet investimeve dhe veprimtarive, sipas rastit, që përfitojnë të drejtën për t'u financuar nga ndërmjetësit financiarë duke përdorur fondet e përfuara nga Banka për projektin e NF-së.
5. Kërkesat e kësaj KP-je do të zbatohen për të gjitha nënprojektet.
6. Kur fondet e siguruara nga Banka përfshijnë financim të përgjithshëm për shoqërinë tregtare, si në formë kapitali aksionar, që nuk mund të identifikohet tek nënprojekte e veçanta, kërkesat e kësaj KP-je zbatohen për të gjitha nënprojektet e ardhshme të ndërmjetësit financiar.
7. Ndërmjetësi financiar nuk ka nevojë të zbatojë procedura të menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social për nënprojekte që mund të paraqesin pak ose aspak rreziqe të padëshirueshme mjedisore dhe sociale.
8. BERZH-i mund t'u kërkojë ndërmjetësve financiarë që të miratojnë dhe zbatojnë kërkesa shtesë dhe alternative mjedisore dhe sociale, në varësi të natyrës së NF-së, veprimtarisë tregtare, nivelin e riskut dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale që lidhen me portofolin dhe nënprojektet e tij, si dhe vendin ku ushtron aktivitetin, sipas rastit. Këto kërkesa shtesë ose alternative do të përfshihen në procedurat e posaçme mjedisore dhe sociale që do të dakordësohen ndërmjet BERZH-it dhe NF-së në kohën e investimit të Bankës.

Kërkesat

Kapaciteti organizativ brenda NF-së

9. Ndërmjetësi financiar duhet të ketë politika për burimet njerëzore, sisteme dhe praktika menaxhimi në përputhje me KP2 (Kushtet e punës dhe punësimin) dhe do të respektojë kërkesat përkatëse për shëndetin dhe sigurinë në punë të KP4 (Shëndeti, siguria dhe siguri). Këto do t'u komunikohen punonjësve të NF-së.
10. Ndërmjetësi financiar duhet të caktojë një apo më shumë përfaqësues nga radhët e drejtuesve të lartë të ndërmjetësit financiar për çështjet mjedisore, shëndetësore, sociale dhe të sigurisë, si dhe duhet të zbatojë kërkesat e kësaj KP-je si dhe të KP2 dhe KP4. Përfaqësuesi përgjegjës duhet të: (i) caktojë një punonjës personin përgjegjës për zbatimin e përditshëm të kërkesave mjedisore dhe sociale dhe të japë mbështetje për zbatimin; (ii) identifikojë nevojat për trajnim mjedisor dhe social dhe buxhetin e nevojshëm; dhe (iii) sigurojë që të ketë ekspertizën e duhur teknike, ose brenda organizatës ose jashtë saj, për të kryer vlerësimet dhe për të menaxhuar nënprojektet me rreziqe dhe ndikime të mundshme e të padëshirueshme mjedisore ose sociale.
11. Ndërmjetësi financiar duhet të ketë në funksionim një Sistem të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS), duke përfshirë një politikë mjedisore dhe sociale dhe procedura mjedisore dhe sociale sipas natyrës së ndërmjetësit financiar, dhe nivelit të rreziqeve mjedisore dhe sociale që shoqërojnë nënprojektet.
12. Kur ndërmjetësi financiar mund të tregojë se e ka një SMMS të tillë, ai duhet të paraqesë dëshmitë e duhura të dokumentuara lidhur me SMMS-në. Kur kërkohet ngritja apo përmirësimi i SMMS-së, ndërmjetësi financiar do të dakordësojë një plan veprimi me BERZH-in.
13. Procedurat mjedisore dhe sociale duhet të përfshijnë mekanizmat e vlerësimit dhe të monitorimit të riskut, sipas rastit:
 - për të shqyrtuar paraprakisht të gjithë klientët/nënprojektet kundrejt Listës së përjashtimit mjedisor dhe social bashkëlidhur si Shtojca 1 e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it dhe Listës së Referimit të ndërmjetësit financiar, bashkëlidhur si Shtojca A e kësaj KP-je;
 - për të kategorizuar riskun mjedisor dhe social të nënprojekteve të propozuara (i ulët/i mesëm/i lartë) në përputhje me Listën e BERZH-it për kategorizimin e riskut mjedisor dhe social për ndërmjetësit financiarë;
 - për të siguruar, përmes vlerësimit, që nënprojektet të strukturohen në përputhje me kërkesat rregullatore të vendit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale, duke përfshirë, sipas nevojës, kërkesat rregullatore kombëtare në lidhje me konsultimin publik dhe publikimin e informacionit dhe duke u kërkuar klientëve, sipas rastit, të zbatojnë plane korrigjuese veprimi;
 - për të mbajtur dhe përditësuar rregullisht të dhënat mjedisore dhe sociale për nënprojektet; dhe
 - për të monitoruar nënprojektet me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me aktet kombëtare ligjore për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, si dhe punën.

14. Kur ndërmjetësi financiar financon një nënprojekt që përmbush kriteret e listës së projekteve të Kategorisë A apo Shtojca 2 bashkëlidhur Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, këto nënprojekte duhet të përmbushin KP 1 deri te KP 8 dhe KP 10.
15. Lista e Referimit të NF-ve, bashkëlidhur si Shtojca A e kësaj KP-je, rendit një sërë veprimtarish me rreziqe tepër të larta mjedisore dhe sociale. Kur një nënprojekt përfshin veprimtari të renditura në Shtojcën A të kësaj KP-je, ndërmjetësi financiar duhet të referojë këtë nënprojekt te BERZH.

Angazhimi i palëve të interesit

16. Ndërmjetësit financiarë duhet të vënë në zbatim një sistem për trajtimin e komunikimit të jashtëm për çështjet mjedisore dhe sociale. Ndërmjetësi financiar duhet t'u përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve të tilla në kohën e duhur. Ndërmjetësit financiarë duhet të publikojnë edhe politikën e tyre mjedisore dhe sociale ose një përmbledhje të SMMS-së së tyre në faqen e internetit, nëse ka. Kur është e mundur, ndërmjetësit financiarë duhet të vendosin në faqen e tyre të internetit informacionin për çdo raport vlerësimi të ndikimeve mjedisore dhe sociale për nënprojektet e Kategorisë A që ata financojnë. NF-të duhet të publikojnë edhe informacionin mbi risqet mjedisore dhe sociale të çdo nënprojekti të referuar BERZH-it në përputhje me paragrafin 15 të kësaj KP-je dhe masat e propozuara zbutëse për të adresuar këto rreziqe, objekt i kufizimeve rregullatore të zbatueshme, ndjeshmërisë së tregut ose pëlqimit të financuesit të nënprojektit.

Raportimi te BERZH-i

17. Ndërmjetësi financiar duhet t'i paraqesë BERZH-it raporte vjetore mjedisore dhe sociale për zbatimin e SMMS-së së tij, të këtij kriteri performance, të KP 2, të kërkesave për sigurinë dhe shëndetin në punë të KP 4, si edhe për ecurinë mjedisore dhe sociale të portofolit të nënprojekteve të tij.

Shtojca A: Lista e Referimit të Ndërmjetësve Financiarë

Financimi nga NF-të për sa më poshtë është objekt referimi pranë BERZH-it⁹⁵:

- (i) Veprimtari që rezultojnë në zhvendosjen e pavullnetshme – *Kërkesa e Performancës 5 e BERZH-it*
- (ii) Veprimtari që ndodhin brenda ose kanë potencialin të ndikojnë negativisht në një zonë ligjërish të mbrojtur, dhe/ose njihet ndërkombëtarisht, ose propozohet për një status të tillë nga qeveritë kombëtare, habitatit kritik, ekosistemet e tjera që mbështesin karakteristikat parësore të biodiversitetit, vendet me interes shkencor, habitatet e llojeve të rralla/të rrezikuara, peshkimi me rëndësi ekonomike ose pyje të lashta me rëndësi ekologjike – *Kërkesa e Performancës 6 e BERZH-it*
- (iii) Veprimtari që përfshijnë mbarështimin intensiv të gjësë së gjallë – *Kërkesa e Performancës 6 e BERZH-it*
- (iv) Veprimtaritë e vendosura brenda, pranë ose në rrjedhën e sipërme të tokës së zënë nga popullsia indigjene dhe/ose grupet e cenueshme, duke përfshirë tokat dhe rrjedhat ujore të përdorura për sigurimin e jetesës, siç janë kullotja e bagëtive, gjuetia ose peshkimi – *Kërkesa e Performancës 7 e BERZH-it*
- (v) Veprimtari që mund të ndikojnë negativisht në sitet me rëndësi kulturore apo arkeologjike – *Kërkesa e Performancës 8 e BERZH-it*
- (vi) Veprimtari që mund të shkaktojnë çlirimin e OMGJ-ve në mjedisin natyror – *Kërkesa e Performancës 6 e BERZH-it*
- (vii) Çdo Projekt Hidrocentrali (HPP) mikro, i vogël apo i mesëm që nuk shpie në zbatimin e kërkesave të Kategorisë A – *Kriteret e Pranimi të BERZH-it për Projektet e Hidrocentraleve të Vegjël*
- (viii) Çdo projekt i Kategorisë A i përfshirë në Shtojcën 2 të Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it.

⁹⁵ Kërkesa kryesore e performancës që do të kërkohet të plotësojnë transaksionet e propozuara tregohet me shkronja të pjerrëta.

Kërkesa e Performancës 10 e BERZH-it: Publikimi i informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit

Hyrje

1. Kjo kërkesë performance (KP) pranon rëndësinë e një pjesëmarrjeje të hapur dhe transparente midis klientit, punonjësve të tij, përfaqësuesve të punonjësve, komuniteteve vendore dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga projekti dhe, sipas rastit, palëve të tjera të interesit, si një element thelbësor i praktikës së mirë ndërkombëtare dhe qytetarisë së shoqërisë tregtare. Një angazhim i tillë është edhe një mënyrë për ta përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale të projekteve. Në veçanti, një angazhim i efektshëm i komunitetit, i përshtatshëm me natyrën dhe shkallën e projektit nxit një performancë mjedisore dhe sociale të shëndoshë dhe të qëndrueshme dhe mund të sjellë rritje të rezultateve financiare, mjedisore dhe sociale, krahas rritjes së përfitimeve për komunitetin.
2. Angazhimi i palëve të interesit është thelbësor për ndërtimin e marrëdhënieve të forta, konstruktive dhe me komunikim të vazhdueshëm, të cilat janë të rëndësishme për menaxhimin me sukses të riskut dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të një projekti. Ai është një proces gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm i cili bëhet më i efektshëm kur ndërmerret në një fazë të hershme të projektit dhe është një pjesë përbërëse e vlerësimit, menaxhimit dhe monitorimit të rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit.

Objektivat

3. Objektivat e kësaj kërkesë performance janë:
 - përvijimi i një qasjeje sistematike për angazhimin e palëve të interesit, që do t'i ndihmojë klientët të ndërtojnë dhe të mbajnë një marrëdhënie konstruktive me palët e interesit;
 - sigurimi i mjeteve për angazhimin e efektshëm dhe gjithëpërfshirës me palët e interesit të projektit gjatë të gjithë jetës së projektit;
 - sigurimi që publikohet informacioni i duhur mjedisor dhe social dhe mbahen konsultime kuptimplota me palët e interesit të projektit, dhe sipas rastit, merren parasysh komentet e dhëna gjatë konsultimeve; dhe
 - sigurimi që ankesat që vijnë nga palët e interesit të marrin përgjigje dhe të menaxhohen siç duhet.

Fusha e zbatimit

4. Kjo KP zbatohet për të gjitha projektet. Minimalisht, të gjitha projektet duhet të kryejnë identifikimin e palëve të interesit dhe të përgatisin dhe zbatojnë një mekanizëm ankesash. Duhet të ndërmerret angazhim i mëtejshëm i palëve të interesit siç përcaktohet në këtë KP, në proporcion me: natyrën dhe shkallën e projektit, palëve të tij të interesit dhe rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale.

5. Klientët duhet të identifikojnë dhe angazhojnë palët e interesit si pjesë integrale të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social të projektit, sistemeve të menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS), dhe planit të menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS) sikurse përcaktohet në KP 1. Kjo KP duhet të lexohet së bashku me kërkesat e KP 2 lidhur me angazhimin e punonjësve dhe me KP 4 lidhur me angazhimin e përgatitjes dhe përgjigjes ndaj emergjencave. Në rastin e projekteve që përfshijnë shpërnguljen ekonomike dhe zhvendosjen e pavullnetshme, që prek popullsitë indigjene ose kanë një ndikim të padëshirueshëm në trashëgiminë kulturore, klienti duhet të zbatojë edhe kërkesat e veçanta të publikimit të informacionit dhe konsultimeve siç parashikohet në KP 5, KP 7 dhe KP 8.

Kërkesat

6. Angazhimi i palëve të interesit duhet të përfshijë elementet e mëposhtme: identifikimin dhe analizimin e palëve të interesit, planifikimin e angazhimit të palëve të interesit, publikimin e informacionit, konsultimin kuptimplotë, mekanizmin e ankesave dhe raportimin në vazhdimësi tek palët përkatëse të interesit.
7. Klienti duhet të realizojë angazhimin e palëve të interesit duke u mundësuar atyre qasje në informacion të përpiktë, relevant, të kuptueshëm dhe të aksesueshëm, në një mënyrë kuptimplote, efektive, gjithëpërfshirëse dhe në përshtatje me kulturën e tyre, si dhe pa manipulime, ndërhyrje, shtrëngime, frikësime dhe ndëshkime.
8. Angazhimi i palëve të interesit duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur gjatë hartimit të projektit dhe do të vijojë gjatë të gjithë jetës së projektit. Natyra dhe shpeshësia e angazhimit të palëve të interesit gjatë të gjitha fazat e përgatitjes së projektit duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e projektit dhe me risqet dhe ndikimet e mundshme të padëshirueshme si dhe nivelin e interesimit të palëve të interesit. Klienti duhet të përmbushë kërkesat e legjislacionit kombëtar në lidhje me informimin dhe konsultimin e publikut, përfshi edhe ato akte ligjore që zbatohen detyrimet që ka vendi pritës në kuadër të së drejtës ndërkombëtare.
9. Klienti duhet të përcaktojë role, përgjegjësi dhe autoritete të qarta, si dhe të caktojë punonjës të posaçëm të cilët të jenë përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të angazhimit të palëve të interesit.

Angazhimi gjatë përgatitjes së projektit

Identifikimi i palëve të interesit

10. Klienti duhet të identifikojë dhe dokumentojë palët e interesit, të përkufizuar si individë apo grupe të ndryshme që: (i) preken ose ka të ngjarë të preken (drejtpërdrejt ose tërthorazi) nga projekti (palët e prekura), ose (ii) mund të kenë interes për projektin (palë të tjera të interesuara).
11. Klienti duhet të identifikojë palët e prekura nga projekti (individët dhe grupet) të cilët për shkak të rrethanave të tyre të veçanta, mund të jenë të cënuar apo disavantazhuar. Në bazë të këtij identifikimi, klienti do të identifikojë edhe individët apo grupet që mund të kenë shqetësime dhe përparësi të ndryshme lidhur me ndikimet e projektit, mekanizmat zbutëse dhe përfitimet, dhe të cilët mund të kërkojnë forma të ndryshme apo më vete të angazhimit. Identifikimi i palëve të interesit duhet të kryhet në mënyrë të hollësishme, me qëllim që të përcaktohet niveli i duhur i komunikimit lidhur me projektin.

Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit

12. Për projektet që ka të ngjarë të kenë risk dhe/ose ndikime të padëshirueshme mjedisore ose sociale, klienti duhet të hartojë dhe të zbatojë një plan për angazhimin e palëve të interesit (PAPI) apo një proces të barasvlershëm të dokumentuar të përshtatshëm për natyrën dhe shkallën e riskut, të ndikimeve dhe fazës së zhvillimit të projektit. Për çdo projekt që kërkon një Vlerësim të Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale (VNMS), PAPI duhet të zbatojë kërkesat për publikimin e informacionit dhe konsultimet për projektet e Kategorisë A të parashtruara në pikat 22-26 të kësaj KP-je.
13. PAPI duhet të përshkruajë se si do të kryhet angazhimi me palët e identifikuar të interesit gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, duke përfshirë kohën dhe metodat e angazhimit, informacionin që do të publikohet, gjuhë(t) dhe llojin e informacionit që duhet kërkuar nga palët e interesit. PAPI duhet të përshtatet në të atillë mënyrë që të merren parasysh karakteristikat kryesore (duke përfshirë gjininë) dhe interesat e palëve të prekura nga projekti, si dhe të bëhet dallimi ndërmjet niveleve dhe metodave të ndryshme të angazhimit që mund t'i përshtatet secilit. Niveli i detajimit të nevojshëm do të përcaktohet rast pas rasti. Burimet që do të vihen në dispozicion për angazhimin e palëve të interesit do të përcaktohen në PAPI. PAPI duhet të përditësohet sipas rastit gjatë jetëgjatësisë së projektit.
14. Kur angazhimi i palëve të interesit varet në mënyrë të konsiderueshme nga përfaqësuesit e komunitetit,⁹⁶ klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të verifikuar që këta persona përfaqësojnë me të vërtetë pikëpamjet e komuniteteve të prekura dhe që ata e lehtësojnë procesin e komunikimit duke ua komunikuar informacionin zgjedhësve të tyre dhe duke i përcjellë komentet e tyre tek klienti ose autoritetet, sipas rastit.
15. Kur angazhimi i palëve të interesit është përgjegjësi e autoriteteve përkatëse shtetërore, klienti duhet të bashkëpunojë, në masën e lejuar, me autoritetin qeveritar përkatës për të arritur rezultatet që janë në përputhje me këtë KP. Kur ka boshllëqe midis kërkesave rregullatore vendore dhe kësaj kërkesë performance, klienti duhet të identifikojë veprimtaritë e angazhimit në plotësim të procesit rregullator zyrtar dhe, sipas rastit, të angazhohet për masa plotësuese shtesë.
16. Në rastet kur nuk dihet vendndodhja e saktë e projektit, PAPI duhet të ketë formatin e një qasjeje kuadër si pjesë e SMMS-së së përgjithshme të klientit, duke përvijuar parimet e përgjithshme dhe një strategji për të identifikuar palët e prekura të interesit dhe planin për një proces angazhimi në përputhje me këtë kërkesë performance që do të zbatohet pasi të merret vesh vendndodhja.
17. Klientët me aktivitete dhe projekte në disa zona, për të cilat kërkohet financim i përgjithshëm i shoqërisë tregtare, kapital qarkullues ose financim për kapitalin aksioner, duhet të ndjekin dhe të zbatojnë një PAPI në nivel shoqërie tregtare. PAPI në nivelin e shoqërisë tregtare duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën e veprimtarisë tregtare të klientit dhe me rreziqet dhe ndikimet përkatëse mjedisore dhe sociale dhe nivelin e interesimit të palëve të interesit. PAPI duhet të shtrihet tek të gjitha strukturat në kohën e duhur. Ai duhet të përfshijë procedura dhe burime për të siguruar angazhimin e duhur të palëve të interesit në nivel strukture dhe për të siguruar që palët e interesit në afërsi të strukturave të marrin informacion për performancën mjedisore dhe sociale të strukturës përkatëse.

⁹⁶ Për shembull, udhëheqësit fetarë dhe të komunitetit, përfaqësuesit e pushtetit vendor, përfaqësuesit e shoqërisë civile, politikanët, mësuesit dhe/ose përfaqësuesit tjerë të një ose më shumë grupeve të prekura të palëve të interesit.

Publikimi i informacionit

18. Kur projekti ka ndikime mjedisore dhe sociale, klienti duhet të publikojë informacionin përkatës të projektit, sipas rastit, për të ndihmuar palët e interesit të kuptojnë rreziqet, ndikimet dhe mundësitë e projektit. Klienti duhet t'u sigurojë palëve të interesit qasje në informacionin e mëposhtëm:
 - qëllimi, natyra, shkalla dhe kohëzgjatja e projektit;
 - rreziqet dhe ndikimet e mundshme për palët e interesit dhe planet zbutëse të propozuara që theksojnë rreziqet dhe ndikimet e mundshme që mund të prekin në mënyrë jo proporcionale grupet e cënueshme dhe të disavantazhuara dhe të diferencojnë masat për t'i zbutur ato;
 - procesi i parashikuar për angazhimin me palët e interesit, nëse ka, dhe mundësitë dhe mënyrat me të cilat palët e interesit mund të marrë pjesë;
 - koha dhe vendi i çdo takimi të parashikuar për konsultimet me publikun dhe procesi me të cilin njoftohen, përmbledhen dhe raportohen takimet; dhe
 - procesi përmes së cilit do të menaxhohen ankesat.

Informacioni duhet të jepet në gjuhë(t) vendore dhe në mënyrë të aksesueshme dhe të përshtatshme në aspektin kulturor, duke pasur parasysh nevojat e veçanta të grupeve që mund të preken në mënyrë të diferencuar ose të grupeve të popullsisë me nevoja të veçanta informim (q përfshijnë aftësinë e kufizuar, aftësinë e të lexuarit dhe kuptuarit, gjininë, lëvizshmërinë, dallimet në gjuhë apo aksesueshmëri). Aty ku është e nevojshme dhe e përshtatshme nga ana kulturore, një palë e tretë mund të punësohet për të dhënë informacion me qëllim shmangien e frikësimit, shtrëngimit ose çdo forme të manipulimit.

Konsultimi serioz

19. Klienti duhet të zhvillojë konsultime kuptimplota, mbështetur në natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit dhe nivelit të interesimit të palëve të interesit. Nëse klienti është në angazhim e sipër me një proces të tillë, ai duhet të ofrojë dëshmi të dokumentuara adekuate të këtij angazhimi..
20. Konsultimi kuptimplotë është një proces me dy kahe që:
 - duhet të fillojë herët në procesin e planifikimit të projektit për të mbledhur opinionet fillestare për propozimin e projektit dhe për të informuar hartimin e projektit;
 - inkurajon reagimet e palëve të interesit, veçanërisht si një mënyrë për të informuar procesin e përgatitjes së projektit dhe angazhimin e palëve të interesit në identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale;
 - kryhet në vazhdimësi;
 - bazohet në publikimin dhe shpërndarjen paraprake të informacionit përkatës, transparent, objektiv dhe lehtësisht të aksesueshëm në një afat kohor që mundëson konsultime me palët e interesit;

- ndërmerret në një format të përshtatshëm kulturor, në gjuhë(t) përkatëse vendore, është i kuptueshëm për palët e interesit dhe merr në konsideratë proceset vendimmarrëse të palëve të interesit;
- merr parasysh dhe i përgjigjet komenteve;
- mbështet angazhimin aktiv dhe gjithëpërfshirës me palët e prekura nga projekti, duke përfshirë grupet e disavantazuara apo të cënueshme;
- nuk ka manipulim të jashtëm, ndërhyrje, shtrëngim, diskriminim, kërcënim dhe ndëshkim; dhe
- dokumentohet nga klienti.

21. Klienti duhet t'i informojë në kohë ata që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik lidhur me vendimin përfundimtar për projektin, masat përkatëse lehtësuese mjedisore dhe sociale dhe çdo përfitim të projektit për komunitetet vendore, së bashku me arsyet dhe argumentet mbi të cilat është bazuar vendimi. Ky informacion duhet të përfshijë një përmbledhje të komenteve të marra dhe një shpjegim të shkurtër se si është marrë parasysh ose arsyet pse nuk është marrë dhe mekanizmin e disponueshëm të ankesave.

Publikimi i informacionit dhe konsultimet për Projektet e Kategorisë A

22. Projektet e Kategorisë A kërkojnë që klienti të ndërmarrë një proces të formalizuar dhe me pjesëmarrje për konsultimin dhe publikimin e informacionit, i cili do të integrohet në çdo fazë të procesit të VNMS-së, duke marrë parasysh fazën e zhvillimit të projektit. Ky proces kërkon konsultime të organizuara dhe të përsëritura, si rezultat i të cilave klienti duhet të përfshijë në procesin vendimmarrës pikëpamjet e palëve të prekura për çështjet që i prekin ata drejtpërdrejt.
23. Klienti duhet të përfshihet në një proces të përcaktimit të çështjeve mjedisore dhe sociale me palët e identifikuara të interesit në një fazë të hershme të procesit VNMS, për të siguruar identifikimin e çështjeve kryesore që duhen vlerësuar në kuadër të VNMS-së. Në kuadër të procesit të përcaktimit të çështjeve mjedisore dhe sociale, palët e interesit duhet të jenë në gjendje të japin komente dhe sugjerime për një projekt-PAPI dhe dokumentet e tjera të përcaktimit të çështjeve mjedisore dhe sociale.
24. Krahas VNMS-së dhe PAPI-t, klienti duhet të bëjë publik edhe Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) të projektit si dhe një përmbledhje jo-technike (NTS)⁹⁷. Planet e zbatueshme të menaxhimit duhet të bëhen publike sikurse përcaktohet në këto KP dhe sipas dakordësimit me Bankën.
25. Procesi i konsultimeve dhe publikimit të informacionit duhet të përmbushë çdo kërkesë të zbatueshme sipas legjislacionit të brendshëm për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sipas akteve të tjera përkatëse ligjore. Klienti duhet ta mbajë publik VNMS-në përgjatë gjithë jetës së projektit, por ai mund të ndryshohet, herë pas here, me informacione shtesë ose të arkivohet pas përfundimit të projektit, për sa kohë është i disponueshëm sipas kërkesës dhe brenda afateve të duhura.

26. Klienti duhet t'u raportojë rregullisht palëve të interesit për performancën e tij mjedisore dhe sociale. Këto raporte duhet të kenë një format të aksesueshëm për komunitetet e prekura përmes një publikimi të vecantë, në faqen e internetit, ose sikurse detajohet në PAPI. Këto raporte do të publikohen të paktën çdo vit, në përputhje me shqetësimet e palëve përkatëse të interesit.

⁹⁷ Direktiva e BERZH-it për Informimin Publik parashikon që Banka të publikojë VNMS-të për projektet e kategorisë A, 60 ditë kalendarike përpara shqyrtimit të projektit nga Bordi i Drejtorëve për projektet e sektorit privat dhe 120 ditë kalendarike përpara shqyrtimit të Bordit për projektet e sektorit publik.

Angazhimi gjatë zbatimit të projektit dhe raportimi i jashtëm

27. Gjatë jetëgjatësisë së projektit, klienti duhet të informojë palët e identifikuar të interesit në mënyrë të vazhdueshme. Shpeshësia, metoda dhe informacioni që do të jepet do të jenë të përshtatshme për natyrën e projektit dhe rreziqet dhe ndikimet e tij negative mjedisore dhe sociale, palët e interesit dhe nivelin e interesit. Mund të duhet të jepen informacione ose të mbahen konsultime shtesë në faza kyçe të ciklit të projektit dhe për çdo çështje të veçantë që është identifikuar si shqetësim nga palët e interesit gjatë procesit të publikimit të informacionit dhe konsultimit apo mekanizmit të ankesave.
28. Sipas rastit, klienti duhet të kërkojë edhe reagime nga palët e prekura mbi efektivitetin e masave për zbutjen e ndikimit. Për projektet me risqe mundësisht të larta ose ndikime negative në komunitetet e prekura, dhe në përputhje me nivelin e interesimit të palëve të interesit, klienti mund të angazhojë anëtarë të komunitetit ose palë të tjera të interesit për të marrë pjesë në veprimtaritë e monitorimit mjedisor dhe social të përcaktuara në KP 1.

Mekanizmi i ankesave

29. Klienti duhet të jetë i ndërgjegjshëm për shqetësimet e palëve të interesit në lidhje me projektin dhe t'u përgjigjet atyre në kohë. Për këtë qëllim, klienti duhet të ngrejë një mekanizëm të efektshëm për ankesat, sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë të që marrë dhe të mundësojë zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, sidomos për performancën mjedisore dhe sociale të klientit. Mekanizmi i ankesave duhet të jetë në përputhje me shkallën e rreziqeve dhe të ndikimeve të padëshirueshme që mund të ketë projekti:
- mekanizmi i ankesave do të trajtojë shqetësimet menjëherë dhe në mënyrë efektive, në një mënyrë transparente që është kulturalisht e përshtatshme, pa manipulime, ndërhyrje, shtrëngime, frikësime dhe ndëshkime dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjitha palët e prekura, pa asnjë kosto. Mekanizmi nuk duhet të pengojë përdorimin e rrugëve ligjore gjyqësore ose administrative. Klienti duhet t'i informojë palët e interesit për procesin e ankesave gjatë veprimtarive të angazhimit me komunitetin dhe të raportojë rregullisht përpara publikut për zbatimin e tij, duke mbrojtur të dhënat private të individëve të prekur;
 - trajtimi i ankesave do të bëhet në një mënyrë kulturalisht të përshtatshme dhe do të jetë i matur, objektiv, i ndjeshëm dhe i gatshëm kundrejt nevojave dhe shqetësimeve të palëve të interesit. Mekanizmi do të mundësojë edhe paraqitjen dhe adresimin e ankesave anonime;
 - klienti duhet të marrë në konsideratë ofrimin e ndërmjetësit në zgjidhjen e ankesave në projekte ku ka shqetësime të konsiderueshme të komunitetit; dhe
 - monitorimi i zbatimit të mekanizmit të ankesave dhe analiza e tendencave do të ndërmerren rregullisht.

Ndryshime në rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit

30. PAPI duhet të përfshijë dispozita për angazhimin e palëve të interesit nëse ka ndryshime, në çdo fazë të jetëgjatësisë së projektit, të cilat rezultojnë në ndryshime të rëndësishme në rreziqet dhe ndikimet mjedisore ose sociale. Klienti duhet të informojë palët e interesit rreth zbutjes së këtyre ndryshimeve, dhe nëse ka rreziqe dhe ndikime të konsiderueshme negative në palët e prekura, klientit duhet të kryejë konsultime shtesë.

Shënime

Kontakte të BERZH-it

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

Londër EC2A 2JN

Mbretëria e Bashkuar

ëëëëëë.ebrd.com

Telefon:

Tel: +44 20 7338 6000

Kërkesat për informacion

Për kërkesa dhe pyetje, ju lutemi klikoni në
www.ebrd.com/eform/information-request

1096 Politika Mjedisore dhe Sociale

© Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim